



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 93

Tiranë – E martë, 15 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 68/2021, datë 20.5.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)”.....
	9245
Dekret i Presidentit nr. 13097, datë 10.6.2021	Për shpallje ligji.....
	9247
Ligj nr. 69/2021, datë 20.5.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2019, për projektin “Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës (DKTI)”.....
	9247
Dekret i Presidentit nr. 13098, datë 10.6.2021	Për shpallje ligji.....
	9249
Ligj nr. 70/2021, datë 20.5.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal”.....
	9250
Dekret i Presidentit nr. 13099, datë 10.6.2021	Për shpallje ligji.....
	9252
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 2.6.2021	Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021.....
	9252
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 10.6.2021	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Vorë, Bashkia Vorë, faza I.....
	9276

Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 3, datë 2.6.2021	Për miratimin e planit të veprimit për ruajtjen e gjelit të egër (<i>Tetrao Urogallus</i>), si një nga llojet veçanërisht të mbrojtura, të regjistruar me status “ruajtje të pafavorshme”, ndodhur në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, në Shqipëri.....	9294
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 336, datë 10.6.2021	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.....	9321
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 270, datë 31.5.2021	Për miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik “Mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë”.....	9326
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 390, datë 7.6.2021	Për delegim kompetencash.....	9328
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3010/5, datë 11.6.2021	Për rishpallje kërkesë për shpronësim për interes publik përmes kompensimit me shkëmbim, për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit “Për zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative 6, zona Kombinat”, në funksion të procesit të rindërtimit.....	9328
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Shaqe Zefi.....	9348
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetasit Vilfred Mëlleza.....	9348
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Karmelina Dredhaj.....	9348



LIGJ
Nr. 68/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2018, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI PËR MENAXHIM TË
QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME
KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE
(DKTI)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.5.2021.

Shpallur me dekreten nr.13097, date 10.6.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2018, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI PËR MENAXHIM TË
QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME
KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE
(DKTI)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar Protokollit të Bisedimeve Qeveritare të datës 22 nëntor 2018, kanë rënë dakord si vijon.

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose të marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)* shumat e mëposhtme:

1. Një kredi të butë, në vlerë të përgjithshme deri në 50 000 000 euro (me fjalë: pesëdhjetë milionë euro), e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim për zbatimin e projektit “Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se projekti vlen për t'u mbështetur në pikëpamje të politikave zhvillimore, dhe nëse vazhdon të konfirmohet aftësia kredimarrëse e Republikës së Shqipërisë, si dhe nëse Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, për sa kohë nuk është ai vetë marrësi i kredisë. Projekti nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.



2. Një kontribut financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, në vlerë të përgjithshme deri në 5 000 000 euro (me fjalë: pesë milionë euro).

3. Një kontribut financimi, në vlerë të përgjithshme deri në 6 900 000 euro (me fjalë: gjashtë milionë e nëntëqind mijë euro), për projektin “Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve - grant investimesh”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur dhe konfirmohet, se i plotëson kriteret e veçanta të financimit në formën e një shume financimi, si një masë për përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri, si masë e orientuar për nga vetë ndihma në luftën kundër varfërisë, si fond i garancisë së kredive për sipërmarrjet e mesme apo projekt në sektorin e infrastrukturës sociale ose të mbrojtjes së mjedisit.

2. Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* hua apo shuma të tjera financimi për përgatitjen e projekteve të përmendura në paragrafin 1 apo shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të përmendura në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e prokurimit përcaktohen në kontratat, që do të lidhen midis *Kreditanstalt für Wiederaufbau* dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të huas dhe të financimit nuk lidhen brenda katër viteve pas vitit të premimit financiar. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2022.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha

pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumave të financimit, do të garantojë ndaj *Kreditanstalt für Wiederaufbau* pagesat eventuale për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin, në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Taksa të tjera të veçanta konsumi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahës kësaj, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe të furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huave dhe shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.



2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila prej palëve në marrëveshje mund ta zgjidhë atë në çdo kohë, me shkrim në rrugë diplomatike; zgjidhja e marrëveshjes bëhet e vlefshme 30 ditë pas mbërritjes së këtij njoftimi pranë palës tjetër kontraktuese.

4. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

5. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese, përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 27.1.2021, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës
së Shqipërisë

Për qeverinë e Republikës
Federale të Gjermanisë

DEKRET

Nr. 13097, datë 10.6.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 68/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin ‘Programi për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve (DKTI)’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 69/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2019, PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I HIDROCENTRALIT TË FIERZËS (DKTI)”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2019, për projektin “Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës (DKTI)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.5.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13098, datë 10.6.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**MARRËVESHJE****NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2019, PËR PROJEKTIN
“REHABILITIMI I HIDROCENTRALIT TË
FIERZËS (DKTI)”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimeve financiar të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 341/2019, e datës 19 dhjetor 2019),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)* shumat e mëposhtme:

1. Një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 40 000 000 euro (me fjalë: dyzet milionë euro), e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim për zbatimin e projektit “Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës (DKTI)”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se projekti vlen për t'u mbështetur në pikëpamje të politikave zhvillimore dhe nëse vazhdon të konfirmohet aftësia kredimarrëse e Republikës së Shqipërisë, si dhe nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, për sa kohë nuk është ai vetë marrësi i kredisë. Projekti nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.

2. Një kontribut financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin Faqe|9248

1 në vlerë të përgjithshme deri në 2 000 000 euro (me fjalë: dy milion euro), nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* shumat të tjera financimi për përgatitjen apo realizimin e projektit të përmendur në paragrafin 1 apo shumat të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e prokurimit përcaktohen në kontratat, që do të lidhen midis *Kreditanstalt für Wiederaufbau* dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të huas dhe të financimit nuk lidhen brenda një periudhe katërvjeçare pas vitit të premtimeve. Për këto shumat afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2023.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumave të financimit, do të garantojë ndaj *Kreditanstalt für Wiederaufbau* pagesat eventuale për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në



kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Taksa të tjera të veçanta konsumi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahas kësaj Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe të furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huave dhe shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila prej palëve në marrëveshje mund ta zgjidhë atë në çdo kohë me shkrim, duke respektuar afatin paraprak gjashtëmujor.

4. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

5. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 27.1.2021, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

DEKRET

Nr. 13098, datë 10.6.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 69/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2019, për projektin ‘Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës (DKTI)’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



LIGJ
Nr. 70/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2018, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR
ZHVILLIM TË INTEGRUAR RAJONAL”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.5.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13099, datë 10.6.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2018, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR
ZHVILLIM TË INTEGRUAR RAJONAL”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe për t'i thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar Protokollit të Bisedimeve Qeveritare të datës 22 nëntor 2018,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)* shumat e mëposhtme:

1. Një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 20 000 000 euro (me fjalë: njëzet milionë euro), e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim për zbatimin e projektit “Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal”,

nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar, se projekti vlen për t'u mbështetur në pikëpamje të politikave zhvillimore dhe nëse vazhdon të konfirmohet aftësia kredimarrëse e Republikës së Shqipërisë, si dhe nëse Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, për sa kohë nuk është ai vetë marrësi i kredisë. Projekti nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.

2. Kontribute financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, në vlerë të



përgjithshme deri në 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro).

2) Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* hua apo shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 apo shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e prokurimit përcaktohen në kontratat, që do të lidhen midis *Kreditanstalt für Wiederaufbau* dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të huas dhe të financimit nuk lidhen brenda katër viteve pas vitit të premtimeve financiar. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2022.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumave të financimit, do të garantojë ndaj *Kreditanstalt für Wiederaufbau* pagesat eventuale për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1. Tatimi mbi

Vlerën e Shtuar, si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Taksa të tjera të veçanta konsumi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahës kësaj Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe të furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huave dhe shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila prej palëve në marrëveshje mund ta zgjidhë atë në çdo kohë me shkrim në rrugë diplomatike; zgjidhja e marrëveshjes bëhet e vlefshme 30 ditë pas mbërritjes së këtij njoftimi pranë palës tjetër kontraktuese.

4. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.



5. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo negociatave përkatëse.

Bërë në Tiranë, më 27.1.2021, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave Për Qeverisë e Republikës
të Republikës Federale të Gjermanisë
së Shqipërisë

DEKRET

Nr. 13099, datë 10.6.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 70/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin ‘Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 326, datë 2.6.2021

PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t’ia përcjellë menjëherë rekomandimet prioritare Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe t’ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorisë të të gjitha shkallëve dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

REKOMANDIME PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021 TIRANË, MAJ 2021

Ministria e Drejtësisë, mbështetur në qëllimin e programit të Këshillit të Ministrave për sistemin e drejtësisë që synon të forcojë pavarësinë e këtij sistemi, konsolidimin e mekanizmave të llogaridhënies, mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, bazuar në detyrimet e ligjit nr. 97, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka përgatitur rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim, në luftën kundër kriminalitetit.

Sikurse është theksuar në çdo rekomandim kundër kriminalitetit, garantimi dhe funksionimi me eficiencë të plotë dhe të besueshme të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit është me rëndësi jetike në parandalimin e çdo veprimtarie keqbërëse, që cenon sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve dhe vë në rrezik interesat publikë dhe ato shtetërorë. Po kështu, me rëndësi prioritare në çdo rekomandim të adresuar është siguri i pavarësisë së plotë të prokurorisë, kjo, me qëllimin e vetëm për të garantuar mbarëvajtjen, kontrollin e



veprimeve dhe respektimin e pavarësisë së brendshme të vetë prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, brenda kornizës ligjore të reformuar në vitet e fundit tërësisht, si në aspektin material, ashtu edhe në atë procedural.

Rekomandimet për luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2021, janë mbështetur kryesisht në vizionin, politikat, prioritetet dhe objektivat e dokumenteve strategjike, të cilat përbëjnë udhërrëfyes për çdo institucion ligjzbatues në planifikimin dhe ndërmarrjen e masave me efekte të drejtpërdrejta dhe të qëndrueshme në kohë dhe, konkretisht:

- Programin qeverisës 2017–2021¹;
- Draftstrategjinë e re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025² dhe në planin e saj të veprimit³;
- Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021⁴;
- Rekomandimet e raportit të progresit për Shqipërinë të Komisionit Evropian për vitin 2020;
- Planin e veprimit 2015–2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit⁵;
- Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur dhe planin e veprimit 2018–2021⁶;
- Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022⁷;

¹ Publikuar në faqen zyrtare: <https://kryeministria.al/www-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>.

² Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e drejtësisë, mbart detyrimin për të planifikuar dhe hartuar, në konsultim me institucionet e sistemit të drejtësisë, Strategjinë e re Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin përkatës të Veprimit 2021–2025.

Ministria e Drejtësisë ka koordinuar përgjatë muajve të fundit procesin e hartimit të Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 me asistencën e misionit EURALIUS V. Stafi i Ministrisë së Drejtësisë është përkujdesur të garantojë një proces gjithëpërfshirës, përmes konsultimit të gjerë të Koncept-dokumentit me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë. Përgjatë këtij procesi konsultimi kemi marrë komente dhe sugjerime shumë të vlefshme, të cilat janë reflektuar në variantin e konsoliduar të Koncept-dokumentit, i cili është miratuar nga Kryeministria.

Elementet e koncept-dokumentit dhe qëllimi i politikave, objektivat strategjikë dhe specifikë janë prezantuar nga ministri i Drejtësisë në takimin e komitetit drejtues sektorial për reformën në drejtësi, organizuar në datën 22.1.2021, me pjesëmarrjen e të gjithë institucioneve të përfshirë në SND, shoqësi civile, partnerëve kombëtar/ndërkombëtar.

Aktualisht vijon puna konkrete për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit bazuar në këtë Koncept-dokument, në përputhje me të gjitha kërkesat e metodologjisë së hartimit të dokumenteve strategjikë në Shqipëri.

³ Miratuar me vendimin nr. 409, datë 19.6.2019, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 24.6.2019.

⁴ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, në datën 10.4.2019.

⁵ Miratuar me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 7.7.2020.

⁶ Miratuar me vendimin nr. 541, datë 19.9.2018, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 20.9.2018.

- Raportet e organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë joqeveritarë⁸ lidhur me monitorime për çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike;

- Si dhe dokumente të tjera më rëndësi strategjike.

Gjithashtu, në përgatitjen e paketës së rekomandimeve janë përfshirë edhe kontributet e propozuara nga strukturat e pushtetit ekzekutiv (Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), institucione, të cilat kanë në përbërje të tyre personel, që me ligj iu është njohur cilësia e policisë gjyqësore. Një nga bazat kryesore në hartimin e rekomandimeve kanë përbërë statistikatat e dërguara nga organi i prokurorisë, kjo me qëllim evidentimin e trendeve, si në llojin dhe formën e veprimtarive kriminale, ashtu edhe në numër pjesëmarrjeje në to, përgjatë vitit 2020⁹.

⁷ Miratuar me vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 12.1.2021.

Me mbarimin e afatit të planit Kombëtar të Veprimit 2017–2020, Ministria e Brendshme ka hartuar strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, ku çështja e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit trajtohet si një element kriminal, pjesë e krimit të organizuar dhe ka gjetur aq vend sa lejon hapësira e dokumentit, duke ditur që format e krimit të organizuar janë të shumta dhe të ndërlidhura. Në zbatim të kësaj strategjie është hartuar dhe plan i veprimit 2021–2022.

⁸ Progresraporti për Shqipërinë i Komisionit Evropian, i vitit 2020, publikuar në “Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020 Communication on EU Enlargement Policy”, publikuar në datën 20.10.2020, në faqen zyrtare: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf; Indeksi vjetor i korrupsionit i Transparency International, Corruption perception Index 2020, publikuar në faqen zyrtare: <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/nz>; Deklarata e fundit e datës 25.2.2021, e FATF-së, mbi raportin kundër pastrimit të parave për Shqipërinë <https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/documents/increased-monitoring-february-2021.html#albania>.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit- *International Narcotics Control Strategy Report: volume 1-Drug and Chemical Control*, publikuar në 2 mars 2021, në faqen zyrtare: [https://www.state.gov/2021-INCSR-VOLUME-1-Drug-and-Chemical-Control-\(As-submitted-to-Congress\)-United-States-Department-of-State](https://www.state.gov/2021-INCSR-VOLUME-1-Drug-and-Chemical-Control-(As-submitted-to-Congress)-United-States-Department-of-State); dhe *volume 2-Money Laundering and Financial Crimes*, publikuar në 2 mars 2021, në faqen zyrtare: <https://www.state.gov/2021-INCSR-VOL-2-Final-to-GPS-2-17-21.docx> (state.gov).

⁹ Ministria e Drejtësisë ka kërkuar, me shkresën nr. 211 prot., datë 13.1.2021, kontribut nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ministria e Brendshme ka përcjellë kontribut me shkresën nr. 235/4 prot., datë 9.2.2021 protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/1 prot., datë 10.2.2021; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përcjellë kontribut me shkresën nr. 345/1 prot., datë 8.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/2 prot., datë 11.2.2021; Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë kontribut me shkresat nr. 699/3 prot., datë 11.2.2021 të Drejtonisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/3 prot., datë 12.2.2021, dhe shkresën nr. 1001/1 prot., datë 10.2.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/4 prot., datë 12.2.2021; Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 790/1 prot., datë 23.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/5 prot., datë 24.2.2021. Gjithashtu me shkresën nr.



Po kështu, Ministria e Drejtësisë ka ndjekur vijimësisht mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për vitin 2020, duke analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e tyre, ndërsa problematikat e evidentuara kanë shërbyer si bazë për të adresuar rekomandime konkrete për vitin 2021.¹⁰ Këto rekomandime i përcillen Prokurorit të Përgjithshëm dhe i bëhen të njohura edhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për administrimin e informacionit, lidhur me luftën kundër kriminalitetit, informacion, i cili i përcillet ministrit të Drejtësisë në kuadër të raportimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve prioritare.

Bazuar në zhvillimet e reja legislative dhe administrative, sikurse miratimi i ndryshimeve në paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit¹¹ dhe vijimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve (*vetting*) risin kërkesën për bashkëpunim dhe ndërveprim efektiv ndërmjet institucioneve, për të siguruar kushtet për konsolidimin dhe intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar në të gjitha format e tij, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në respekt të plotë të lirive dhe të drejtave të individit, barazinë e shtetasve përpara ligjit dhe angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Për sa më sipër, rekomandimet prioritare që Këshilli i Ministrave adreson për t'u ndjekur nga organi i prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2021, jepen në këto drejtime:

Drejtimi i parë: Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit;

Drejtimi i dytë: Lufta kundër korrupsionit;

Drejtimi i tretë: Lufta kundër krimit të organizuar;

Drejtimi i katërt: Respektimi i të drejtave të njeriut;

Drejtimi i pestë: Bashkëpunimi ndërinstitucional.

1. Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit

Pavarësia e prokurorit nga njëra anë dhe përgjegjshmëria profesionale dhe personale nga ana tjetër, janë dy parime bazike në mirëfunksionimin efektiv të organit të prokurorisë. Në këtë konsideratë, roli i prokurorit në procedurën penale, për shkak të lidhjes së ngushtë me të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor, përbën një faktor deciziv në përmbushjen me sukses të politikave penale të shtetit të së drejtës dhe në forcimin e besimit të publikut tek organet gjyqësore në veçanti dhe te sistemi i drejtësisë në tërësi. Ushtrimi i detyrës nga prokurori me profesionalizëm, përgjegjshmëri, shmangia e ndikimeve nga çdo element me natyrë objektive dhe subjektive që mund të vendosë në dyshim pavarësinë e tij, vendosmëria për zbatimin e drejtë të ligjit përbëjnë qëllimin e rekomandimeve që adresohen të ndiqen në këtë drejtim.

Strukturat, mekanizmat e rregullat materiale dhe procedurale në organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, të cilat jetësuan vizionin strategjik dhe normat ligjore të reformës në drejtësi, përbëjnë garanci të shtuar në forcimin dhe konsolidimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit. Kështu, viti 2020 shënoi hapin vijues në historinë e suksesit të kësaj reforme, të materializuar me ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja ligjzbatuese (Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Byroja Kombëtare e Hetimit), të cilat do të krijojnë kushtet e nevojshme për rritjen e profesionalizmit dhe të vlerësimit të veprimtarisë së prokurorëve.

Prokurori i Përgjithshëm luan rol kyç në garantimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së prokurorisë dhe në sigurimin e pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të detyrës.

Krahas Prokurorisë së Posaçme (SPAK)¹², ngritja e strukturës së specializuar të Policisë

212 prot., datë 13.1.2021, ka kërkuar statistikën për vitin 2020 nga Prokuroria e Përgjithshme.

¹⁰ Ministria e Drejtësisë me shkresat e saj nr. 3385/1 prot., datë 5.11.2020 dhe nr. 161 prot., datë 11.1.2021, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2020. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar, me shkresat e saj nr. 968/23, datë 31.12.2020, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 3385/2 prot., datë 5.1.2021 dhe shkresën nr. 968/25 prot., datë 30.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 161/1 prot., datë 31.3.2021.

¹¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, më datë 30.7.2020, emëroi znj. Aida Veizaj, si drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

¹²Mbas kërkesës së bërë nga drejtuesi i SPAK, z. Arben Kraja, Kuvendi ka miratuar, më datë 28.1.2021, numrin e përgjithshëm të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme i cili është 20 prokurorë.

Komisioni i Ligjeve ka miratuar shtimin e numrit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. SPAK-u do të jetë me 20 prokurorë, nga 13 që ka aktualisht, pas kërkesës së bërë nga drejtuesi i këtij institucioni, Arben Kraja, duke marrë kështu edhe miratimin e Komisionit të Ligjeve.

Kjo kërkesë është miratuar gjithashtu edhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendimi do të jetë formal, pasi Kuvendi, në buxhetin e miratuar për SPAK-un, për vitin 2021, ka përcaktuar fondin për prokurorët shtesë të strukturës kundër krimit dhe korrupsionit në të gjitha nivelet.

SPAK-u ka nisur punën në 12 dhjetor 2012 dhe sipas ligjit duhet të përbëhet nga 15 prokurorë, por sot kjo strukturë ka vetëm 13 prokurorë. Për dy prokurorë nuk ka përfunduar ende procedura e emërimit, pasi janë



Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) përbën një gur themeli në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, veçanërisht në korrupsionin e zyrtarëve të lartë, një fenomen i cili përbën sfidën për progresin e Shqipërisë drejt integritetit në Bashkimin Evropian. Gjatë muajit korrik 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 183, datë 30.7.2020, zgjodhi znj. Aida Veizaj si drejtues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, institucion i cili do të ketë në përbërje rreth 60 hetues¹³.

Veprat penale të cilat përfshihen në kompetencën lëndore të SPAK-ut, të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe legjislacioni i posaçëm¹⁴, janë vepra penale me një rëndësi të veçantë, për shkak të kategorisë së veprës penale ose/dhe subjektit nga i cili ato kryhen¹⁵. Fillimi i funksionimit të këtij institucioni, i cili është i pavarur nga organi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, do të adresojë këtë problematikë,

në proces *vettingu*. Me lëvizjen e fundit, SPAK-ut do t'i shtohen edhe 7 prokurorë, pesë të rinj dhe dy që janë në proces rekrutimi.

¹³Byroja Kombëtare e Hetimit më datë 8.9.2020, ka shpallur thirrjen “Për hapjen e aplikimeve për pozicionin e hetuesit të BKH-së”, ku përmes këtij procesi do të përzgjedhen 60 hetues që do të jenë pjesë e BKH-së dhe afati i fundit i aplikimit ishte data 29.9.2020.

Komisioni i Përzgjedhjes, në datën 19.11.2020, mbylli Fazën e Intervistës dhe përzgjedhjes së kandidatëve, për fazat e mëtejshme të konkurrimit, nga e cila janë përzgjedhur **39 kandidatë**. Kandidatët e kualifikuar do të plotësojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit. Deklarata e pasurisë, e plotësuar, do të dërgohet e skanuar, me email, në adresën: bkh.aplikim@spak.al, jo më vonë se data 2.12.2020.

Kandidatët e kualifikuar, do t'i nënshtrohen Testit të Poligrafit. Vendi, data dhe ora e zhvillimit të Testit të Poligrafit dhe udhëzime të hollësishme do të njoftohen në datën 2 dhjetor 2020, në *websites-in* e BKH-së. Më datë 3.2.2021, BKH-ja ka nxjerrë njoftimin ku me përfundimin e fazës së verifikimit të figurës dhe pasurisë së kandidatëve të kualifikuar, do të hapi përsëri konkurrimin për pozicionin e punës “Hetues” për vendet vakante. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, në datën 1.4.2021, mbylli verifikimin e kushteve të sigurisë për kandidatët që konkurrojnë për “Hetues” në Byronë Kombëtare të Hetimit dhe ka vendosur që nga 37 kandidatët:

- 28 (njëzet e tetë) kandidatët kalojnë kushtet e sigurisë;
- 9 (nëntë) kandidatët nuk i kalojnë kushtet e sigurisë.

Aktualisht nuk ka asnjë hetues të emëruar.

¹⁴ Ligji nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

¹⁵ Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale:

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/d, 319/e dhe 319/f;

b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

d) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

duke synuar rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Konkretisht, për periudhën nga momenti i krijimit të saj deri në datën 31.12.2020, rezulton se¹⁶ nga organi i Prokurorisë së Posaçme janë paraqitur të dhëna statistikore, në lidhje me veprat penale që ka në kompetencë lëndore, ku janë hetuar gjithsej 588 procedime penale, nga të cilat 204 procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, 384 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë periudhës kohore të mësipërme dhe 18 procedime penale janë regjistruar kryesisht. Për 24 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjeve, duke shkuar në 564 procedime penale, me 746 persona nën hetim.

Në lidhje me rekomandimin për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, nga të dhënat e përcjella nga organi i prokurorisë¹⁷, lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2020, në zbatim të rezolutës së Kuvendit, datë 18.6.2020, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për zbatim nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht janë miratuar: udhëzimi nr. 11, datë 20.7.2020, “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”; urdhri nr. 112, datë 27.7.2020, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020”.

Gjithashtu, me synimin për të garantuar pavarësinë e prokurorit, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.7.2020, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”; udhëzimin nr. 16, datë 14.12.2020, “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.7.2020, Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”; urdhrin nr. 120, datë

¹⁶ Raporti vjetor 2020, mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

¹⁷ Me shkresat e tyre nr. 968/23 prot., datë 31.12.2020 dhe nr. 968/25 prot., datë 30.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 3385/2 prot., datë 5.1.2021 dhe nr. 161/1 prot., datë 31.3.2021.



8.9.2020, “Për miratimin e disa shtesave në Rregulloren standard të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, me synim organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit në organizimin dhe funksionimin e seksioneve të prokurorive”; me urdhrin nr. 164, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm u miratuan dy “Rregullore standard”, për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, me juridiksion të përgjithshëm, dhe prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, në bashkëpunim me projektin EURALIUS V; urdhrin nr. 136, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme”.

Këto akte nënligjore, të publikuara në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, u janë shpërndarë të gjithë prokurorëve, si dhe drejtuesit e prokurorive, në zbatim të kompetencave të tyre ligjore, janë udhëzuar për marrjen e masave me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit në ushtrimin e funksionit dhe për të siguruar eficiencën, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorive të cilët drejtojnë.

Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, me synim rritjen e bashkëpunimit me institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), në nëntor të vitit 2020, ka përgatitur dhe iniciuar projekt marrëveshjen e bashkëpunimit “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, marrëveshje e nënshkruar nga drejtuesit e këtyre institucioneve në shkurt të vitit 2021.

Me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të llogaridhënies së strukturave të policisë gjyqësore janë nxjerrë akte nënligjore nga Prokurori i Përgjithshëm dhe aktet e përbashkëta me institucionet e tjera. Në këtë kuadër, Prokurori i Përgjithshëm, në lidhje me strukturat e policisë gjyqësore, ka nxitur, mbështetur dhe asistuar Komisionin e Policisë Gjyqësore për miratimin e rregullave në përputhje me ligjin nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Në vijim të këtij bashkëpunimi, Komisioni i Policisë Gjyqësore miratoi, me vendimin nr. 27/1, datë 30.10.2020, “Rregulloren

për sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë dhe integritetin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore”, e cila u është shpërndarë të gjitha prokurorive dhe institucioneve shtetërore që ligji u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore.

Bashkërendimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së policisë gjyqësore, kryerja e analizave të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse ose të agjencive ligjzbatuese janë normuar në dy (2) udhëzime:

1. Udhëzimin nr. 10/2020, “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale”.

2. Udhëzimin nr. 11/2020, “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.

Këto udhëzime kanë për qëllim përmirësimin e ecurisë së hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara dhe normimin dhe unifikimin e masave administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, për rritjen e efektivitetit në hetimet pasurore dhe financiare, për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale.

Prokuroria e Përgjithshme ka nxitur bashkëpunimin me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe ka kontribuar për të finalizuar, në dhjetor 2020, projekt rregulloren “Për caktimin e rregullave për trajnimin fillestar për hetimin e personave të përgjigdhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore”, i miratuar nga ky komision në janar 2021. Gjithashtu, është ndihmuar Komisioni i Policisë Gjyqësore për përgatitjen e kalendarit të trajnimit fillestar të tyre.

Rritja profesionale është vlerësuar si domosdoshmëri nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm për forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, përfshirë dhe oficerët e policisë gjyqësore, për të cilët Prokuroria e Përgjithshme është duke punuar në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore për të finalizuar kuadrin normativ, për trajnimin fillestar dhe atë vazhdues të Oficerëve të Policisë Gjyqësore.



Prokuroria e Përgjithshme, pasi ka bërë një vlerësim të nevojave për trajnim gjatë muajit korrik 2020, pavarësisht orientimit, nëpërmjet udhëzimit nr. 11/2020, për drejtuesit e prokurorisë, për të zhvilluar trajnime të përbashkëta të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore, ka ndërmarrë edhe vetë rol proaktiv për zhvillimin e trajnimeve.

Në vijim, është miratuar një cikël trajnimesh me dy modele, zhvilluar në datat 14 – 15 dhjetor, me temë “Pastrimi i parave dhe hetimi pasuror dhe financiar”, me pjesëmarrjen e 69 përfaqësuesve nga të gjitha institucionet ligjzbatuese, dhe në datat 17 – 18 dhjetor, me temë “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën”, me pjesëmarrjen e 79 përfaqësuesve.

Sa më sipër, pavarësisht arritjeve pozitive dhe adresimit të sfidave në vlerësim të prioritetëve të BE-së, politikave në fushën e të drejtës, **me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit, Këshilli i Ministrave rekomandon:**

1. Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

2. Nxitjen e prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e OPGJ-ve, si dhe evidentimin e rasteve që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbushjen e detyrave që u ngarkon ligji.

3. Marrjen e masave për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në fusha specifike, sipas ndarjes së tyre në seksione brenda prokurorisë.

4. Marrjen e masave për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve.

5. Forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe të llogaridhënies së prokurorit.

6. Marrjen e masave, me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave.

7. Marrjen e masave për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit Penal në praktikë, lidhur me situatën e pandemisë së COVID-19 dhe dhunën në familje.

Lufta kundër korrupsionit

Një ndër qëllimet e reformës në drejtësi, e materializuar me ngritjen e institucioneve të reja, ka qenë ashpërsimi i veprimeve për të luftuar pa kompromis dhe me eficiencë fenomenet shqetësuese të shoqërisë shqiptare, ku një ndër to, dhe me ndjeshmërinë më të lartë për çdo qytetar dhe që cenon drejtpërdrejt imazhin e shtetit të së drejtës, është fenomeni i korrupsionit në çdo nivel të shoqërisë. Rekomandimet në këtë drejtim adresojnë nevojën për forcimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen e domosdoshme për institucionet e reja si Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar - SPAK-u, Byroja Kombëtare e Hetimit – BKH-ja, dhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese brenda vendit.

Këshilli i Ministrave, vitet e fundit, ashtu si dhe gjatë vitit 2020, ka rritur fokusin e saj në luftën kundër korrupsionit dhe ka ndërmarrë një sërë masash, në lidhje me luftimin e aktiviteteve korruptive në kuadër të Strategjisë Ndërsëktoriale Antikorrupsion 2015–2023¹⁸.

Sipas vendimit nr. 506, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, pika 4, parashikon se: Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.¹⁹

Në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit kundër korrupsionit 2020–2023, Ministria e Drejtësisë ka publikuar raportin vjetor, lidhur me ecurinë në luftën kundër korrupsionit²⁰. Ndërkohë,

¹⁸ Miratuar me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit, për periudhën 2015–2020’ dhe miratimin e ‘Planit të Veprimit 2020–2023’, në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit 2015–2023 të Pasaportës së Indikatorëve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 7.7.2020.

¹⁹ Miratuar me vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, miratuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 20.3.2015.

²⁰ Raporti Vjetor i Monitorimit të SNKK-së, janar–dhjetor 2020, publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë:



në bashkëpunim me të gjitha institucionet publike të përfshira në strategjinë kundër korrupsionit dhe me asistencën teknike të Bashkimit Evropian është hartuar Plani i Veprimit për periudhën 2019–2023²¹.

Gjithashtu pranë Ministrisë së Drejtësisë funksionon edhe një strukturë e veçantë antikorrupsioni: Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion (Drejtoria Antikorrupsion), si pjesë e strukturës organike të Ministrisë së Drejtësisë, e cila u krijua me urdhrin e Kryeministrit nr. 114, datë 4.9.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”.

Drejtoria Antikorrupsion planifikon, koordinon e përcakton instrumentet e domosdoshëm për implementimin e politikave të fushës, për zgjidhjen dhe zhvillimin e programeve në fushën e antikorrupsionit, si dhe krijimin e bazës së infrastrukturës që do t'i paraprijë këtij zhvillimi, si dhe është përgjegjëse për zhvillimin e dokumenteve të politikës, hartimin e planeve të veprimit, zbatimin e masave të politikave antikorrupsion, hartimin e raporteve të monitorimit.

Në vijim të konsolidimit të luftës kundër korrupsionit, me urdhrin nr. 106, datë 25.7.2019, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion të Kryeministrit”, u krijua Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion, strukturë e shtrirë në nivel qendror dhe lokal, nën drejtimin e ministrit përgjegjës për luftën kundër korrupsionit (Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit).

Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion është një risi për vendin tonë dhe do të shërbejë për mbledhjen, analizën dhe koordinimin e gjithë informacionit për rastet korruptive të referuara nga burime të ndryshme, raportimin pranë drejtorisë së dedikuar antikorrupsion/Sektorit i Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, si dhe vlerësimin e rrezikut kundër korrupsionit dhe propozimin e rregullave e

të procedurave për menaxhimin e këtij rreziku. Qëllimi dhe arsyeja e ngritjes së një strukture të tillë është parandalimi dhe goditja e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore përmes një mekanizimi referimi, i cili do të bashkëpunojë dhe raportojë në drejtorinë e dedikuar antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në mars 2021, “Volumi 1 - Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike”,²² dhe “Volumi 2- Pastrimi i parave dhe krimet financiare”²³, ndër të tjera përmend se: “Qeveria e Shqipërisë nuk bëri asnjë përparim të dukshëm drejt pengimit të pastrimit të parave dhe krimeve financiare në vitin 2020. Shqipëria mbetet e ndjeshme ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, rrjetet e krimit të organizuar dhe institucionet e dobëta ligjore dhe qeveritare. Vendi ka një ekonomi të madhe parash dhe sektori informal, me flukse të konsiderueshme parash nga jashtë në formën e remitancave dhe investimeve të ndryshme. Krimet kryesore të gjenerimit të të ardhurave në Shqipëri përfshijnë trafikimin e drogës, evazionin fiskal dhe kontrabandën. Organizatat kriminale shqiptare kanë lidhje me rrjetet që veprojnë në Evropë dhe Amerikën e Jugut.

Reformat e vazhdueshme gjyqësore, duke përfshirë vettingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të çrrënjësuar korrupsionin nga sektori i drejtësisë dhe krijimin e njësisë të shumta policore të specializuara që synojnë krimet financiare dhe ekonomike, kanë përmirësuar perspektivat e Shqipërisë për adresimin e pastrimit të parave.

Shqipëria duhet të zbatojë në mënyrë efektive ligjet ekzistuese dhe të vazhdojë të zhvillojë kapacitetin e policisë dhe prokurorëve të saj për t'u përqendruar në korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimet ekonomike.

Personeli i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili është krabu hetimor i SPAK-ut, ka pësuar vonesa, por po vazhdon. Reformat thelbësore të kodit penal në 2016 dhe 2017, kishin për qëllim të ndërtonin një sistem më efektiv, por zbatimi i këtyre reformave është ende një sfidë. Përkundër një numri të konsiderueshëm të hetimeve të pastrimit të parave në vitet e fundit, numri i ndjekjeve penale të lidhura mbetet i ulët.

Sundimi i dobët i ligjit, korrupsioni dhe një shkallë e lartë e papunësisë janë drejtuesit kryesorë pas problemit të kontrollit të drogës në Shqipëri. Grupet shqiptare të krimit

<http://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndërsektoriale-kundër-korrupsionit/>. Gjatë vitit 2020 Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion nuk ka pasur asnjë aktivitet dhe nuk ka marrë asnjë masë administrative, sikurse viti 2019 ku u rekomanduan 168 masa administrative, 192 masa disiplinore dhe 36 referime në prokurori. Në Kryeministri është ngritur “Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievaizion”.

²¹Planit i veprimit 2019–2023 është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë: <http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/ministria-e-drejtësisë-koordinatori-kombëtar-kundër-korrupsionit-përfundoj-procesin-e-rishikimit-të-planit-të-veprimit-2019-2023-në-zbatim-të-strategjisë-ndërsektoriale-kundër-korrupsionit/>.

²² 2021 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 1 drug and Chemical Control, publikuar në datën 2 mars 2021, në faqen [International Narcotics Control Strategy Report - Volume I \(state.gov\)](https://www.state.gov/international-narcotics-control-strategy-report-volume-1).

²³2021 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2 Money, Laundering and financial crimes, publikuar në datën 2 mars 2021, në faqen zyrtare: [Money Laundering - 2021 INCSR Vol 2 Final to GPS 2-17-21.docx \(state.gov\)](https://www.state.gov/international-narcotics-control-strategy-report-volume-2).



të organizuar vazhdojnë të pastrojnë të ardhurat në Shqipëri dhe të kontribuojnë në korrupsionin në vend. Reformat në drejtësinë penale në Shqipëri synojnë të ndjekin penalisht dhe të dënojnë kriminelët e trafikimit të drogës duke përdorur lidhjen e krimit të organizuar. Prokurorët tani kombinojnë akuzat e lidhura me drogën me akuzat e krimit të organizuar.

Progres raporti për Shqipërinë 2020²⁴ për luftën kundër korrupsionit konstaton se: *Shqipëria ka bërë një progres të mirë në luftën kundër korrupsionit. Autoritetet shqiptare forscan kapacitetet operacionale, koordinuese dhe monitoruese në luftën kundër korrupsionit. Shqipëria ka vazhduar përpjekjet e saj drejt krijimit të një rekordi të qëndrueshëm në 6 betime, ndjekje penale dhe gjykim të çështjeve të korrupsionit. Megjithatë verifikimi i anëtarëve të gjyqësorit është një proces administrativ, është e rëndësishme të vlerësohen rezultatet konkrete derisa Shqipëria të luftojë korrupsionin. Janë bërë përpjekje të mëtijshme drejt vendosjes së një rekordi solid në luftën kundër korrupsionit, megjithatë mbetet një objektiv afatgjatë që vazhdon të kërkojë përpjekje të mëtijshme të strukturuar dhe të qëndrueshme. Ndërsa numri i betimeve në vazhdim mbetet i lartë, deri më sot, dënimet përfundimtare në rastet që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë mbeten të kufizuara. Organet e porsa themeluara të specializuara antikorrupsion (SPAK dhe Gjykatat Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) pritet të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin. Megjithatë, në përgjithësi, korrupsioni mbetet i përhapur dhe është një shqetësim serioz.*

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2020²⁵, Shqipëria ka pësuar një rënie të lehtë në renditjen e shteteve për sa i përket korrupsionit në sektorin publik, duke u rankuar në vendin e 104, nga vendi i 106 që ka qenë në vitin 2019.

Fillimi i funksionimit dhe efektiviteti i Prokurorisë së Posaçme përbën një rol të padiskutueshëm në fushën e ndëshkimit të korrupsionit, të zyrtarëve të lartë dhe në gjyqësor, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave me origjinë kriminale, aseteve kriminale apo pasurisë së pajustificuar të vënë nga korrupsioni zyrtar, parandalimin e korrupsionit në strukturat

shtetërore dhe për rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, krijimi dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit përbën një hallkë të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, si një njësi e posaçme dhe e specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, e cila vepron pranë Prokurorisë së Posaçme.

Nga të dhënat e paraqitura nga Prokuroria e Përgjithshme rezulton se në kuadër të marrjes së masave për forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme më datë 15.12.2020, kanë nënshkruar Aktin e Koordinimit Institucional “Për rritjen e eficiencës nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj”.

Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Penale²⁶, i kanë kaluar SPAK-ut për kompetencë lëndore nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e, si dhe nenet 328 dhe 328/b, të Kodit Penal, dispozita të cilat më herët kanë qenë në kompetencën e Prokurorisë së Përgjithshme.

Gjithashtu, në lidhje me veprat penale në fushën elektorale, nëpërmjet ndryshimeve me ligjin nr. 147/2020, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në kompetencën lëndore të SPAK-ut kanë kaluar përkatësisht nenet 328, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, dhe 328/b, “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, të Kodit Penal.

Nga të dhënat e sjella nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), rezulton se nga ky organ janë hetuar gjithsej 588 procedime penale, nga të cilat 204 procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga ish Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa 384 procedime penale

²⁴ Albania 2020 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020, Communication on EU Enlargement Policy.

²⁵ Publikuar në faqen zyrtare të Transparency International: https://www.transparency.org/whatwedo/publication/corruption_perceptions_index_2020.

²⁶ Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017 dhe ligjin nr. 147/2020, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.



janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme. Nga 588 procedime penale të hetuara për vitin 2020, për 24 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke pasur në hetim për këtë periudhë kohore gjithsej 564 procedime penale në hetim, me 746 persona nën hetim.

Gjatë vitit 2020 të ushtrimit të veprimtarisë së tij Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), ka regjistruar 238 procedime penale në fushën e korrupsionit, ose rreth 42.2% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e korrupsionit. Numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara e ka neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, me 98 procedime penale të regjistruara. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezultojnë se janë dërguar për gjykim 50 çështje, 22 çështje janë pushuar, 4 çështje janë pezulluar, 28 çështje të transferuara dhe 134 çështje rezultojnë të mbetura në hetim.

Nga 50 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2020, të cilët zënë rreth 21.01% të çështjeve të hetuara në fushën e korrupsionit, rezultojnë se numri i të hetuar/pandehur ka qenë 95 persona. Nga këto çështje për 8 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg”, për 17 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” dhe për 33 persona është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Gjithashtu, numrin më të lartë të çështjeve të dërguara për gjykim e ka neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, me 25 çështje të dërguara për gjykim. Për vitin 2020 rezultojnë se ka përfunduar gjykimi për 20 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 29 të pandehurish.

Ndërkohë vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa i përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të korrupsionit, pasi në total për të gjitha veprat penale rezultojnë se janë regjistruar vetëm 18 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme. Në vitin 2021, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar rezultojnë të ketë të mbartura për hetim 348 procedime penale me 212 persona nën hetim. Nga këto hetime të mbartura rezultojnë se numri prej 134 procedime penale me 54 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të

korrupsionit, ose rreth 38.5% e çështjeve të mbartura për hetim. Gjithashtu, lidhur me përdorjen e metodave speciale të hetimit rezultojnë se përgjatë vitit 2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 91 procedime penale, ku pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë ato çështje të hetuara për veprat penale të korrupsionit²⁷, me 49 procedime penale, 368 pajisje fundore dhe 322 subjekte.

Lidhur me zbatimin e ligjit antimafia²⁸, nga Prokuroria e Posaçme, për periudhën 19.12.2019 – 31.12.2020, janë hetuar gjithsej 313 materiale/verifikime pasurore, nga të cilët 298 materiale pasurore janë regjistruar në periudhën 19.12.2019 – 31.12.2019, ardhur për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe 15 materiale pasurore për periudhën 1.1.2020 – 31.12.2020, të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Për periudhën 19.12.2019 – 31.12.2020, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për sekuestrim, në vlera të konsiderueshme si të hollash, pasurish të luajtshme, të cilat janë pranuar nga **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**. Ndërkohë janë paraqitur në gjykatë, 8 kërkesa për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, të cilat janë pranuar.

Në zbatimin të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”²⁹, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Operacioni Forca e Ligjit (njohur si OFL) janë referuar gjithsej 251 materiale për të cilat nga SPAK-u janë paraqitur në gjykatë 120 kërkesa për sekuestrim pasurie, ku 68 kanë qenë sekuestro me kërkesë të prokurorit sipas parashikimeve të nenit 18 të aktit

²⁷ Konkretisht nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, të Kodit Penal.

²⁸ Ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

²⁹ Miratuar me ligjin nr. 18/2020, datë 5.3.2020.



normativ dhe 52 kanë qenë vlefësime të sekuestrimeve të kryera me emergjencë nga policia gjyqësore.

Nga prokurorët e posaçëm përgjatë vitit 2020 sipas parashikimeve të nenit 19 të aktit normativ, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është shprehur me vendim deri më datë 31.12.2020, vetëm për 117 prej tyre (115 pranime dhe 2 mospranime), ndërsa 3 prej tyre kanë kaluar për shqyrtim për vitin 2021.³⁰

Në vazhdim të procesit gjyqësor, përgjatë vitit 2020 janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme në gjykatë 62 kërkesa për konfiskim pasurie³¹, ku për 27 prej tyre Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka pranuar 25.

Referuar analizës për vitin 2020 që Ministria e Drejtësisë ka kryer në bazë të të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme³², rezultojnë se:

- Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit të cilat kanë mbetur në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultojnë se gjatë vitit 2020 janë hetuar 1751 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit³³, me një numër total prej 310 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 172 persona. Rezultojnë se ka një rënie të lehtë të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2019, me 2 çështje më pak, ulje të dukshme të numrit të personave nën hetim me 91 persona më pak nën hetim dhe një ulje prej 33 personash të marrë si të pandehur më pak, krahasuar me të dhënat e vitit të

kaluar³⁴. Por pavarësisht kësaj, rastet që dërgohen për gjykim mbeten gati në të njëjtat nivele ose krahasuar me numrin total rezultojnë më e ulët. Për vitin 2020 janë dërguar për gjykim vetëm 80 procedime penale ose rreth 4,6 % të çështjeve të hetuara, me 163 të pandehur. Krahasuar me vitin 2019³⁵, konstatohet një rënie e dukshme e numrit të çështjeve me 10 çështje më pak dhe 31 të pandehur më pak. Për vitin 2020 ka përfunduar gjykimi për 55 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 106 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 81 persona, krahasuar me vitin 2019³⁶, rezultojnë se ka një rritje të lehtë me 2 çështje më shumë, dhe një rënie të numrit me 9 persona të pandehur më pak dhe 19 të dënuar më pak.

-Ndërsa nga ana tjetër, nëse i referohemi hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, konkretisht në vitin 2020, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuar është 39490³⁷, nga të cilat vetëm 59³⁸ janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori, ose rreth 0,15% e numrit të përgjithshëm. Nga 59 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 4 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetura në kompetencë, ose rreth 6.8 % e numrit të çështjeve kryesisht, ku të vetmet çështje të regjistruara janë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, me 4 çështje. Krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara kryesisht në 2019 për të njëjtat vepra penale konstatohet një rritje e lehtë me 1 çështje, ku në vitin 2019 kanë qenë të regjistruara vetëm 3 çështje kryesisht. Krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë në rënie në numrin e çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit, pavarësisht rekomandimeve³⁹.

³⁰ Lloji i pasurive të sekuestruara janë: - 373 pasuri të paluajtshme; - 233 pasuri të luajtshme; - 51 subjekte/aktivitete tregtare; - 4 llogari bankare.

³¹ Lloji i pasurisë së konfiskuar: - 8 pasuri të paluajtshme; - 29 pasuri të luajtshme.

³² Me shkresën nr. 71/1 prot., datë 3.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1526 prot., datë 12.3.2021.

³³ Bazuar në 5 veprat penale në fushën e korrupsionit që kanë mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/a, 164/b, 248, 256 dhe 257/a të Kodit Penal), nga 22 vepra që janë analizuar në vijueshmëri deri në fund të vitit 2019 kur ka filluar funksionimin Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, referuar ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, dhe ligjin nr. 147/2020, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, ku në nenin 75/a të këtij Kodi përcaktohen se i kanë kaluar për kompetencë Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nenet: 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e, si dhe nenet 328 dhe 328/b, të Kodit Penal;

³⁴ Në 2019 për 5 veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultojnë se ishin 1753 çështje në hetim me 401 persona nën hetim dhe 205 të pandehur.

³⁵ Në vitin 2019 numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto 5 vepra penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme ka qenë 90 (5.13% e rasteve) me 194 të pandehur.

³⁶ Në vitin 2019, për 5 veprat penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme kishin përfunduar gjykimin 53 çështje penale me 115 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 100 persona.

³⁷ Një ulje prej 7851 referimesh krahasuar me vitin 2019, ku ishin në total 47341 referime.

³⁸ Një ulje prej 56 çështje më pak krahasuar me vitin 2019.

³⁹ Në vitin 2019 janë 3 çështje të regjistruara kryesisht për 5 veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetura në kompetencë.



-Rezultoni një rritje e numrit të çështjeve për veprat penale në fushën e pastrimit të parave regjistruar pranë Prokurorisë së Përgjithshme (rreth 21,2 % më tepër) krahasuar me të dhënat e vitit 2019 pavarësisht rekomandimit për shtimin e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe rritjes së cilësisë së këtyre hetimeve. Ndërsa, në total numri i çështjeve të regjistruara (kryesisht dhe me referim) për veprat penale të pastrimit të parave⁴⁰ është 286 çështje, me një numër total prej 59 personash nën hetim nga të cilët vetëm 23 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2019⁴¹, rezultoni se ka një rritje prej 50 çështjesh të regjistruara më shumë, me 31 persona nën hetim më shumë dhe rritje të numrit të të pandehurve me 10 të pandehur më shumë.

- Ndërsa, nga të dhënat statistikore të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme, rezultoni se nga totali i çështjeve të filluara kryesisht, për veprën penale të pastrimit të parave rezultoni vetëm 1 çështje⁴², e cila është regjistruar për veprën penale “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, neni 287/b i K. Penal, dhe nuk është regjistruar asnjë çështje për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287 i K. Penal. Pavarësisht rekomandimeve, numri i çështjeve kryesisht për këtë kategori vijon të mbetet shumë i ulët.

- *Lidhur me hetimet proaktive në veprat e korrupsionit*, duke mbajtur në konsideratë se pjesa më e madhe e veprave të korrupsionit kanë kaluar në kompetencë të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar – SPAK-un, dhe duke pasur parasysh se për veprat në këtë fushë që mbeten në juridiksion të prokurorive të përgjithshme nuk lejohen kryerja e veprimeve proaktive, për sa i përket aplikimit të nenit 294/a, gjatë vitit 2020, nuk ka pasur hetime me veprime simuluese, për vepra të korrupsionit në kompetencë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

Duke mbajtur në konsideratë problematikat sa më sipër të evidentuara, prioritetet e përbashkëta, **Këshilli i Ministrave për forcimin e luftës kundër korrupsionit rekomandon:**

1. Forcimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, rritjen e numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave.

2. Mbështetja e Prokurorisë së Posaçme për sa i përket hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, veçanërisht për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në nivele të larta të politikës dhe administratës publike.

3. Shtimin e numrit të hetimeve proaktive (çështje të filluara kryesisht) me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit.

4. Shtimin e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimin e aseteve të sekuestruara/konfiskuara.

5. Zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore.

6. Ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe SPAK-un.

Lufta kundër krimit të organizuar

Një tjetër fenomen shqetësues është krimi i organizuar, një veprimtari që për shkak të përmasave në pjesëmarrje, shtrirjes në kohë dhe përhapjes në terren duke shkuar përtej kufijve kombëtarë, bëhet çdo vit më i sofistikuar, më i përhapur dhe më i vështirë për t'u cilësuar. Për këtë qëllim, rekomandimet në këtë drejtim janë fokusuar në nxitjen e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar sidomos me agjencitë ligjzbatuese e të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar, shkëmbim të shpejtë të informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta në kuadër të efektivitetit të hetimit penal, mbrojtjen e të dhënave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përdorimin e metodave dhe të teknologjisë, si dhe rritjen e profesionalizmit të prokurorëve dhe

⁴⁰ Nenet 287, 287/a dhe 287/b të Kodit Penal.

⁴¹ Në vitin 2019 për këto tre vepra penale janë regjistruar 236 çështje me 28 persona nën hetim dhe 13 të pandehur.

⁴² Ka një ulje me 1 çështje krahasuar me vitin 2019.



oficerëve të policisë gjyqësore. Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe terrorizmit, është shumë i rëndësishëm për të luftuar këtë fenomen kriminal.

Dokumenti i publikuar nga FATF-ja,⁴³ në shkurt të 2021, thekson: që nga Shkurti 2020, kur Shqipëria bëri një angazhim të nivelit të lartë politik për të punuar me FATF-në dhe Moneyval-in për të forcuar efektivitetin e regjimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Shqipëria ka ndërmarë hapa drejt përmirësimit të tyre, por duhet të vazhdojë të punojë në zbatimin e planit të saj të veprimit për të adresuar mangësitë e saj strategjike, duke përfshirë: 1. finalizimin e një projekti për të zvogëluar ekonominë informale, të bazuar në para dhe për të regjistruar pronësinë e të gjitha pasurive të paluajtshme; 2. përmirësimi i trajtimit në kohë të kërkesave reciproke të ndihmës juridike; 3. vendosja e mekanizmave më efektive për të zbuluar dhe parandaluar kriminelët që të mbajnë ose kontrollojnë Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jo-Financiare (DNFBP), duke përfshirë forcimin e kompetencave të autoriteteve kompetente për të zbatuar sanksione; 4. duke siguruar që informacioni i saktë dhe i azhurnuar ligjor dhe përfitues i pronësisë është i disponueshëm në kohë; 5. rritja e numrit dhe përmirësimi i sofistikimit të ndjekjeve penale dhe konfiskimeve për pastrimin e parave, veçanërisht në rastet që përfshijnë vepra penale paraprake të huaja ose pastrim parash të palëve të treta; dhe 6. përmirësimin e zbatimit të sanksioneve financiare të synuara përmes veprimeve mbikëqyrëse që identifikojnë dhe korrigjojnë mangësitë e pajtueshmërisë.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në mars 2021, “Volumi 1-Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike”,⁴⁴ dhe “Volumi 2-Pastrimi i parave dhe krimet financiare”⁴⁵, vë theksin te zbatimi me efektivitet i ligjit dhe reformës në drejtësi, nevoja e rritjes së hetimit dhe ndjekjeve penale, dënimit të rasteve të veprave penale për trafikim të lëndëve narkotike (droga të forta), hetimin e pastrimit të parave të krimit të

organizuar në pasuri të paluajtshme, si dhe sekuestrimin e tyre. Konkretisht në këtë raport theksohet se: “Reformat e vazhdueshme gjyqësore, duke përfshirë vettingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të errënjësuar korrupsionin nga sektori i drejtësisë dhe krijimin e njësisë të shumta policore të specializuara që synojnë krimet financiare dhe ekonomike, kanë përmirësuar perspektivat e Shqipërisë për adresimin e pastrimit të parave. Ndryshimet e fundit ligjore dhe të politikave kanë përmirësuar aftësinë e Shqipërisë për të luftuar pastrimin e parave dhe krimet financiare, megjithëse zbatimi ka qenë i paqëndrueshëm. Ligji Antimafia u ndryshua në vitin 2020 për të përmirësuar menaxhimin e pasurive të konfiskuara.

Shqipëria duhet të zbatojë në mënyrë efektive ligjet ekzistuese dhe të vazhdojë të zhvillojë kapacitetin e policisë dhe prokurorëve të saj për t'u përqendruar në korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimet ekonomike.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila u bë operacionale në Dhjetor 2019, ka regjistruar suksese në luftën kundër trafikimit dhe krimit të organizuar dhe sekuestrimit të pasurive të pastruara.

Grupet shqiptare të krimit të organizuar vazhdojnë të pastrojnë të ardhurat në Shqipëri dhe të kontribuojnë në korrupsionin në vend. Reformat në drejtësinë penale në Shqipëri synojnë të ndjekin penalisht dhe të dënojnë kriminelët e trafikimit të drogës duke përdorur lidhjen e krimit të organizuar. Prokurorët tani kombinojnë akuzat e lidhura me drogën me akuzat e krimit të organizuar.

Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet e reformës në drejtësi dhe të punojë për të gërryer ndikimin e krimit të organizuar.

Progresi raporti 2020,⁴⁶ në lidhje me pastrimin e parave konstaton se: “Shqipëria ka bërë përpjekje për të adresuar mangësitë në pajtueshmërinë teknike të identifikuar në raportin e vlerësimit të ndërsjellë të Moneyval-it 2018 për Shqipërinë, i cili, me gjithë mangësitë, në lidhje me efektivitetin, shkaktoi referenca në Shqipëri në Grupin e Rishikimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Shqipëria intensifikoi përpjekjet e saj për të adresuar shumicën e rekomandimeve të Moneyval-it gjatë vitit 2019. Një “paketë Moneyval-i” u miratua në Parlament në Qershor 2019 i cili përfshinte ndryshime në katër ligje ekzistuese, në lidhje me: i. parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit; ii. masa kundër financimit të terrorizmit; iii.

⁴³ Financial Action Task Force 2021, publikuar në shkurt 2021, në faqen: <https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/documents/increased-monitoring-february-2021.html#albania>.

⁴⁴ 2021 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 1, Drug and Chemical Control, publikuar në datën 2 mars 2021, në 2021 INCSR-Volume I: Drug and Chemical Control (As submitted to Congress) - United States Department of State.

⁴⁵ 2021 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2, Money laundering and financial crimes, publikuar në datën 2 mars 2021, në faqen zyrtare: 2021 INCSR-Volume II: Money Laundering (As submitted to Congress) - United States Department of State.

⁴⁶ “Albania 2020 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020 Communication on EU Enlargement Policy” publikuar në datën 6.10.2020, në faqen: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf



procedurat tatimore; dhe iv. Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ai përfshiu gjithashtu miratimin e një ligji të ri mbi administrimin e pasurive të sekuestruara. Një ligj i ri mbi masat kufizuese ndërkombëtare u miratua në nëntor. Si njohje e këtyre përpjekjeve, Shqipëria u modernizua në gjashtë rekomandime në seancën plenare të Moneyval-it në dhjetor. Për shkak të faktit se progresi jo i mjaftueshëm pozitiv dhe i prekshëm mund të demonstrohej në lidhje me adresimin e të gjitha mangësive strategjike të identifikuar, gjithashtu, në lidhje me zbatimin efektiv të kornizës në fuqi, FATF e ka vendosur Shqipërinë në 'listën gr', që do të thotë se vendi është zotuar të zgjidhë mangësitë e identifikuar strategjike brenda kornizave kohore të rëna dakord dhe i nënshtrohet një monitorimi të shtuar. Shqipëria duhet të përmbushë rekomandimet e saj me shpejtësi dhe të sigurojë që veprimtaritë që i nënshtrohen pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe krimit të organizuar nuk përfitojnë nga amnistia fiskale e propozuar. Shqipëria duhet të vazhdojë zbatimin e rekomandimeve të raportit Moneyval dhe harmonizimin e legjislacionit me acquis e BE-së për pastrimin e parave / luftimin e financimit të terrorizmit;

Referuar analizës për vitin 2020 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezultojnë se:

Lidhur me veprat penale në fushën e krimit të organizuar në bazë të ndryshimeve ligjore në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, i kanë kaluar Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

Në raportin vjetor 2020 mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezultojnë se gjatë vitit 2020 të ushtrimit të veprimtarisë së tij, kjo strukturë ka regjistruar 164 procedime penale në fushën e krimit të organizuar, ose rreth 29.1% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e krimit të organizuar. Numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara e kanë grupi veprave penale të neneve (283/a “Trafikimi i narkotikëve”, 333/a “Grupi i strukturuar kriminal”, 334 “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”) me 64 procedime penale të regjistruara. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezultojnë se janë dërguar për gjykim 16 çështje, 2 çështje janë pushuar, 14 çështje janë pezulluar, 21 çështje të transferuara dhe 111 çështje rezultojnë të mbetura në hetim.

Nga 16 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2020, të cilët zënë rreth 9.75% të çështjeve të hetuara në fushën e krimit të organizuar, rezultojnë se numri i të hetuar/pandehur ka qenë 113 persona. Numrin më të lartë të çështjeve të dërguara për gjykim, njësoj si numri i procedimeve penale të regjistruara e kanë grupi veprave penale të neneve (283/a “Trafikimi i narkotikëve”, 333/a “Grupi i strukturuar kriminal”, 334 “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”) me 6 çështje të dërguara për gjykim. Nga këto çështje për 106 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg”, për 3 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” dhe për 2 persona është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Për vitin 2020, rezultojnë se ka përfunduar gjykimi për 12 çështje penale për veprat penale kundër krimit të organizuar me një numër prej 63 të pandehurish. Gjithashtu, lidhur me hetimet e mbartura për vitin 2021, nga SPAK-u, rezultojnë se 111 procedime penale janë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar me 93 persona nën hetim, nga të cilët 56 prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg”, ose rreth 31.9% e çështjeve të mbartura për hetim.

Lidhur me përdorjen e metodave speciale të hetimit rezultojnë se përgjatë vitit 2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 91 procedime penale, ku për çështjet penale të hetuara për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike (283/a/2, 333/a, 334) me 36 procedime penale, 935 pajisje fundore dhe 788 subjekte.

Ndërkohë vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa i përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të krimit të organizuar, pasi në total për të gjitha veprat penale rezultojnë se janë regjistruar vetëm 18 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme.

Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme⁴⁷ për zbatimin e rekomandimeve prioritare rezultojnë se:

- Në kuadër të “Hetimeve efektive nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe

⁴⁷Me shkresën nr. 968/25 prot., datë 30.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 161/1 prot., datë 31.3.2021.



rritja e hetimeve proaktive” gjatë vitit 2020, në zbatim të kërkesave dhe procedurave ligjore, janë kryer hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 630 procedimeve për veprat penale kundër trafikëve të paligjshme (narkotikëve, personave, armëve/municioneve), përfshi edhe veprat penale kundër narkotikëve, pastrimit të parave dhe krimeve të rënda në kompetencë lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin e kaluar rezultoi një rritje me 2 herë më shumë të procedimeve penale.

- Prokurorët kanë pasur rol aktiv si në regjistrimin e procedimeve, dhënien e autorizimeve ose kur mbi kërkesën e tyre me vendime gjyqësore është autorizuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes për zbatimin e tyre. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu edhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 709 personave të dyshuar në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

- Gjithashtu, me rëndësi vijon të mbetet zbatimi i kuadrit ligjor mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave kriminale⁴⁸ me qëllim ndërprerjen e të ardhurave të grupeve kriminale, e mundësive për të ndërvepruar në terren apo për t'i shpëtuar drejtësisë. Lidhur me sekuestrimin e aseteve kriminale, përgjatë vitit 2020, në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” janë kryer sekuestime pasurie mbi kërkesën e prokurorëve me vendimet gjyqësore, në kuadrin e 5 procedimeve penal. Gjatë po kësaj periudhe në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, në kuadrin e hetimit pasuror, prokurorët kanë kërkuar për 4 procedime, sekuestrimin e pasurisë, të pranuar nga gjykata. Sërish përmendet fakti që në këto të dhëna ndikon

fakti i kalimit të çështjeve Prokurorisë së Posaçme referuar kompetencës lëndore të saj.

- Në kuadër të strukturës policore Operacioni Forca e Ligjit (OFL)⁴⁹, janë trajtuar 308 praktika, nëpërmjet të cilave është kërkuar verifikimi dhe përcjellja e dokumentacionit për 951 shtetas shqiptar, dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me *Eurojust*-in, janë trajtuar 28 praktika (kërkesa për asistencë), nga të cilat 21 kërkesa janë dërguar nga prokurorët e vendeve të BE-së të atashuar në *Eurojust*, ndërsa 7 kërkesa janë përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme në *Eurojust*, me qëllim lehtësimin e dhënies së ndihmës juridike në kohë reale.

- Në zbatim të udhëzimit nr. 11/2020, sipas të dhënave statistikore dhe informacionit të disa prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm rezultoi se, në Prokurorinë e Posaçme janë transferuar 64 procedime/referime penale, kryesisht për krimet kundër jetës, kalimit të paligjshëm të kufirit, trafikimit të narkotikëve dhe veprave penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie, ku kryerja e hetimeve proaktive ka çuar në zbulimin e ekzistencës së elementeve të bashkëpunimit të veçantë, për kryerjen e hetimeve të mëtejshme në kuadrin e veprimtarisë kriminale të organizuar.

- Për vitin 2020, në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” janë kryer sekuestime pasurie mbi kërkesën e prokurorëve, në kuadrin e 5 procedimeve penale.

- Në lidhje me pastrimin e parave dhe hetimin financiar e pasuror, në zbatim të rekomandimeve dhe planit të veprimit të ICGR-së/FATF-së në datën 15.7.2020, Prokurori i Përgjithshëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Brendshëm, nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve me origjinë kriminale. Në vijim të këtij memorandumit, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin nr. 10, datë 17.7.2020, “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar,

⁴⁸ Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

⁴⁹ Referuar të dhënave në shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme nr. 968/25 prot., datë 30.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 161/1 prot., datë 31.3.2021.



financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale”, nëpërmjet të cilit, në 1.9.2020, janë krijuar seksionet e posaçme për hetimin e pastrimit të parave, krimin financiar dhe hetimet pasurore në shtatë prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, ndërsa në pesëmbëdhjetë prokurori të tjera është caktuar nga një prokuror për ndjekjen e këtyre çështjeve. Në total 41 prokurorë janë ngarkuar me ndjekjen penale të pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe kryerjen e hetimeve pasurore.

- Nga analiza e të dhënave statistikore lidhur me veprat penale të trafikimit⁵⁰, për vitin 2020, rezulton se janë regjistruar 254 çështje penale me 47 persona në hetim, nga të cilët vetëm 29 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 38 çështje me 64 të pandehur, ose rreth 14.9 % e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të hetuara e zë vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/a i K. Penal me 148 çështje të regjistruara.

- Rezulton një ulje e numrit⁵¹ të çështjeve të regjistruara me 29 çështje më pak dhe rënie e numrit të personave nën hetim me 8 persona më pak, ndërsa për personat e marrë si të pandehur kemi një rritje me 13 persona më tepër. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2020, numri i tyre është rritur me 12 çështje më tepër, ndërsa numri i të pandehurve në gjykim është rritur me 29 persona më shumë krahasuar me vitin 2019⁵².

- Për veprat penale kundër narkotikëve konstatohet se në vitin 2020 janë hetuar më shumë çështje penale se në vitin 2019 (me 444 çështje më tepër). Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike⁵³, në vitin 2020 janë hetuar 3002 çështje penale ose 444 çështje penale më tepër se viti 2019. Rezulton se janë hetuar 1255 persona dhe janë marrë të pandehur 966 persona. Krahasuar me vitin 2019⁵⁴ rezultojnë 207 persona më shumë të

hetuar dhe 86 më shumë të pandehur. Janë dërguar për gjykim 506 çështje ose 16.9 % e çështjeve, me 797 të pandehur, nga ku rezulton një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2019, me 1 çështje me tepër të dërguara për gjykim dhe 96 të pandehur më shumë⁵⁵. Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zë vepra penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, neni 283 i K. Penal, me 1417 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 328 çështje.

- Konstatohet se vijon të mbetet i ulët numri i veprave penale kundër terrorizmit pavarësisht kompleksitetit dhe vështirësisë që kanë në hetim këto vepra, pavarësisht rritjes me 1,5 të numrit të procedimeve të regjistruara. Lidhur me këtë kategori veprash penale⁵⁶, rezulton se janë regjistruar në total 12 çështje për vitin 2020 me 2 persona nën hetim dhe 2 persona të marrë si të pandehur. Në lidhje me çështjet e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2020, ndryshe nga viti i kaluar, rezultojnë vetëm 2 çështje të dërguara për gjykim, me 2 persona të pandehur. Në krahasim me vitin 2019⁵⁷, vihet re një numër i njëjtë i çështjeve të regjistruara me 4 çështje më shumë, por në ndryshim nga 2019 kemi 2 persona nën hetim më pak dhe rritje të numrit të pandehurve me 2 persona.

- Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura⁵⁸ për vitin 2020 janë regjistruar 6 çështje penale për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” parashikuar nga neni 265 i K. Penal, dhe 1 çështje penale për veprën penale “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj” parashikuar nga neni 265/a i K. Penal, me 1 person nën hetim dhe 4 të pandehur. Rezulton një rritje e numrit të çështjeve me 3 çështje më shumë krahasuar me vitin 2019⁵⁹, por ndryshe nga viti 2019 rezulton vetëm 1 çështje e dërguar për gjykim me 4 të pandehur për këtë kategori veprash.

Sa më sipër, **Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, i rekomandon:**

⁵⁰ Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të K. Penal.

⁵¹ Në vitin 2019 ishin regjistruar 283 çështje penale me 55 persona në hetim, nga të cilët 16 janë marrë si të pandehur.

⁵² Në vitin 2019 ishin dërguar për gjykim 26 çështje me 35 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

⁵³ Ku janë përfshirë 283/a; 283/b; 284/c; 285/a; 285/b; 286 dhe 286/a të K. Penal.

⁵⁴ Në vitin 2019 kanë qenë 2558 çështje të hetuara me 1048 persona nën hetim dhe 880 të pandehur.

⁵⁵ Në vitin 2019 janë dërguar për gjykim 505 çështje, me 701 persona të pandehur.

⁵⁶ Nenet 230–232/b të Kodit Penal.

⁵⁷ Në vitin 2019 ishin regjistruar 8 çështje penale, me 4 persona nën hetim dhe asnjë të pandehur.

⁵⁸ Nenet 265–265/c të K. Penal.

⁵⁹ Në vitin 2019 janë regjistruar 4 çështje penale dhe asnjë person të marrë nën hetim ose të pandehur.



1. Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike.

2. Përmirësimin e cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore.

3. Fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj.

4. Zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore.

5. Pasurimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave për të siguruar një bazë të besueshme për reforma të mëtejshme për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave.

6. Marrjen dhe zbatimin e masave për përmbushjen e rekomandimeve të *Moneyval*-it për pastrimin e parave / luftimin e financimit të terrorizmit.

Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut

Objekti i reformës në drejtësi është mirëfunksionimi i shtetit ligjor kjo me qëllim respektimin dhe garantimin e çdo të drejte të njohur nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe të prioritetuara nga Bashkimi Evropian, si përpjekje për t'u anëtarësuar në familjen evropiane. Të gjitha organet ligjzbatuese, përfshirë edhe organin e prokurorisë kanë përgjegjësinë të kenë vëmendje të shtuar në trajtimin me dinjitet dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare të autorëve dhe viktimave të veprave penale që vijnë nga shtresat vulnerable të shoqërisë dhe të forcojnë

bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e detyrave brenda afateve më të përshtatshme ligjore.

Referuar analizës për vitin 2020 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezultojnë se:

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2020 në prokuroritë pranë Gjykatave me Juridiksion të Përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale⁶⁰ është për 1402 çështje, me 1413 të pandehur, shifra që zënë 14.05% të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim. Në lidhje me këto institute të reja procedurale, rezultojnë se për 410 çështje kundërvajtje penale është kërkuar miratimi i urdhrit penal me 432 të pandehur, ku krahasuar me 2019 rezultojnë me ulje 44.5% të çështjeve, për 740 çështje me 749 të pandehur është kërkuar miratimi marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku rezultojnë me rritje 0.6% të çështjeve të krahasuara me vitin 2019, për 225 çështje me 225 të pandehur është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë, një rritje 0.22% të çështjeve krahasuar me vitin 2019.

Në lidhje me rekomandimin për hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsimin e dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3, datë 21.6.2019, "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve", Prokuroria e Përgjithshme referon se për gjatë vitit 2020 janë regjistruar 5 procedime penale me 1 të pandehur dhe 1 të pandehur të dënuar.

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se gjykimi i drejtpërdrejtë vijon të mbetet një nga llojet e gjyqësorisë më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë. Organi i prokurorisë për vitin 2020 ka dërguar për gjykim 9973 çështje (nuk përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por vetëm për 252 prej tyre prokuroria ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë ose me rreth 2.52%. Rezultojnë një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2019⁶¹, si dhe një rritje e lehtë e çështjeve për të cilat është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë. Ndërkohë që për

⁶⁰Referuar shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. 968/25 prot., datë 30.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 161/1 prot., datë 31.3.2021.

⁶¹ Për vitin 2019 janë dërguar për gjykim 10396 çështje, për 218 prej të cilave është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë.



vitin 2020 një nga rekomandimet e Këshillit të Ministrave ka qenë edhe rritja e rasteve të kërkuara nga organi i prokurorisë për gjykimin e drejtpërdrejtë.

- Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës⁶² rezulton se për vitin 2020 janë regjistruar 1358 çështje penale me 390 persona nën hetim dhe janë marrë 785 të pandehur. Krahastuar me vitin 2019⁶³ rezultojnë 111 çështje më shumë të regjistruara; 22 persona më shumë nën hetim, dhe 77 të pandehur më shumë. Në lidhje me këtë kategori veprash rezulton se për vitin 2020 janë dërguar për gjykim 954 çështje me 1029 të pandehur. Krahastuar me një vit më parë⁶⁴ ka një rritje prej 75 çështjesh më shumë të dërguara për gjykim, dhe 93 të pandehur më shumë.

- Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i K. Penal, për vitin 2020 janë regjistruar 1251 çështje penale ose rreth 3.2 % e të gjitha çështjeve penale të regjistruara⁶⁵, me 358 persona nën hetim dhe janë marrë në cilësinë e të pandehurit 756 persona. Krahastuar me vitin 2019⁶⁶ konstatohet një rritje e numrit të çështjeve të regjistruara me 111 çështje më shumë, 19 persona nën hetim më shumë dhe 71 të pandehur më shumë.

- Rezulton se në vitin 2020 janë dërguar për gjykim 914 çështje për këtë veprë penale me total prej 979 të pandehurish, çka përbën një rritje prej 80 çështjesh dhe 91 të pandehurish më shumë krahasuar me vitin 2019⁶⁷. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këtë veprë përbën rreth 9.2 % të numrit total të çështjeve të dërguara për gjykim gjatë vitit 2020⁶⁸. Nga këto çështje, për vitin 2020, janë gjykuar 622 çështje me 656 të pandehur, duke pësuar një rënie me 112 çështje më pak dhe 136 të pandehur më pak se në vitin 2019⁶⁹.

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjykimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për dhunën në familje rezulton se është kërkuar vetëm në 1 rast dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës i dispozitës (në

vitin 2019 nuk është kërkuar në asnjë rast). Gjithashtu:

- i. krahasuar me vitin 2019 rezulton se sërish nuk është kërkuar në asnjë rast dënimi me gjobë;
- ii. për 1 të pandehur është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit;
- iii. për 179 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita⁷⁰;
- iv. për 277 të pandehur është kërkuar dënim mesatar⁷¹;
- v. për 3 raste është kërkuar ulja e dënimit nën minimumin e parashikuar nga dispozita⁷²;
- vi. për 260 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit⁷³.

Ndërkohë konstatohen 7 raste kur është kërkuar pushimi i çështjes ose 13 raste më pak në krahasim me vitin 2019⁷⁴. Nuk konstatohet ashpërsim i politikës penale, në lidhje me këtë veprë, pavarësisht rekomandimit të dhënë për vitin 2020.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në çështjet penale të regjistruara gjatë vitit 2020, ka pasur 392 të pandehur të mitur të moshës 14 – 18 vjeç, nga të cilët 381 janë meshkuj dhe 11 femra, ndërsa kanë rezultuar 96 viktima të mitur nga të cilët 51 meshkuj dhe 45 femra. Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për të miturit për vitin 2020, janë regjistruar 478 procedime ku krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej 20.4% të numrit të procedimeve, me 525 persona në hetim ku krahasuar me vitin 2019 rezulton një rritje prej 35.3% të numrit të të pandehurve, nga ku 146 çështje janë dërguar për gjykim, duke shënuar një rritje me 5 procedime më shumë⁷⁵, për 39 referime/kallëzime është vendosur mosfillimi dhe për 199 çështje është vendosur pushimi i çështjes. Për sa u përket masave të sigurimit personal, rezulton se në 31 raste ose për rreth 5.9% e të miturve është caktuar masa e sigurisë personal “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale ose me ulje 0.1% të të miturve me masë sigurimi “Arrest në burg” krahasuar me vitin 2019, për 213 raste është aplikuar masa alternative e shmangies, në 7 raste është vendosur

⁶²Seksioni IX, nenet 124–130/a të Kodit Penal.

⁶³Në vitin 2019 ishin regjistruar 1247 çështje me 368 persona nën hetim dhe 708 të pandehur.

⁶⁴Në vitin 2019 ishin dërguar për gjykim 879 çështje me 936 të pandehur.

⁶⁵Për vitin 2020 janë regjistruar në total 39490 çështje.

⁶⁶Për vitin 2019 janë regjistruar 1140 çështje me 339 persona nën hetim dhe 685 persona në cilësinë e të pandehurit gjatë hetimeve.

⁶⁷Në vitin 2019 janë dërguar për gjykim 834 çështje me 888 të pandehur.

⁶⁸Numri total i çështjeve të dërguara në gjyq në vitin 2020 është 9973 çështje.

⁶⁹Në vitin 2019, janë gjykuar 734 çështje me 792 të pandehur.

⁷⁰Në vitin 2019, dënimi minimal është kërkuar për 171 të pandehur.

⁷¹Në vitin 2019, dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita është kërkuar për 294 të pandehur.

⁷²Në vitin 2019, ulja e dënimit nën minimumin e parashikuar nga dispozita është kërkuar për 13 raste.

⁷³Në vitin 2019, pezullimi i ekzekutimit është kërkuar për 304 të pandehur.

⁷⁴Në vitin 2019, pushimi i çështjes për dhunën në familje është kërkuar në 20 raste.

⁷⁵Në vitin 2019, janë regjistruar 141 çështje të dërguar për gjykim.



ndërmjetësimi, 4 raste këshillimi për të miturin dhe familjen në 13 raste është vendosur paralajmërimi me gojë dhe në 189 raste është vendosur paralajmërim me shkrim.

- Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit⁷⁶, nga të dhënat statistikore në vitin 2020 janë regjistruar 331 çështje penale, ose 0.84% e totalit të çështjeve të regjistruara në këtë vit, me 88 persona nën hetim dhe 56 të pandehur. Në krahasim me vitin 2019⁷⁷, rezulton një rritje e lehtë e numrit të çështjeve me 67 çështje më shumë, me 25 persona nën hetim më shumë dhe një rënie të lehtë me 1 të pandehur më pak, ose me rritje 25,3 % të numrit të procedimeve dhe 39% rritje e numrit të personave nën hetim krahasuar me ata të regjistruar për vitin 2019. Numri më i madh i çështjeve penale vijon të jetë i regjistruar për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i K. Penal me 185 çështje të regjistruara.

- Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë grup veprash rezulton se për vitin 2020 janë dërguar për gjykim 64 çështje me 70 të pandehur, ku krahasuar me vitin 2019⁷⁸ rezulton një ulje e lehtë me 1 çështje më pak e dërguar për gjykim dhe 2 të pandehur më pak. Në përgjigjen e përcjellë, Prokuroria e Përgjithshme konstaton se numri i procedimeve penale dhe i të pandehurve të dërguar në gjyq dhe të dënuar janë në shifra pothuajse të njëjta krahasuar me vitin 2019, tregues me efekt ndikimi edhe nga gjendja e pandemisë COVID-19.

Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, rekomandon:

1. Shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjyqimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve.

2. Nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet

e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore.

3. Vijimin e ashpërsimit të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

4. Rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale për autorët e veprës penale të dhunës në familje.

5. Zhvillimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve.

6. Forcimin e përpjekjeve për kryerjen e hetimeve të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës së dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Forcimi i Bashkëpunimit ndërinstitucional

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe konsolidimi i ndërveprimit ndërmjet agjencive ligjzbatuese të brendshme por edhe me ato ndërkombëtare, përbën thelbin e rekomandimeve në këtë drejtim.

Në kuadër të marrjes së masave për forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, më datë 15.12.2020, kanë nënshkruar Aktin e Koordinimit Institucional “Për rritjen e efciencës nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj”;

Gjithashtu në Raportin vjetor 2020 mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar rezulton se funksionon Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i cili është përgjegjës për koordinimin e punës së saj me autoritetet e zbatimit të ligjit të shteteve të tjera.

⁷⁶Nenet 201–207 të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2019.

⁷⁷Në vitin 2019 ishin regjistruar 264 çështje penale me 63 persona në hetim dhe 57 të pandehur.

⁷⁸Në vitin 2019 ishin dërguar për gjykim 65 çështje me 72 të pandehur.



Gjatë vitit 2020 nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë trajtuar 69 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, në bazë të konventave të Këshillit të Evropës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Nga këto 20 kërkesa kanë qenë të mbartura nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe 49 janë kërkesa të reja, të paraqitura pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme.

Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve procedurale në Republikën e Shqipërisë. Numri i madh i tyre, tregon për besimin që autoritet e huaja kanë krijuar ndaj Prokurorisë së Posaçme dhe rëndësinë e veçantë që kjo prokurori i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar.

Nga numri total i 69 kërkesave të paraqitura për ndihmë të ndërsjellë juridike ka rezultuar se numrin më të lartë, 31 prej tyre, ose 44,92 %, e zënë kërkesat që kanë të bëjnë me hetime në fushën e veprave penale të “Trafikimit të narkotikëve”, “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 283/a, 283, 284/a, 333/a të tij.

Nga totali prej 69 kërkesave, gjatë periudhës 20.12.2019 deri në 31.12.2020, janë ekzekutuar gjithsej 31 kërkesa ndërsa pjesa tjetër është në fazë ekzekutimi ku për të gjitha është marrë lejimi nga Ministria e Drejtësisë dhe gjykata për ekzekutimin e këtyre letërporosive.

Krahas kërkesave për ndihmë juridike që lidhen me hetime të autoriteteve të huaja, lidhur me hetimet e Prokurorisë së Posaçme është e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore apo verifikimeve jashtë Shqipërisë. Për kryerjen e këtyre veprimeve janë përpiluar për vitin 2020 nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme 41 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja, prej të cilave janë ekzekutuar 22 gjatë vitit 2020.

Nga këto 41 kërkesa të dërguara rezulton se numrin më të lartë, 18 prej tyre, ose 43.9 %, e zënë kërkesat që kanë të bëjnë me hetime në fushën e veprave penale të “Trafikimit të narkotikëve”, “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit, asaj të “Grupit të strukturuar

kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 283/a, 283, 333/a të tij.

Një tjetër fushë e marrëdhënieve me jashtë në të cilën ka operuar Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është dhe krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore. Kjo strukturë gjatë vitit 2020 ka kryer hetime me 6 (gjashtë) skuadra të përbashkëta hetimore me autoritetet e drejtësisë të Italisë nën drejtimin dhe asistencën e *Eurojust*-it. Këto skuadra janë krijuar për veprat penale “Trafikim të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit atë të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/a, 333/a të Kodit Penal Shqiptar, si dhe për veprat penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit atë të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 287, 283/a, 333/a, 334 të Kodit Penal Shqiptar.

Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2020 ka plotësuar praktikat për kërkesat për ekstradime në 24 raste, nga të cilat 7 raste nga Shqipëria drejtuar shteteve të huaja dhe 17 nga jashtë vendit në Shqipëri.

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje.

Konkretisht, në datën 7.2.2020, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Drejtorinë Kombëtare të Antimafias dhe Antiterrorizmit të Republikës Italiane, ndërsa në datën 27.11.2020 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Zyrën për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Kroacisë (USKOK).

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2020 në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional, nga organi i prokurorisë rezulton:

- Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme⁷⁹, në lidhje me rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të

⁷⁹ Me shkresën nr. 968/25 prot., datë 30.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 161/1 prot., datë 31.3.2021.



kriminalitetit, është konsideruar domosdoshmëri një qasje e përbashkët dhe e unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese. Për këtë qëllim, Prokuroria e Përgjithshme i ka kushtuar vëmendje si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, ashtu edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror.

- Në këtë kuadër janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimit të produkteve/aseteve me origjinë kriminale, veprave penale që lidhen me detyrën dhe ato korruptive. Gjithashtu Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë po bashkëpunon me INSTAT në kuadër të implementimit të Nomenklaturës Ndërkombëtare të Krimeve për Qëllime Statistikore.

- Krijimi i vakancave për shkak të rivlerësimit kalimtarë për 43 prokurorë në prokuroritë e të gjitha niveleve me juridiksion të përgjithshëm, krahas masave për plotësimin e vendeve vakante me prokurorë, kërkon marrjen e masave emergjente për shtimin e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të numrit të administratës ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjitha niveleve.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja në fushën penale, është gjithashtu i rëndësishëm dhe kërkon fillimisht koordinimin ndërinstitucional midis organit të prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese apo institucioneve të tjera që marrin pjesë aktive në këtë proces me qëllim finalizimin me sukses dhe në një kohë sa më të shpejtë të bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

- Bashkëpunimi i organeve të hetimit dhe përfshirja e tyre në hetim shmang hetimet joefektive dhe të dështuara, duke krijuar kështu historik suksesi mbi referimet dhe hetimin e veprave penale, duke çuar në përfundimin final që

është dhënia e drejtësisë efektive, në afate të arsyeshme.

- Një rëndësi kyçe, sidomos për veprat penale të rënda si veprat në fushën e korrupsionit apo krimit të organizuar, ka edhe bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë.

- Për sa i përket rekomandimit për rritjen e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në funksion të përmirësimit të cilësisë së veprimeve hetimore në muajin korrik 2019, në zbatim të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” u ngrit dhe nisi funksionimin Komisioni i Policisë Gjyqësore, si dhe Sekretariati Teknik për funksionimin e tij. Prokurori i Përgjithshëm ka nxitur, mbështetur dhe asistuar Komisionin e Policisë Gjyqësore për miratimin e rregullave në përputhje me ligjin nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Në vijim të këtij bashkëpunimi, Komisioni i Policisë Gjyqësore miratoi me vendimin nr. 27/1, datë 30.10.2020, “Rregullore për sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë dhe integritetin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore”, e cila u është shpërndarë të gjitha prokurorëve dhe institucioneve shtetërore që ligji u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore. Për shkak të natyrës së paqartë të dispozitave që rregullojnë vlerësimin e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, varësinë e dyfishtë të oficerëve të policisë gjyqësore, mosngritjen ende të “Strukturave hetimore në Policinë e Shtetit”, është vendosur që fillimisht ky sistem të aplikohet vetëm për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë.

-Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Prokurori i Përgjithshëm përzgjedhi prokurorin ndërlidhës pranë *Eurojust-it*⁸⁰, dhe nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2020 në kuadër të letër-kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike janë kryer: 119 ekstradime nga jashtë, 114 ekstradime për jashtë, 550 letërporosi nga jashtë, 620 letërporosi për jashtë, 35 transferime të dënueshëm nga jashtë, 5 transferime të dënueshëm për jashtë, 34 transferime procedimi nga jashtë, 15

⁸⁰ Znj. Fatjona Memçaj, ku në datën 17.12.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi komandimin e znj. Memçaj pranë *Eurojust-it*, për një periudhë 2 vjet e 6 muaj.



transferime procedimi për jashtë, 54 njohje vendime penale nga jashtë, 12 njohje vendime penale për jashtë, janë trajtuar 28 praktika (kërkesa për asistencë), në bashkëpunim me *Eurojust*-in, nga të cilat 21 kërkesa janë dërguar nga Prokurorët e vendeve të BE-së të atashuar në *Eurojust*, ndërsa 7 kërkesa janë përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme në *Eurojust*, me qëllim lehtësimin e dhënies së ndihmës juridike në kohë reale.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit për organizimin e trajnimeve të përbashkëta janë në proces për të realizuar një cikël trajnimesh me pjesëmarrjen e prokurorëve me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, Oficerët e Policisë së Shtetit, strukturave hetimore të doganave dhe tatimeve, inspektorë të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Shërbimit të Çështjeve të Brendshme në Ministrinë e Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Gjithashtu është përmendur arritja e marrëveshjes të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese me qëllim rritjen e cilësisë së hetimeve/kallëzimeve të paraqitura dhe rritjen e efektivitetit të hetimeve për veprat e referuara prej tyre.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të forcimit të koordinimit ndërinstytucional, në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, organi i prokurorisë bën me dije se sistemi CAMS nuk është ende funksional. Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është ngritur një grup pune ku janë ftuar edhe përfaqësues të projektit EURALIUS V. Aktualisht Prokuroria e Përgjithshme është në pritje të kryerjes së një analize teknike nga një ekspert i pavarur i caktuar nga EURALIUS V, për të vlerësuar se në ç'masë një investim i mëtejshëm në këtë program është rentabël dhe/ose mund ta bëjë atë funksional.

- Ndërkohë nga analiza e statistikave të prokurorisë për vitin 2020 konstatohet se numri më i madh i referimeve ka ardhur nga policia e shtetit me 31415 çështje të referuara, ndërkohë që referimet e policive të tjera janë si vijon: 49 çështje të referuara nga policia e ndërtimit; 17 çështje të referuara nga policia financiare; 16 çështje të referuara nga policia pyjore; 19 çështje të referuara nga policia elektrike; dhe 282 çështje të referuara

nga policitë e tjera. Përveç referimeve nga policia e shtetit, numri i referimeve të tjera vijon të jetë i ulët, ku në krahasim me vitin 2019⁸¹ rezulton një rritje e lehtë e referimeve nga policia elektrike me 17 raste më shumë dhe policitë e tjera me 18 raste më shumë. Ndërsa lidhur me rastet e referuara për policinë e shtetit rezulton një rënie e numrit të çështjeve të referuara me 4945 raste më pak, për policinë financiare me 21 raste më pak të referuara, për policinë pyjore me 14 raste më pak të referuara dhe për policinë e ndërtimit 17 raste më pak të referuar.

- Nga vlerësimi i rekomandimeve të propozuara nga Ministrinë e linjës që kanë në përgjegjësi agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentohet progres i arritur dhe forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë. Me qëllim përmirësimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, nga këto institucione janë propozuar si vijon:

Ministria e Brendshme⁸², e ka strukturuar kontributin e saj sipas fushave të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave. Konkretisht:

- në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, narkotikëve e trafikeve dhe krimeve financiare fokusohet në:

i. përmirësimin e kapaciteteve njerëzore e teknike, duke planifikuar e zhvilluar trajnime specifike me qëllim hetimin efikas, në kohë e me cilësi të krimit të organizuar, luftës kundër narkotikëve e trafikeve, si dhe krimit financiar, duke u fokusuar në përdorimin e mjeteve speciale të hetimit, veprimet simuluese, si dhe hetimet pasuror;

ii. rritjen e bashkëpunimit mes Prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, me qëllim shkëmbimin e shpejtë e të saktë të informacionit në kuadër të hetimeve;

iii. rritja e rolit të prokurorit të çështjes, në hetimin e procedime komplekse dhe të vështira, që kanë impakt dhe ndjeshmëri të lartë publike;

iv. rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, për zbulimin e autorëve që i fshihen drejtësisë;

⁸¹ Të dhënat për vitin 2019 kanë qenë: 36360 referime nga policia e shtetit; 38 referime nga policia financiare; 66 referime nga policia e ndërtimit; 30 referime nga policia pyjore; dhe 264 referime nga policitë e tjera, ndërsa nga policia elektrike janë referuar vetëm 2 raste.

⁸²Me shkresën e saj nr. 235/4 prot., datë 9.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/1 prot., datë 10.2.2021.



v. rritja e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, me qëllim parandalimin e krimeve kompjuterike të përdorura për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe ato për qëllime financiare e të terrorizimit;

vi. krijimin, administrimin dhe rakordimin e regjistrave me të dhëna të plota e të konsoliduara për veprat penale të rënda, (korrupsionin, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimin e organizuar, trafiket e paligjshme), sipas standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare të FATF-së dhe *Moneyval*-it, me qëllim krijimin, administrimin, mbajtjen e të dhënave unike në nivel kombëtar;

vii. ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve të seksioneve të posaçme për hetimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Korçë.

- Në kuadër të luftës kundër korrupsionit Ministria e Brendshme sugjeron:

i. forcimin e bashkëpunimit mes Prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, për shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin efektiv të metodave speciale të hetimit, duke forcuar jo vetëm kuadrin normativ ndërinstitucional por dhe bashkëpunimin reciprok;

ii. rritjen domethënëse të hetimeve pasurore për çështjet e korrupsionit, të shtrira më herët në kohë dhe synimin për rritjen e konfiskimit të pasurive të paligjshme;

iii. planifikimin dhe zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta me prokurorët e Prokurorisë së Posaçme për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Byronë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore. Në lidhje me një nga sugjerimet për rritjen e numrit të hetimeve, veçanërisht hetimeve proaktive për rastet e korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe nivelet e mesme e të larta të administratës shtetërore, duhet të mbahet në konsideratë kompetenca lëndore e prokurorive të juridiksionit të zakonshëm për këtë kategori veprash.

- Në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut, Ministria e Brendshme sugjeron:

i. përshpejtimin dhe rritjen e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë për hetimin e rasteve të të miturve, për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe shkurtimin e periudhës së kufizimit të lirisë;

ii. zbatimin e masave alternative të dënimit ndaj personave me rrezikshmëri të ulët shoqërore, që kryejnë vepra penale që parashikohet masë dënimi deri në 5 vite;

iii. ashpërsimin e politikës penale nga ana e prokurorisë për veprat penale që kanë minimum dënimi 5 vite, veçanërisht për veprat penale të krimit të organizuar, krimeve të rënda kundër jetës, korrupsionit, krimit financiar e kryesisht të pastrimit të parave, armëmbajtjes pa leje, veprave penale që cenojnë mjedisin etj.;

iv. rritjen e aplikimit të gjykimit të drejtpërdrejtë, me qëllim shkurtimin e periudhës së paraburgimit për personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime.

Ministria e Brendshme ka paraqitur disa problematika që lidhen me administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara, ku sugjerohet:

i. Gjatë planifikimit të sekuestros, rritje e bashkëpunimit të prokurorisë me personelin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) në kuadër të dorëzimit apo të menaxhimit më të mirë të pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara. Ky bashkëpunim është veçanërisht i nevojshëm në rastet e pasurive me vlera të mëdha, pasurive që nuk kanë asnjë vlerë, llogarive bankare boshe ose dhe marrjen e masave për vënien në administrim të tyre pas vendimit gjyqësor;

ii. Prokuroria në kërkesën e paraqitur në gjykatë të përcaktojë saktë pjesën që kërkon të sekuestrohet/konfiskohet, pasi për shkak të kërkesës të shprehur në përqindje, e cila reflektohet në vijim edhe në dispozitivin e vendimit gjyqësor, është e vështirë marrja në administrim e kësaj pasurie;

iii. Koordinimi midis institucioneve sugjerohet edhe për përcaktimin e shpenzimeve të administrimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, për të cilat, gjatë proceseve gjyqësore për sekuestrimin, konfiskimin, apo revokimin e pasurisë të shtetasit që është nën hetim pasuror, prokurori duhet ta kërkojë specifikisht, që të reflektohet edhe në dispozitivin e vendimit gjyqësor.

Krahas sa më sipër, Ministria e Brendshme ka paraqitur edhe disa sugjerime të tjera në interes të respektimit të përcaktimeve ligjore dhe rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit institucional:



i. Respektimi i parimit ligjor për delegimin e hetimit strukturës së shërbimit të policisë gjyqësore që e ka referuar veprën penale te prokurori;

ii. Njoftimi i institucioneve për mënyrën e përfundimit të tyre në rastet kur personat e kallëzuar janë personel i institucionit;

iii. Intensifikimi i punës midis Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë për integrimin e programeve dhe sistemeve respektive të menaxhimit të çështjes, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Progres Raportit të Bashkimit Evropian.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konkretisht Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve⁸³

i. në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 1079, datë 15.7.2020, janë marrë angazhime për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim rritjen e saktë dhe të plotë të rrethanave të faktit në shkelje të ligjit që përbëjnë veprë penale në fushën e pastrimit të parave, krimeve financiare, për kryerjen e hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale;

ii. në nivel qendror është rënë dakord të ngrihet një strukturë e cila do të veprojë si organ monitorues dhe koordinues për analizimin dhe vlerësimin e ecurisë së zbatimit të masave ndërinstitucionale dhe problematikave në kuadër të hetimit të veprave penale objekt të fushës së veprimit të memorandumit;

iii. kërkohet një vëmendje e shtuar dhe prioritet më të lartë në sektorët e identifikimit me risk si sektori i ndërtimit, juridiksionet *offshore* dhe zbatimi i një plani masash në kuadër bashkëpunimi ndërinstitucional për mbledhjen e tatimeve të shmangura;

iv. kërkohet më tepër vëmendje në lidhje me fenomenin e skemave mashtruese me TVSH, krijimi i subjekteve tregtare fiktive, administratorëve apo ortakëve fiktivë, dënimi i të cilëve është i paefektshëm;

iv. në veprat penale në fushën e tatimeve duhet të zbatohet gjerësisht sekuestroja preventive dhe konservative.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP)⁸⁴ paraqet të

njëjtat sugjerime, mbështetur dhe në rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë:

i. nevojitet një rritje në tërësi e numrit të rasteve të dërguara në gjykatë për veprën penale të parashikuar nga neni 287, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*”, të Kodit Penal, duke përdorur në mënyrë sistematike edhe provat rrethanore, me fokus të veçantë në rastet kur pasuria që i nënshtrohet pastrimit apo tentohet t’i nënshtrohet, të ketë prejardhje nga pasuri kriminale të krijuar jashtë vendit apo nga raste korrupsioni brenda vendit;

ii. nevojitet rritje në tërësi e numrit të rasteve të dërguara në gjykatë për të cilat kërkohet konfiskimi i pasurisë kriminale (për çdo vepër të aplikueshme), përfshirë pasurinë indirekte dhe atë të prejardhur nga pasuria fillestare kriminale;

iii. vëmendje e veçantë duhet për rastet e hetuara dhe gjykuara sipas nenit 287 të Kodit Penal në të cilat kjo vepër penale kryhet nga persona të tretë, familjarë, lidhje të ngushta shoqërore apo profesionist, duke synuar dënimin e tyre dhe konfiskimin e pasurisë;

iv. qartësim dhe unifikim i qëndrimit të prokurorëve të rretheve gjyqësore për autonominë e veprës penale të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, pasi edhe pse dispozita ligjore është shumë e qartë, herë pas here ndeshen vendimmarrje jo në përputhje me parashikimin ligjor;

v. të shihet mundësia e miratimit të procedurave të unifikuara standarde hetimore për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/b, 179/a, 230/a të Kodit Penal.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁸⁵ shprehet se ka pasur një bashkëpunim të mirë si me Prokurorinë e Përgjithshme ashtu edhe me Prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm. Gjatë vitit 2020, nuk ka pasur problematika në lidhje me mosfillimin e referimeve penale, pasi referimet e Oficerëve e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Hetimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ndër vite janë vlerësuar nga organi i Prokurorisë duke i regjistruar si procedime penale. Gjatë vitit të kaluar nuk ka pasur problematika të vonesës në kthimin e përgjigjeve apo kërkesave për informacion. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për shkaqe administrative në funksion të Kodit

⁸³Me shkresën e tyre nr. 1001/1. datë 10.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/4 prot., datë 12.2.2021.

⁸⁴Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 699/3 prot., datë 11.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/3 prot., datë 12.2.2021.

⁸⁵Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 699/3 prot., datë 11.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/3 prot., datë 12.2.2021.



Doganor të Republikës së Shqipërisë (vendosjen e gjobave administrative të cilat gjenerojnë të ardhura në buxhetin e shtetit), si dhe nisur nga fakti i marrjes së informacionit në terren, i cili shërben për investigimin e mëtejshëm për të shkuar në origjinën e personave që kryejnë kontrabandë, sugjeron veprat penale në fushën e kontrabandës, të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se nga cili institucion vjen pranë Prokurorive, të ndiqen nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit⁸⁶ vlerëson bashkëpunimin midis dy institucioneve dhe sugjeron:

i. forcimin e këtij bashkëpunimi nëpërmjet dhënies prej tyre të informacionit dhe ekspertizës në fushën e lojërave të fatit;

ii. rritjen e hetimeve proaktive jo vetëm për veprat penale që lidhen me veprat penale në fushën e lojërave të fatit, por edhe në veprat penale si pastrimi i produkteve të veprës penale, mitmarrja, shpërdorimi i detyrës, evazioni fiskal; si dhe

iii. rritjen e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim për këtë kategori veprash penale me qëllim reduktimin e këtij fenomeni.

Ministria e Mbrojtjes⁸⁷ nuk ka paraqitur problematika në lidhje me prokurorinë por ka sugjeruar:

i. të hartohet një plan trajnimi bazë (fillestar) dhe i vazhdueshëm, i përditësuar për oficerët e Policisë Gjyqësore dhe oficerët e Policisë Kriminale që gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore të Policisë Ushtarake;

ii. të hartohet një udhëzim i Prokurorisë së Përgjithshme për drejtuesit e prokurorive të rretheve për unifikimin e trajtimit të procedimeve penale ushtarake, të cilët janë pezulluar më herët dhe kanë plotësuar afatet e parashkrimit.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit⁸⁸ paraqet ndryshimet e saj organizative, ku pas procesit të shkrires së Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT-së) në tre institucione, një pjesë e policisë pyjore ka kaluar në strukturën e Inspektoratit Kombëtar të

Mbrojtjes së Territorit (IKMT-së), dhe për rrjedhojë Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) nuk ka kallëzime penale në nivel qendror dhe rajonal, pasi fusha e përgjegjësisë është mjedisi dhe ujërat dhe shkeljet e konstatuara lidhen me kundërvajtjet administrative. Gjatë vitit 2020, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (AKB) ka depozituar 10 raste në zbatim të vendimit nr. 424, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, pranë strukturave të Policisë Vendore, ndërkohë që nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe institucione të tjera të varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, gjatë vitit 2020 nuk ka pasur raste penale të referuara drejtpërdrejt në Prokurori.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve⁸⁹ parashtron shqetësimin, në lidhje me disa çështje konkrete:

i. për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a, i K. Penal, hetimi dhe vënia përpara përgjegjësisë penale të autorëve nuk është në nivelin e duhur;

ii. numri i çështjeve të dërguara për gjykim është i ulët në krahasim me çështjet e pushuara dhe mosfilluara;

iii. hetimet e zhvilluara nuk janë të plota, dhe shpesh kufizohen vetëm në administrimin e raporteve të shërbimit të policisë së burgjeve, pa kryer veprime të tjera të domosdoshme shtesë, në funksion të mbledhjes së provave për këtë vepër penale;

iv. mungojnë hetimet në lidhje me ekzistencën e bashkëpunimit në kryerjen e kësaj vepre penale ose në lidhje me moskallëzimin e krimit nga personat e tjerë të cilët vuajnë dënimin.

Në lidhje me shqetësimin e paraqitur lidhur me qëndrimin e gjykatës, vlerësimin e hetimit, formën e zhvillimit të procesit me gjykim të posaçëm, marzhin e dënimit të dhënë nga gjykata dhe zbatimin e bashkimit të dënimeve, këto shqetësime nuk janë element i punës së organit të prokurorisë, megjithatë për forcimin e efektivitetit të hetimit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka sugjeruar: i. rritjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit për rastet e përfunduara me vendim

⁸⁶ Informacion i përcjellë në mënyrë elektronike, me email-in e datës 20.4.2021, nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

⁸⁷ Me shkresën e saj nr. 790/1 prot., datë 23.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/5 prot., datë 24.2.2021.

⁸⁸ Me shkresën e saj nr. 345/1 prot., datë 8.2.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 211/2 prot., datë 11.2.2021.

⁸⁹ Me shkresën nr. 2138 prot., datë 1.3.2021, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1257 prot., datë 2.3.2021.



mosfillimi/pushimi; ii. nxjerrjen e një udhëzimi nga Prokurori i Përgjithshëm për unifikimin e qëndrimit të prokurorive të juridiksionit të zakonshëm në lidhje me këto vepra penale.

Sa më sipër, **Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional i rekomandon:**

1. Konsolidimin e bashkëpunimit nëpërmjet nxitjes për shkëmbim të të dhënave, kryerjes së analizave të përbashkëta për rastet e referuara, shkëmbimit dhe kërkimit të ekspertizës, krijimin e procedurave standarde hetimore me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe lehtësimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit.

2. Forcimin e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe asaj doganore, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ndërinstitucionale.

3. Forcimin e kapaciteteve të seksioneve të posaçme pranë prokurorive me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtyre seksioneve.

4. Shtimin e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre, në respektim të parimit për të caktuar si OPGJ oficerin e strukturës referuese.

5. Zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtëm të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik.

6. Përmirësim të koordinimit ndërinstitucional në lidhje me të dhënat statistikore, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit.

VENDIM

Nr. 345, datë 10.6.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VORË, BASHKIA VORË, FAZA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 66, datë 29.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Vorë, Bashkia Vorë dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin dhe/ose shkëmbimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, që do të realizohet në zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Vorë, Bashkia Vorë, faza I, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës të bëhen në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në



vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtësë”, në shumën 4 771 827 (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit financiar, prej 4 771 827 (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekësh, që i transferohet Bashkisë Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

5. Shkëmbimi i pasurive private të llojit “ndërtësë” me një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme, do të bëhet referuar legjislacionit në fuqi, cilësimeve në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe marrëveshjeve/kontratave paraprake që janë lidhur dhe do të lidhen, ndërmjet Bashkisë Vorë dhe qytetarëve që shprehin dakordësinë.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikat, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Vorë, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

7. Shpronësimi të fillojë menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Bashkia Vorë të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, dhe të bëjë shkëmbimin e pronës, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

9. Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare do të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit. Afati i kryerjes së shkëmbimit të pronës private me një pronë shtetërore të ardhshme do të jetë në përfundim të realizimit të projektit për zhvillimin në zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Vorë, Bashkia Vorë.

10. Bashkia Vorë i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën truall, ku do të krijohet pasuria

e ardhshme, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, bëhet regjistrimi i barrës ligjore sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore, kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privat që kanë pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë të kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe të përfaqësuesit të pronarit shtet bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet, në favor të pronarit privat.

11. Bashkia Vorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, t'i kërkojë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private, të shpronësuar, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

12. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimin e punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

13. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Vorë, për pasuritë e shpronësuar.

14. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

15. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Vorë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[illegible]

Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2021 – Numri 93



Fletorja Zyrtare  Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2021 – Numri 93



Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare



Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2021 – Numri 93



Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

[illegible]

Fletorja Zyrtare Viti 2021 – Numri 93



Viti 2021 – Numri 93

[illegible]

[illegible]



1				3127	2/206	6	100	VO-C.1	KPP	TRU/ALL	100	Tenda 30 m ²		Mbi krah përveç përveç shërbimi në 22.05/2019 në 22.05/2019	Okupuar nga shërbimi përveç shërbimi në 22.05/2019 në 22.05/2019	0.00	0.00	0.00	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0	0			
2				3127	2/270	6	124	VO-C.1	KPP	TRU/ALL	100.00		Bukuri në 1200 Kondicionat i bukur në shërbimi	Mbi krah përveç përveç shërbimi në 22.05/2019 në 22.05/2019	Okupuar nga shërbimi përveç shërbimi në 22.05/2019 në 22.05/2019	0.00	0.00	0.00	0		0.00	0.00	0.00	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0	0			
3				3127	2/104	7	5	VO-C.2	KPP	TRU/ALL	100	Tenda 22 m ²			Okupuar nga shërbimi përveç shërbimi në 22.05/2019 në 22.05/2019	0.00	0.00	0.00	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0	0			

1. Çmimi sipas Vendimit nr. 89, datë 03.02.2016 - për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë

Çmimi (lek/m²)

1. Truall

4,242

2. Çmimi sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2019 për Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016

Çmimi (lek/m²)

1. Njësi Banimi/ Apartament

32,113

2. Njësi shërbimi*

32,113

Për njësitë e shërbimit, është zbritur amortizimi i objektit në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 (i përditësuar), neni 20, pika 3.

UDHËZIM
Nr. 3, datë 2.6.2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT PËR RUAJTJEN E GJELIT TË
EGËR (*Tetrao Urogallus*), SI NJË NGA
LLOJET VEÇANËRISHT TË
MBROJTURA, TË REGJISTRUAR ME
STATUS “RUAJTJE TË PAFAVORSHME”,
NDODHUR NË PARKUN KOMBËTAR TË
MALIT TË TOMORIT, NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për ruajtjen e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus*), si një nga llojet veçanërisht të mbrojtura, të regjistruar me status “ruajtje të pafavorshme”, ndodhur në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, Shqipëri, për periudhën 2021–2023, bashkëlidhur këtij Udhëzimi si pjesë integrale e tij.


2. Zbatimi i Planit të Veprimit për ruajtjen e gjelit të egër, të përfshihet dhe të integrohet në politikat, planet e menaxhimit, programet dhe veprimtaritë që lidhen me to, si dhe në vendimmarrjet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administratat rajonale të zonave të mbrojtura për të zbatuar Planin e Veprimit për ruajtjen e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus*).

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

PLANI I VEPRIMIT
PËR RUAJTJEN E GJELIT TË EGËR
(*TETRAO UROGALLUS*)
NË PARKUN KOMBËTAR TË MALIT TË
TOMORIT, SHQIPËRI



Përmbajtja e lëndës

Hyrje

- 1.1 Përshkrimi i llojit
- 1.2 Statusi aktual i ruajtjes
- 1.3 Korniza rregullative

Konventa dhe direktiva ndërkombëtare.

- 1.4 Legjislacioni kombëtar
- 1.5 Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit

1.6 Analiza e kontekstit (korniza territoriale dhe fitoklimatike)

1.7 Ekologjia dhe gjendja e popullatës së gjelit të egër në planin teorik të njohjes dhe të të dhënave paraprake të publikuara për parkun e Tomorit

Përshkrimi dhe biologjia e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus L.*), si dhe shpërndarja dhe statusi i tij në botë, Evropë dhe Shqipëri

- 1.8 PËRSHKRIMI
- 1.9 AREALI DHE BIOTOPI
- 1.9.1 RIPRODHIMI
- 1.9.2 RITMI I AKTIVITETIT DITOR
- 1.9.3 USHQIMI
- 1.9.4 GJUEITIA

2 Njohja reale e gjendjes së tanishme e popullatës (popullatave) të gjelit të egër në Parkun e Malit të Tomorit

2.1 Sipërfaqja e përhapjes reale të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

2.2 Kërkime paraprake



2.3 Studimi i tipave të pyjeve që hasen në habitatin e gjelit të egër në Parkun e Tomorit, bazë për përcaktimin e dimensioneve të popullatës së tij

2.4 Grumbullimi i të dhënave në terren lidhur me dimensionet e popullatës së gjelit të egër në parkun e Tomorit

2.5 Metodat e monitorimit të popullatave të gjelit të egër

2.6 Monitorimi në periudhën e riprodhimit

2.7 Monitorimi në periudhën dimërore

2.8 Monitorimi veror

2.9 Praktika e monitorimit

2.9.1 Rezultatet e rëlvimeve

2.9.2 Rëlvime (numërime) pranverore

2.9.3 Rëlvime verore

3. Gjendja e popullatës së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

3.1 Efektiviteti i vlerësuar për tërë parkun

3.2 Fiksimi në hartë dhe përshkrimi i vendeve të këngës (arenave) të determinuara bazë për përsëritjen e numërimeve në vitet e ardhshme

3.3 Kërcënime ndaj popullatës së gjelit të egër në masivin e malit të Tomorit

4. Identifikimi i vendimmarrësve dhe i aktorëve të tjerë që janë përfshirë direkt në menaxhimin e habitatit/species dhe analiza SWOT

4.1 Autoritetet qendrore

4.2 Autoritetet lokale

4.3 Analiza SWOT

5. Përcaktimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë për ruajtjen e habitateve/specieve në periudha afatshkurtra, të mesme dhe të gjata

6. Plani i Veprimeve për ruajtjen dhe rikualifikimin e habitatit dhe të popullatës (popullatave) së gjelit të egër në parkun e Tomorit

6.1 Përmirësimin e politikave për ruajtjen e species *Tetrao Urogallus* dhe të planit të menaxhimit

7. Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e *Tetrao Urogallus*

8. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

8.1 Menaxhimi dhe monitorimi i llojit *Tetrao Urogallus* dhe ruajtja e habitatit

8.2 Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit

8.3 Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve

8.4 Masa lidhur me gjuetinë dhe problematiken e lindur prej saj

8.4.1 Masa për përmirësimin e habitatit

8.4.2 Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet

8.4.3 Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe atij artificial

8.4.4 Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK të Malit të Tomorit

8.4.5 Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

9. Informacione dhe masa sensibilizuese për aktorët dhe për popullsinë lokale në drejtim të thellimit të njohjes së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

10. Vlerësim i impaktit të Planit të Veprimit për mbrojtjen dhe menaxhimin korrekt të habitatit/species

10.1 Problemet e pritshme gjatë implementimit

10.2 Impakti njerëzor

11. Identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare, të cilat do të përfshihen në projekt nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet publike dhe private

12. Monitorimi i Planit të Veprimit për kontrollin e efektivitetit të veprimeve

13. Lista e indikatorëve për monitorimin

Lista e figurave

Figura 1. Harta e habitateve në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

Figura 2. Mashkulli i *Western Capercaillie* (*Tetrao Urogallus*)

Figura 3. Femra (*Tetrao Urogallus*)

Figura 4. Shpërndarja e *Tetrao Urogallus*

Figura 5. *Western Capercaillie* mashkulli dhe femra

Figura 6. Habitatit i *Tetrao Urogallus*

Figura 7. Mashkulli dhe femra në paradën e dashurisë

Figura 8. Vezët e *Tetrao Urogallus*

Figura 9. Jashtëqitjet e *Tetrao Urogallus*

Figura 10. Harta e shtrirjes së territorit ku është dëgjuar gjeli i egër

Figura 11. Model, kullë vrojtimi

Figura 12. Projektimi i pyjeve, kërkesat mjedisore dhe rekomandimet e përgjithshme për implementimin e masave silvikulturale për ruajtjen e *Tetrao Urogallus*

Lista e tabelave

Tabela 1. Kategorizimi i territorit

Tabela 2. Rëlvimet pranverore

Tabela 3. Të dhëna mbi çuarjet

Tabela 4. Analiza SWOT

Tabela 5. Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese



Hyrje

1.1 Përshkrimi i llojit

Shpërndarja gjeografike e shumë specieve të rendit Galliformes ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, për shkak të aktiviteteve njerëzore (p.sh. gjuetia e tepruar, sëmundjet, zjarret, shpyllëzimet) dhe kjo gjë shpesh ka çuar në boshllëqe jonatyrore të shpërndarjes së tyre. Duke konsideruar kompleksitetin e kërkesave ekologjike dhe ndërveprimet sociale të Galliformeve, është e rëndësishme që çdo boshllëk në shpërndarjen e tyre, i shkaktuar nga njeriu, duhet të vlerësohet plotësisht për potencialin që ofron për ripopullim. Shumë specie të rendit Galliformes kanë kërkesa specifike ndaj habitatit: disa prej tyre nuk janë elastike për të toleruar modifikime të tepuara të habitateve ku jetojnë. Specie të tjera mund të përshtaten ndaj etapave suksese të caktuara. Në këto raste, megjithëse habitatit mund të duket fillimisht i përshtatshëm, nevojitet një studim i detajuar i strukturës dhe përbërjes së tij, për të garantuar përmbushjen e nevojave të specieve për periudha afatgjata.

Kohët e fundit ripopullimet po përdoren gjerësisht si një instrument i menaxhimit të faunës së egër, për të ripërtëritur në habitate të përshtatshme, popullata kafshësh dhe shpendësh në rrezik zhdukjeje apo të pakësuara. Një pjesë e mirë e këtyre popullatave u përkasin specieve të rendit Galliformes. Galliformet sigurojnë kandidatët e përshtatshëm për ripopullimet, me qëllim ruajtjen e tyre dhe kjo, për disa arsye:

Së pari, për shkak të lëvizjes së tyre të pakët, ekziston rrezik i ulët për migrim apo lëvizje jashtë territorit në krahasim me speciet e tjera të shpendëve.

Së dyti, përgjithësisht Galliformet mbartin më pak sëmundje infektuese në krahasim me specie të tjera shpendësh.

Së treti, për shkak të shumë faktorëve, veçanërisht sasia e studimeve të kryera, rendi Galliformes përfshin një grup ideal shpendësh për t'u studiuar në situata eksperimentale.

Direktivat për ripopullimin e Galliformeve, për qëllime ruajtjeje janë krijuar për të zhvilluar parime bazë për ripërtëritjen në natyrë të popullatave të shëndetshme. Këto direktiva sigurojnë informacion bazë mbi qëllimin dhe objektivat e një projekti ripopullimi, si dhe problemet që duhen marrë në konsideratë gjatë fazës së planifikimit. Natyrisht që

këto direktiva janë të vlefshme për të gjitha speciet e këtij rendi ku përfshihen: fazani, gjeli i egër, thëllëza etj.

Konferenca mbi Mjedisin dhe Zhvillimin e mbajtur në Rio de Janerio në vitin 1992, çoi në Konventën e Diversitetit Biologjik. Sikurse citohet në këtë konventë, në lidhje me ripopullimet, përcaktohen detyrime midis vendeve anëtare dhe ripopullimi është një prej instrumenteve që mund të merret në konsideratë për të përmbushur këto detyrime. Nevoja për ripopullim të specieve mund të konsiderohet si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit dhe procesit të planifikimit të veprimeve që të gjitha shtetet firmëtare duhet të ndërmarrin. Për këtë arsye edhe ky projekt përmbush të gjitha detyrimet e kësaj konvente, ashtu si edhe ripopullimin e specieve gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*).

1.2 Statusi aktual i ruajtjes

Gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*) është një specie që në shtojcën 5 & 6 të VKM-së nr. 31, datë 20.1.2016, "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit", përfshihet në listën e kuqe të shpendëve të rrezikuar dhe nga shpjegimi i kategorisë së rrezikut, sipas IUCN-së, bën pjesë në grupimin e emërtuar "CR" që do të thotë rrezik kritik, pra lloji është në rrezik të afërt zhdukjeje në natyrë.

Habitati: Kjo specie jeton në zona malore shkëmbore, të veshura me pyje halore ose të përziera.

Gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*) klasifikohet si një shpend tepër i rrallë në Shqipëri. Duke mbajtur statusin e rrezikuar në listën e kuqe shqiptare të specieve të kërcënuara, veprime urgjente duhet të merren për shpëtimin dhe ruajtjen afatgjatë të kësaj specie. Hartimi i një plani konservimi për këtë specie do ta vendoste problemin e ruajtjes së saj mbi baza profesionale dhe të qëndrueshme që nga fillimi. Plani i ruajtjes së specieve do të projektohet vetëm për Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, me qëllim që të zgjerohet në të ardhmen në nivel kombëtar.

1.3 Korniza rregullative

Konventa dhe direktiva ndërkombëtare

- Akti për ruajtjen e specieve të rrezikuara (*The Endangered Species Act ESA – 1973*)



Objekti i primar i ESA-së është të ruajë speciet vendëse të florës dhe të faunës që janë në rrezik zhdukjeje ose kërcënimi.

- Korniza Ndërkombëtare Rregullatore për Mbrojtjen e Shpendëve

- Direktiva e Shpendëve (1979) dhe direktiva e habitateteve, direktiva 2009/147/EC. Direktiva paraqet një skicë të përgjithshme se si duhet të menaxhohen, mbrohen dhe kontrollohen popullsia e shpendëve. Palët kontraktuese do të përcaktojnë Zonat e veçanta të ruajtjes, SPAs (Zona speciale për shpendë) dhe Zona të veçanta për konservimin SCAs (Territore speciale). Këto territore janë të përfshira në Rrjetin NATURA 2000.

- Konventa e Bernës (1979). Është produkti i parë i prodhuar nga bashkëpunimi ndërkombëtar për ruajtjen e specieve të florës dhe faunës. Pikat e marrëveshjes janë gati njësoj me direktivën për shpendë dhe habitate. Kjo Konventë zbatohet në një sipërfaqe të madhe gjeografike, për arsye se dhe se shumë shtete në botë janë bërë anëtare të kësaj Konvente.

- Konventa e CITES 1975, Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër.

- Konventa e Bonnit (1983). Siguron një kornizë për mbrojtjen, në të cilën shtetet pale mund të veprojnë për të mbrojtur shpendët migrues dhe habitatet e tyre. Shpendët ndahen në dy lloje të rrezikuara ose të kërcënuar. Shpendët e rrezikuara janë plotësisht të mbrojtur me rregulla strikte.

- Konventa mbi Larminë Biologjike (1992). Shtetet palë kanë përgatitur një instrument ligjor për të mbështetur larminë biologjike dhe komponentët bazë duke krijuar diversitet dhe ndarje të burimeve gjenetike.

- Konventa e Ramsarit (1971). Ramsari është një traktat ndërkombëtar që premtim ruajtjen e ligatave me ndihmën e sanksioneve të brendshme vendimtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Shqipëria është palë në Konventat e mëposhtme: Konventa e Ramsarit; Konventa e CITES-it; Konventa mbi Larminë Biologjike; Konventa e Bernës; Konventa e Bonn-it.

1.4 Legjislacioni kombëtar

Ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës në Republikën e Shqipërisë, nga të cilat mund të përmendim:

- Dokumenti i Politikave Strategjike për mbrojtjen e Biodiversitetit, i miratuar me VKM-nr. 31, datë 20.01.2016;

- Ligji nr. 7/2014, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie;

- Ligji nr. 68/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’”, të ndryshuar;

- Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet: a) shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit; b) zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm; c) lehtësimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e vlerësimit të shërbimeve të ekosistemeve (mjedisore); ç) informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura mjedisore;

- Ligji “Për mbrojtjen e faunës së egër”, nr. 10006, datë 23.10.2008, i ndryshuar;

- Ligji “Për rregullat dhe procedurat për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës” nr. 9867, datë 31.1.2008, Fletore Zyrtare nr. 18, data e botimit 19.2.2008, faqe 629, i ndryshuar;

- Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”;

- Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, që përaftron plotësisht direktivën e Këshillit 92/43/EEC të 21 majit 1992, “Për ruajtjen e habitateteve natyrore të faunës dhe të florës së egër”, miratuar më 2 korrik 2014.

1.5 Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit

Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit nr. 2027, datë 31.12.2014, është dokumenti bazë për Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit dhe për Komitetin e Menaxhimit të zonës së mbrojtur. Sipërfaqja totale e PK të Malit të



Tomorit është 24,723.1 hektar dhe zë 5.37% të sipërfaqes totale të zonave të mbrojtura në Shqipëri.

Plani i menaxhimit bashkërendon dhe integron veprimet që ndikojnë mbi qëllimet e Parkut. Plani përcakton një vizion për të ardhmen e Parkut dhe specifikon veprimet dhe rezultatet që duhet të synohen.

Objektivat e Planit të Menaxhimit të PK të Malit të Tomorit janë:

- Rritja dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe tipave të ndryshëm të habitateve.

- Mbrojtja e specieve të florës dhe të faunës dhe një bashkëveprim sa më i mirë ndërmjet ekosistemeve, duke siguruar një cilësi më të mirë të lumenjve dhe të rrjedhjes së ujërave, si dhe ruajtjen e proceseve natyrore dhe biologjike unike.

1.6 Analiza e kontekstit (korniza territoriale dhe fitoklimatike)

Shqipëria karakterizohet nga një peizazh shumë i larmishëm ku peizazhet malore dhe ultësira, duke përfshirë edhe bregdetin, janë të ndërthurura në sipërfaqe shumë të vogla. Vargjet malore të mbuluar me pyje që dominojnë Shqipërinë, të ndërthurura me lugina pjellore që në shumicën e rasteve janë të orientuara nga verilindja në jugperëndim. Lumenjtë e pasur në sedimente shkarkohen në një bregdet të gjatë, duke krijuar nga veriu në jug një numër të konsiderueshëm të ligatinave dhe liqeneve, disa prej të cilave janë brenda zonave më të rëndësishme të shpendëve të të gjithë Adriatikut, ashtu si Parku Kombëtar dhe zona Ramsar e Divjaks – Karavasta dhe Peizazhi i Mbrojtur Vjosë – Nartë.

Klima është, gjithashtu, e ndryshme, mesdhetare në ultësirën perëndimore, kontinentale në anën lindore të vendit dhe kalimtare në pjesën tjetër të territorit. Kjo favorizon zhvillimin e një bimësie të larmishme e cila në anën verilindore i ngjan vegjetacionit të Evropës Qendrore, ndërsa në jugperëndim është tipike mesdhetare.

Të gjitha këto kushte krijojnë habitate shumë të larmishme dhe të përshtatshme për migrimin nga veriu në jug dhe anasjelltas, për dimërimin dhe mbarështimin e shpendëve. Shqipëria përfaqëson një nga seksionet më të rëndësishme përgjatë fluturimit adriatik [2].

Në bazë të periudhës kohore ose të sezonit, shpendët në Shqipëri ndahen, në:

i. banorë ose të pranishëm përgjatë tërë vitit;

ii. në mbarështues që vijnë në vend në pranverë dhe e lënë në vjeshtë;

iii. në dimërues - shpendë që vijnë në Shqipëri në vjeshtë dhe lënë në pranverë;

iv. në kalimtarë ose shpendë që kalojnë nëpër Shqipëri në pranverë ose në vjeshtë ose në të dyja stinët.

Bazuar në madhësinë e popullatave, në mënyrë të thjeshtë, shpendët e Shqipërisë mund të ndahen në të zakonshëm, të rrallë ose të zhdukur. Bazuar në sa më sipër, gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*) klasifikohet si një shpend i rrallë.

Të dhënat gojore nga punonjësit e pyjeve dhe të shoqatave të gjuetarëve tregojnë se gjeli i egër ka qenë i pranishëm në malet e rrethit të Tropojës, rrethit të Librazhdit, qarkut të Dibrës dhe qarkut të Beratit. Në ditët e sotme të dhënat për këtë specie janë shumë të kufizuara dhe raportet e vëzhgimit janë shumë të rralla për të mos thënë mungojnë fare.

Parku Kombëtar i Tomorit përfshin një krahinë të tërë që shtrihet në tri rrethe: Skrapar, Berat dhe Gramsh, që dominohet nga mali i Tomorit me lartësi 2416 m. Konkretisht, kontributi i secilit prej këtyre rretheve në park është, si më poshtë:

- Rrethi i Skraparit: 15045 ha

- Rrethi i Beratit: 8400 ha

- Rrethi i Gramshit: 1278 ha

Total: 24723 ha

Me vendim të Këshillit të Ministrave, datë 3.3.2009, Parkut iu shtuan edhe 1383 ha, kështu që sipërfaqja e përgjithshme aktuale e parkut është 26.106 ha.

Parku i Tomorit ka pyje ahu, pishe (robull) dhe kullota alpine që ndodhen në lartësinë 1000–2000 m mbi nivelin e detit (Dardhë, Lybeshe, Kapinovë). Pyjet e ahut i gjejmë në lartësinë 1000–1200 m mbi nivelin e detit. Pyjet e robullit gjenden në lartësinë mbi 1600 m. Parku ka edhe pyje të përziera ah me robull (Zeran).

Përveç këtyre, në florën e parkut bëjnë pjesë edhe lisi, ashja, shkoza, lajthia, dëllinja, frashëri, mëlleza, thana, mareja, shqopa, lojmeta etj., si dhe 6 lloje bimësh endemike, mes të cilave *Astragalus autroni*, që gjendet vetëm në malin e Tomorit. Mbulesa barishtore përbëhet nga llojet: agulice, festuka, tërfil, çaj i malit, graminace etj. (fig. 1).

Bote shtazore, përveç gjelit të egër, përmban edhe lloje të ndryshme gjitarësh dhe shpendësh të egër, si: ariu, ujku, dhia e egër, derri i egër, macja e

egër, lepur i egër, dhelpra, kunadhja, baldosa, ketri, shqiponja, thëllëza e malit, disa lloje shpendësh, grifsha, mëllenja dhe disa lloje të tjera zogjsh.

Parku përmban, gjithashtu, monumente natyrore, objekte kulturore, fetare e historike, si dhe objekte të tjera në shërbim të komunitetit [3].

Lidhur me gjelin e egër mund të thuhet se numri i tyre ka rënë masivisht gjatë 20 viteve të

fundit dhe vetëm mbas moratoriumit të gjuetisë prania e kësaj specie rifilloi rritjen. Në veçanti në parkun e Tomorit u identifikua një popullatë e gjelit të egër e përshtatshme për riprodhim. Gjatë monitorimit territorial është dëgjuar kënga e tyre por nuk është fotografuar ende.




Fig. 1. Harta e habitateve në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

1.7 Ekologjia dhe gjendja e popullatës së gjelit të egër në planin teorik të njohjes dhe të të dhënave paraprake të publikuara për Parkun e Tomorit

Përshkrimi dhe biologjia e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus L*), si dhe shpërndarja dhe statusi i tij në Botë, Evropë dhe Shqipëri

(A: Capercaillie; F: Grand Tétrás; Gj: Auerhuhn; I: Gallo cedrone; S: Urogallo)

KLASIFIKIMI: Klasa: Aves; Rendi: Galliformes; Familja: Tetraonidae.

♂ ♀



Fig. 2. Mashkulli (*Tetrao Urogallus*)



Fig. 3. Femra (*Tetrao Urogallus*)

BIOMETRIA:

- Gjatësia e përgjithshme 60–87 cm;
- Krah 30–40 cm;
- Hapja e krahëve 87–125 cm;
- Peshë ♂ 3, 4–3, 6 kg; ♀ 1, 5–2, 0 kg;
- Jetëgjatësia 15–20 vjet për gjelat dhe diçka me pak për pulat.

1.8 PËRSHKRIMI:

Ka dimorfizëm seksual të theksuar. Mashkulli ka ngjyrë të errët (fig. 2) që nga larg ngjan si e zezë. Në fakt qafa, shpina dhe krahët janë kaf në të zezë, gusha dhe gjoksi, jeshil në të zezë me shkëlqim blu, kurse supi i krahut, i bardhë. Lëkura rreth syve dhe njolla lakurike mbi to është e kuqe, sytë kafë, sqepi i verdhë, ndërsa bishti i zi me njolla të bardha të çrregullta. Sa më i vjetër të jetë mashkulli aq më të gjata i ka pendët e “mjekrës” dhe aq më të ngushtë e ka këndin që formohet midis sqepit dhe ballit. Kënga e mashkullit përbëhet nga dy pjesë, e para një tingull sikur goditen dy drurë të thatë dhe e dyta

tingulli që lëshon mprehja e kosës (regjistrimi me poshtë).

Femra, e cila është më e vogël se mashkulli, është ngjyrë ndryshku në sfond, mbi të cilin janë vendosur njolla të zeza e të bardha (fig. 3), duke bërë që ajo të ngjajë si me lara. Pjesa e barkut është më e hapur te femra, ndërsa gjoksi kaf i hapur. Zëri i femrës përbëhet nga dy rrokje: got-got. Zogjtë që nuk kanë arritur maturitetin janë të ngjashëm me femrën në ngjyrosje.

Dallimi i sekseve të shpendët e rinj mund të bëhet nga fundi i verës mbasi mbi kurrizin e gjelave shfaqen pendët e zeza. Ndër shqisat ka shumë të zhvilluar shikimin dhe dëgjimin. Fluturon rëndë, shkurtër nga lart poshtë dhe horizontalisht. I qëndron besnik vendit ku është mësuar të jetojë, po u tremb ikën, por rikthehet përsëri. E dëmtojnë të gjithë rrëmbenjësit shpendë apo gjitarë qofshin, të ditës apo të natës. Jeton i vetmuar jashtë periudhës së riprodhimit, kurse në dimër bashkohet në grupe nga 4–5 ekzemplarë, sipas sekseve.

1.9 AREALI DHE BIOTOPIA

Gjeli i egër është një specie palearktike e përhapur në veri të Evropës (fig. 4) dhe në Azi nga Skocia deri në Siberi dhe në Kinë, por me popullata të izoluar gjendet edhe në Evropën Qendrore dhe Jugore ku është i përthshëm. Në vendin tonë është i përhapur në pjesën veriore, verilindore, dhe qendrore të vendit si në Valbonë, Lumi i Gashit, Martanesh, Lurë, Masdejë, Qarishtë, Orosh, Korab, Shishtavec, Tomor etj. Biotopi i tij janë pyjet halore dhe të përziera me drurë të vjetër e çeltira afër kufirit të epërm të vegetacionit pyjor sa më larg qendrave urbane. Harta nga “Oiseaux de France sf d'Europe”, Jim Flegg. Një hartë e veçantë për Shqipërinë nuk ekziston



Fig. 4. Shpërndarja

1.9.1 RIPRODHIMI:

Poligam, mosha e pjekurisë seksuale dhe sociale e gjelave është 2–4 vjet, ndërsa pulat riprodhohen në moshën njëvjeçare. Raporti normal i sekseve është 4–6 pula për një gjel (fig. 5). Kryqëzohet nga 15 marsi deri në fund të majit, duke pasur pikën më intensive nga 15 prill deri 15 maj. Me gjithë këtë, periudha e kryqëzimit është funksion i kushteve klimatike, kohës së ngrohtë dhe me dritë, e cila e shpejton atë dhe e kundërta.



Fig. 5. Western Capercaillie (mashkulli dhe femrat)

Në periudhën e kryqëzimit të dyja sekset mbledhen në pika të caktuara të pyllit të quajtura “arena”, ku ndodhin të ashtuquajturat “beteja” midis meshkujve dhe “paradat e dashurisë”.

Këto pika janë pjesë pylli prej 5–10 ha në formë çeltirash me drurë të rrallë e të vjetër, që zakonisht gjenden afër kufirit të epërm të vegetacionit pyjor të cilat duhen diktuar dhe mbrojtur nga mbarështimi i pyjeve



Fig. 6

Gjelat grumbullohen në këto pika, duke ardhur në fluturim ose më këmbë, kurse femrat vijnë si rregull në fluturim 2–3 javë më vonë. Gjelat flenë në majën e drurëve dhe në mëngjes rreth një orë para se të gdhahet fillojnë këngën. Në kohën e paradave të dashurisë, gjeli lëshon krahët poshtë (fig. 7), hap bishtin në formë erashke dhe zgjat qafën përpara. Të njëjtën gjë bën dhe femra. Kryqëzimi bëhet në tokë pasi del drita.



Fig. 7. Mashkulli dhe femra në paradën e dashurisë

Femra e bën çerdhen në tokë në një gropëz në mes të bimësisë. Në maj pjell 5–9 vezë me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë, me njolla kafe e dimensione (5,8 x 4,1 cm) (fig. 8). Intervali i pjelljes së vezëve është një në ditë, ndërsa inkubacioni fillon mbas pjelljes së vezës së fundit dhe kryhet vetëm nga femra.



Fig. 8. Vezët

Deri nga fundi i gushtit pulat arrijnë të japin mesatarisht 2–3 shpendë për pulë, duke pasur një tregues mesatar riprodhimi prej 0,7 shpendë të rritur për pulë. Shpendët janë nidifugë. Në momentin e çeljes janë të mbuluar me një push të verdhë me njolla të zeza në kokë dhe në qafë dhe njolla kafe në shpinë e krahë. Disa orë mbas çeljes shpendët braktisin çerdhen, kurse 8–10 ditë mbas çeljes janë në gjendje të fluturojnë. Shpendët ndahen nga femra mbasi të kenë mbushur moshën 4 muajsh, kohë kur arrijnë edhe peshën e të rriturve. Përqindja vjetore e mbijetesës është 70–90 % te meshkujt dhe 60–80 % te femrat.

Përqindja e mbijetesës e të rinjve nga mezi i gushtit deri në muajin pasardhës është 35%. Mbas riprodhimit ndodh ndërrimi i pendëve, i cili vazhdon deri në gusht. Është shpend dite, që në verë haset si rregull në tokë, kurse në dimër mbi drurë, i qëndrueshëm. Fle mbi drurë bile shpesh për disa net në të njëjtën degë.



Fig. 9. Jashtëqitjet e gjelit të egër

1.9.2 RITMI I AKTIVITETIT DITOR

Gjeli i egër është aktiv sidomos në fillim dhe në fund të ditës. Në agim ai lë vendin ku ka fjetur (që si rregull është një degë e një druri të lartë) në kërkim të ushqimit. Ky dru shpesh diktohet nga prezencja nën kurorën e tij të jashtëqitjeve të gjelit.

Mbasi ngopet ai kalon pjesën tjetër të ditës i fshehur në barin e lartë ose në filizerinë e dendur, nën degët e ulëta të një druri ose hipën përsëri në degët e larta të drurëve, sipas stinës. Kjo periudhë e

gjatë çlodhjeje shpesh ndërpritet nga periudha të shkurtra aktiviteti që i kushtohen të ushqyerit ose për të bërë banjat e tij të pluhurit. Në sezonin e riprodhimit meshkujt fillojnë të këndojnë një orë para daljes së diellit dhe mund të qëndrojnë në arenë nga një deri në tetë orë në funksion të kushteve atmosferike, numrit të shpendëve në arenë, prezencës ose mungesës së pulave etj.

Aktiviteti i këngës rifillon në mbrëmje, por është më i shkurtër. Ndryshe nga të rriturit, të rinjtë ushqehen thuhetse gjithë ditën afërsisht 16 orë në korrik, nëse temperatura është e mjaftueshme. Gjatë kohës së keqe shpendët mund të qëndrojnë për një kohë të gjatë nën krahët e nënës së tyre në vend që të ushqehen. Në këtë rast mund të ndodhin humbje të rëndësishme.

Meshkujt kanë tendencën të mbrojnë një territor riprodhimi sa më afër që të jetë e mundur nga vendi ku kanë lindur dhe të rikthehen po në vendin ku kanë lindur për të kryer linjërzhimin veror, ndërsa femrat qëndrojnë në vende dimërimi dhe riprodhimi më larg nga vendi i tyre i lindjes, duke bërë gjatë jetës së tyre një migrim stinor midis dy zonave që ndonjëherë janë disa kilometra larg njëra-tjetrës.

1.9.3 USHQIMI

Të rriturit konsumojnë kryesisht ushqim bimor, por regjimi i tyre ushqimor varion sipas stinës.

Nga nëntori deri në prill ai përbëhet thuhetse vetëm nga rreth 250 gr në ditë hala koniferësh, si *Pinus silvestris*, *Pinus uncinata*, *Abies alba*, *Juniperus communis* etj., të cilat shpendi mund t'i asimilojë në saje të aparatit tretës dhe të zorrëve të tij të mëdha që janë degëzime të tubit tretës, të cilat përmbajnë një florë bakteriale të aftë të transformojë celulozën.

Në periudhën prill–maj, rritja e nevojave energjetike të shkaktuara nga aktiviteti riprodhues bën që gjeli i egër të kërkojë ushqime të pasura në proteina. Kështu ai konsumon në këtë kohë mbirje të ahut *Fagus silvatica*, të *Sorbus aucuparia*, të *Vaccinium myrtillus*, bisqe të shelgjeve *Salix sp.*, të mështeknes *Betula verrucosa*, si dhe lulesa dhe mbirje të reja të bimëve barishtore.

Regjimi i tij ushqimor diversifikohet nga qershori në shtator, duke konsumuar rreth 150 lloje bimësh barishtore, si dhe fruta të *Vaccinium myrtillus*, *Rubus idaeus* dhe *Sorbus aucuparia*. Ky ushqim i pasur i jep atij energjinë e nevojshme për zëvendësimin e pendëve gjatë linjërzhimit. Të



ushqyerit në vjeshtë konsiston në kalimin drejt regjimit ushqimor dimëror. Për tretjen e ushqimit, gjeli i egër, si të gjithë galiformët gjellit edhe gastrolite.

Shpendët e rinj ushqehen me arthropode gjatë 4 javëve të para të jetës pastaj kalojnë progresivisht në regjimin ushqimor të të rriturve.

1.9.4 GJUEITIA: Në vendin tonë është plotësisht e ndaluar. Është e lejuar me rregulla në Austri, Bjellorusi, Bosnjë, Bullgari, Finlandë, Francë, Kazakistan, Norvegji, Ruman, Rusi, Sllovaki.

2. Njohja reale e gjendjes së tanishme e popullatës (popullatave) të gjelit të egër në Parkun e Malit të Tomorit

2.1 Sipërfaqja e përhapjes reale të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

1. Vlerësimi i sipërfaqes reale të përhapjes së gjelit të egër në Parkun e Tomorit, me qëllim që pastaj të gjenden arsyet e dendësisë së tij të vogël dhe të propozohen në vazhdim masa për shpëtimin e tij duke propozuar forma konkrete të mbrojtjes dhe mbarështrimit të popullatës (apo popullatave nëse do të ekzistojë më shumë se një e tillë).

2. Parku i Tomorit, në tërësinë e tij prej 26106 ha përbëhet nga pjesë (sipërfaqe) me destinacione dhe përdorime nga më të ndryshmet, si: pyje, kullota, sipërfaqe për qëllime turistike, fetare, sipërfaqe ujore apo për përdorim bujqësor etj.

3. Duke pasur parasysh karakteristikat biologjike të specieve e sidomos veçantitë e saj lidhur me kërkesat ekologjike (masive pyjore me drurë të vjetër, çeltira, nën pyll e bimësi barishtore të variueshme), nevojën e paneglizueshme të ekzistencës së një qetësie të domosdoshme larg qendrave të banuara e veprimtarive bujqësore, turistike, fetare etj., lindi nevoja që puna për përcaktimin e sipërfaqes së përhapjes së gjelit në park të ndjekë ritmikën kohore të mëposhtme:

- kërkime paraprake;
- grumbullimi i të dhënave në terren.

Paraqitja kartografike e të dhënave dhe përpunimi i modeleve të punës për përmirësimin e gjendjes.

2.2 Kërkime paraprake

Përpara se të kryhen punime në terren që lidhen me studimin e parametrave të popullatës referuar [1] së gjelit të egër në Parkun e Tomorit dhe përcaktimin e sipërfaqes së përhapjes së tij do të bëhen disa studime paraprake “në tavolinë”, duke përdorur

dokumentacionin ekzistues që do të grumbullohet si:

- dokumentacioni teknik aktual i parkut;
- dokumentacione të ish-DSHP-ve, shoqatave të gjuetarëve të të tria rrethëve;
- organizmi i një anketimi të banorëve lokalë (pylltarë, bujq, gjuetarë, mësues, nxënës shkollash etj., lidhur me konstatimet që ata mund të kenë bërë me kohë për ekzistencën e gjelit të egër në park (sipas modelit të një ankete që mund të krijohet).

Sigurisht të dhënat e grumbulluara në këtë mënyrë do vlerësohen me kujdes duke i ndarë ato që janë të sigurta nga informacionet që kërkojnë një verifikim të mëtejshëm.

Puna e bërë me dokumentacionin e sipërpërmendur do të japë mundësinë të përcaktojmë sipërfaqet që meritojnë të studiohen në vazhdim, të cilat potencialisht janë sipërfaqe të shpërndarjes reale të llojit në objekt.

Do të krijohet kështu një imazh i parë i habitatit gjeografik të gjelit të egër, duke përjashtuar nga studimi territoret e papërshtatshme apo pak të frekuentuara nga lloji.

Kështu mund të përjashtohen:

- sipërfaqet që ndodhen në një altitudë nën 1200 m;
- sipërfaqet me bimësi pyjore të zonës fitoklimatike *lauretum* dhe *castanetum*;
- sipërfaqet e antropizuara;
- sipërfaqet me altitudë mbi 1900 m, të cilat normalisht nuk përmbajnë formacione pyjore.
- kjo do të bëjë të mundur një kategorizim të parë të territorit, i cili do të paraqitet në tabelën 1:

Tipi i mbulesës	Ha
Pyje halorësh (robull, pish)	27.9
Pyje fletorësh (ah, bunge, panjë mali)	90
Pyje të përziera (...)	47.8
Kullota masive	2.3
Livadhe	4.75
Toka bujqësore	0
Sipërfaqe inproduktive (shkëmbore etj.)	47
Sipërfaqe të urbanizuara	0
Shkurre	52.55
Sipërfaqe boshe	2.3
TOTALI	274.6

Tabela 1. Kategorizimi i territorit

Kështu eliminohen nga kërkimi sipërfaqet e urbanizuara, ato bujqësore, livadhet, sipërfaqet shkëmbore inproduktive dhe kullotat masive. Përcaktohen në këtë mënyrë sipërfaqet ku potencialisht mund të ekzistojë gjeli i egër dhe ku do të zhvillohen kërkimet në vazhdim. Në tërësi për Parkun e Tomorit kjo sipërfaqe rezulton të jetë: 184.55 ha.

2.3 Studimi i tipave të pyjeve që hasen në habitatin e gjelit të egër në Parkun e Tomorit, bazë për përcaktimin e dimensioneve të popullatës së tij

Në bazë të të dhënave të dokumentacionit ekzistues do të përkufizohen në terren dhe në hartë tipat e pyjeve që ekzistojnë në zonën e përhapjes së gjelit të egër. Për çdo tip pylli do të përcaktohet:

1. Emërtimi i tipit të pyllit, i cili do të jetë në përputhje me emërtimet klasike të silvikulturës, p.sh.:

- *Pinetum eldreihii* me ... (llojet treguese barishtore ...);
- *Fagetum* ... (*asperuletosum*) etj.

2. Shtrirja e çdo tipi pylli do të përfshijë pjesë të mëdha pylli që mund të përbëhen nga më shumë se

një nënparcelë, sipas ndarjes së vjetër parcelare të mbarështrimit.

3. Struktura e grumbujve pyjorë brenda çdo tipi pylli.

4. Nënpylli, duke përkrahur: shkallën e mbulimit, përbërjen, lartësinë, vlerën ushqimore etj.

5. Bimësia barishtore, duke përkrahur: përbërjen, shkallën e mbulimit, vlerën ushqimore etj.

Mbi çdo pjesë të tillë sipërfaqeje (pra mbi çdo tip pylli) do të vazhdojnë të kryhen pastaj punimet për grumbullimin e të dhënave, siç tregohet më poshtë.

2.4 Grumbullimi i të dhënave në terren lidhur me dimensionet e popullatës së gjelit të egër në Parkun e Tomorit

Këtu duhet përcaktuar:

1. Prezenca e saktë të llojit (në territorin e presupozuar të ekzistencës së tij);

2. Dendësinë, pra mundësinë për të njohur numrin e individëve për njësi sipërfaqeje dhe për krejt territorin;




Fig. 10. Harta e shtrirjes së territorit ku është dëgjuar gjeli i Egër



Për të bërë monitorimin e gjelit të egër (pra për të përcaktuar prezencën dhe dendësinë) mund të përdoren metoda të ndryshme, të cilat ndryshojnë nga njëra-tjetra nga periudha e vitit kur kryhet monitorimi, saktësia e të dhënave që synohet të grumbullohen, si dhe koha e punës dhe e fondeve që disponohen.

Në vazhdim do të përshkruajmë shkurtimisht përmbajtjen e këtyre metodave:

2.5 Metodat e monitorimit të popullatave të gjelit të egër

Nga literatura dallohen tre tipa monitorimi:

- a) monitorimi në periudhën e riprodhimit;
- b) monitorimi veror;
- c) monitorimi dimëror.

Monitorimi i popullatave kërkon një njohje të mirë të terrenit dhe një motivim, i cili të garantojë etikën e punës së kryer. Që të mund të vlerësohen dhe të shfrytëzohen si duhet rezultatet ato duhet të formalizohen dhe të standardizohen. Prandaj të gjitha veprimet (aksionet) që do të ndërmerren duhet të parashikohen në një material të hartuar paraprakisht, sikurse po veprohet në rastin konkret, i cili nuk duhet të ndryshohet deri në fund të punimeve.

Në fakt nga shumë autorë janë hartuar (parashikuar) metoda të ndryshme të vrojtimit (monitorimit), si dhe kartelat (formularët) teknike përkatëse, që do të përdoren për regjistrimin e të dhënave. Në çdo rast koordinatori (zbatuesi) lokal i kërkimeve është përgjegjës për funksionimin e mirë të dispozitivit të hartuar.

2.6 Monitorimi në periudhën e riprodhimit

Në këtë epoke mund të përfitohet një maksimum të dhënash me një minimum shqetësimi, me kusht që të respektohen rigorozisht metodat e parashikuara. Konkretisht janë hartuar tri metoda [9][1]:

a) Numërim duke vëzhguar nga pika fikse

Metodë që zbatohet në vende fikse (të qëndrueshme), që nuk janë gjë tjetër veçse sipërfaqet e këngës (arena), kur ato janë diktuar prej kohësh nga kënga e meshkujve. Këto pika shënohen në hartë nëpërmjet aparatit GPS, me të cilin duhet të jenë pajisur vrojtuesit.

- Objektivi i metodës: Përveç numërimit të shpendëve grumbullohet, gjithashtu, një maksimum të dhënash lidhur me sjelljen e tyre.

- Metoda e punës

Vrojtuesi vendoset në vendin e vrojtimit para orës 17:00 të ditës para ditës së parashikuar për numërim. Ai do të largohet nga vendi i vrojtimit të nesërmen, duke filluar nga ora 10:00 ose ekzaktesisht një orë mbas momentit kur është konstatuar për herë të fundit prezenca e shpendëve (qoftë dhe e një ekzemplari të vetëm). Një kujdes shumë i rreptë duhet treguar si në përgatitjen e pikës së vrojtimit, afrimin tek ajo dhe maskimin e saj, ashtu edhe gjatë gjithë vrojtimit dhe daljes prej saj.

b) Numërimi me anë të afrimit dhe vrojtimit të kombinuar

Metodë që zbatohet në rastin e vendeve të këngës të paqëndrueshme ose që dihen me përafërsi por jo saktë.

- Objektivi i metodës: Të lokalizohen dhe numërohen shpendët.

- Metoda e punës

Puna në grup: Koordinatori lokal përcakton një numër pikash vrojtimi, në të cilat ai vendos vrojtuesit qoftë një ditë para, qoftë në rastin më të vonët, dy orë para daljes së diellit. Vendet e vrojtimit nuk mund të lihen para orës 10:00 e në rastin më të hershëm një orë mbas konstatimit të fundit të prezencës së shpendëve. Një kujdes shumë i rreptë duhet treguar si gjatë përgatitjes së pikave të vrojtimit, ashtu edhe gjatë vrojtimit dhe largimit nga pika përkatëse.

Puna individuale: Vrojtuesi aplikon metodën e kërkimit me anë të këngës (shih metodën më poshtë), me qëllim që të lokalizojë zonën ku janë shpendët. Gjatë vizitave të tij të tjera në arenat, tashmë të përcaktuara, vrojtuesi zbaton metodën e vëzhgimit nga pika fikse.

c) Kërkimi me anë të këngës

Metodë që zbatohet në zonat ku nuk ka vende (sipërfaqe) të këngës të përcaktuara mirë dhe në zona ku presupozohet se ka prezencë të shpendit (sipas të dhënave të reja ose të vjetra).

- Objektivi i metodës: Të lokalizohet vendndodhja ose të shënohen kontakte zanore ose vizuale me shpendët.

- Metoda e punës: Vrojtuesi parashikon një itinerar të lëvizjes së tij në zonën ku presupozohet se ka shpendë, njëloj siç veprohet në rastin e metodës së inventarizimit me vrojtues të lëvizshëm “transekt” (për detaje shih librin “Biologjia dhe mbarështrimi i faunës së gjuetisë”, A. Postoli 2017). Këtë itinerar ai e përshkon të shumtën një herë në



muaj nga marsi në qershor, qoftë shumë herët në mëngjes për të kërkuar një kontakt zanor, qoftë ditën për të kërkuar tregues të tjerë. Në të gjitha rastet lëvizjet (spostimet) konkretizohen në një plan ditor dhe stinor që hartohet nga drejtuesi i kërkimeve të terrenit dhe bëhen me kujdes dhe koncentrim të madh të vëmendjes, me qëllim që të rriten shanset për të pasur “indicie” dhe për të limituar shqetësimet. Në rastin e një kontakti zanor ose vizual nuk duhet tentuar t’u afroresh shpendëve. Të gjitha konstatimet e realizuara nga vrojtesit i transmetohen në fund të çdo dite pune drejtuesit të kërkimeve në terren i cili nga ana e vet bën të njëjtën gjë ndaj drejtuesit të punimeve në rang parku.

2.7 Monitorimi në periudhën dimërore

a) Kërkimi dimëror (varianti i parë):

Metodë që zbatohet gjatë daljeve dimërore sidomos në zonat në të cilat presupozohet një prezencë e shpendëve (të dhëna të reja ose të vjetra).

- Objektivi i metodës: Të rilevohen tregues dimërorë

- Metoda e punës: Të përcaktohet dhe të paraqitet në kartelën e kërkimeve dimërore plani i një përshkimi të terrenit, i cili mund të kontribuojë në mbledhjen e indekseve dimërore. Midis nëntorit dhe shkurtit, kur kushtet janë të favorshme, të realizohen dy përshkime (kalime të tipit transekt) të terrenit dhe të shënohen të gjitha vërtetimet (konstatimet) në kartelën e përmendur më sipër. Nuk bëhet asnjë përshkrim tjetër dimëror, për të mos shqetësuar individët që dimërojnë në sektorin përkatës.

b) Kërkimi dimëror (varianti i dytë)

Metodë që zbatohet gjatë daljeve dimërore në korridoret e qarkullimit, veçanërisht në zonat ku prezenca e shpendëve është vërtetuar, me qëllim që të njihen kushtet e dimërimit të llojit.

- Objektivi i metodës: Të zbulohen treguesit e mundshëm dimërorë dhe të mbikëqyret frekuenca e tyre.

- Metoda e punës: Vrojtesit përshkon më këmbë zonën ku është i përhapur shpendi dhe kërkon gjurmë të ndryshme të hyrjes së shpendit, duke shfrytëzuar brenda mundësive ndihmën që jep shtresa e dëborës që mund të jetë prezente. Të gjitha gjurmët e ekskrementeve, pendëve etj., të konstatuara i përcillen koordinatorit gjatë bilancit të daljeve dimërore (transekt).

2.8 Monitorimi veror

Në disa zona pilot, duke përfutur nga statusi i veçantë i procesit të menaxhimit, një monitorim veror i riprodhimit komplet format e tjera të monitorimit, me qëllim që të plotësohet vlerësimi i ndikimit të masave që janë zbatuar.

- Objektivi i metodës: Në një sektor të dhënë grumbullohen maksimumi i treguesve të cilët lejojnë të vlerësohet suksesi i riprodhimit të llojit.

- Metoda e punës: Kërkohen tregues në një kalim të caktuar (transekt) në kërkim të gjurmëve të riprodhimit (lëvozhga vezësh, vezë të paçelura, pupla) dhe tregues të prezencës verore (pupla të linjëzimit etj.). Mund të përdoret edhe metoda me çuarje për përcaktimin e numrit të shpendëve. [1]

2.9 Praktika e monitorimit

Në rastin e studimit tonë monitorimi do të bëhet:

a) Gjatë periudhës maj–qershor (kur shpendët janë në fazën e arenave), duke përdorur “metodat e monitorimit gjatë periudhës së riprodhimit” ose “periudhës së këngës”, siç quhet duke përfshirë si këngën e natës ashtu dhe atë të ditës) për të gjetur gjurmë eventuale të prezencës së shpendit.

b) Gjatë periudhës së verës korrik–shtator, që përkon me fazën e rritjes së të vegjëleve, duke përdorur “metodën e kërkimit veror”.

Numri i vërtetimeve (fiks) apo i kalimeve (transekt), si dhe i sipërfaqeve përkatëse të prekura nga studimi do të përcaktohet në terren, në bazë të:

- të dhënave paraprake orientuese mbi përhapjen e gjelit;

- shtrirjes dhe konfiguracionit të zonës së përhapjes së shpendit;

- numrit të popullatave të presupozuara se ekzistojnë.

Paralelisht me vërtetimet e bëra për prezencën dhe dendësinë e species (gjelit) do të grumbullohen edhe të dhëna me karakter ambiental në vendet (zonat) në të cilat konstatohet prezenca e shpendit. Në këto vende përcaktohen sipërfaqe rievimi kampion për të studiuar karakteristikat pyjore dhe të vegjetacionit. Këto sipërfaqe bëhen rrethore me rreze 20 metra, në të cilat përcaktohet:

- përbërja e pyllit;

- kurorëndësia dhe trundendësia e pyllit;

- nënpylli, përbërja e tij, shkalla e mbulimit, lartësia etj.

Një punë e ngjashme bëhet edhe për vegjetacionin barishtor për grumbullimin e të



dhënave të sipërfaqeve kampion të zgjedhura. Përpunimi i të dhënave pyjore dhe i atyre të vegjetacionit, lidhur ky edhe me panoramën e përgjithshme të krejt territorit do të lejojë të përcaktohen korrelacione të rëndësishme mbi preferencat që gjeli i egër ka lidhur me habitatin.

2.9.1 Rezultatet e rëlvimeve

2.9.2 Rëlvime (numërime) pranverore

Të dhënat e grumbulluara nga rëlvimet pranverore do të grumbullohen e paraqiten në një tabelë si më poshtë (tabela 2):

Vendi (grupi i nënparcelave) ku është kryer vrojtimi me kalim (transekt)	Vrojtim direkt	Gjurmë	Viti i rëlvimit	Karakterizimi i vendit të këngës (arenës)
1. Shpati i...	X	X	2019	I sigurt
2. Pylli i...	-	X	2019	I mundshëm
•	•	•	•	•
•	•	•	•	•

Tabela 2. Rëlvimet pranverore

Në funksion të të dhënave të grumbulluara dhe përpunuara do të nxirren pastaj konkluzione lidhur me prezencën e gjelit të egër në vendin përkatës, dendësinë e tij dhe sigurinë e pohimeve përkatëse.

2.9.3 Rëlvime verore

Tregohet sa përshkime të territorit (grup-parcelave) janë bërë me metodën “transekt”, duke shënuar konstatimet, si për prezencën e shpendëve, ashtu dhe gjurmët e tyre (pupla, glasa etj.). Edhe për këtë rast të dhënat pasqyrohen në një tabelë si tabela 2.

Bëhen, gjithashtu, rëlvime me metodën e çuarjes në zona ku presupozohet se femrat realizojnë rritjen e të vegjëlve. Për këto zona bëhet:

- Përshkrimi i zonës (bimësia, relievi etj.);
- Sipërfaqja e çuarjes (si rregull, rreth 50 ha);
- Kundrejtimi;
- Numri i nevojshëm i çuarjeve;
- Gjatësia maksimale e çuarjeve (si rregull 1300–1600 m);
- Të dhënat e çuarjeve përmbledhen në një tabelë si më poshtë tabela 3.

Emërtimi i sipërfaqes e përshkuar nga çuarja dhe madhësia ha	Data e numërimit	Vrojtuesit e çuarjeve	Rezultatet
1. Pusi i ... 50 ha	25.6.2019	9	Kemi 11 sinjalizime të gjelit nga të cilat: 1 çerdhe (mbetjet) 1 femër e ngordhur 5 shenja glasash 4 shenja puplash
•	•	•	•
•	•	•	•

Tabela 3. Të dhëna mbi çuarjet

Kështu plotësohet tabela edhe për sipërfaqe të tjera ku eventualisht janë bërë çuarje. Këto të dhëna (pra numri i gjurmëve apo sinjalizimeve) shërbejnë për të vlerësuar numrin e shpendëve, duke lejuar njëkohësisht përcaktimin apo konfirmimin e sipërfaqeve me të favorshme për rritjen e shpendëve të rinj.

Përpunimi i të dhënave bëhet sipas udhëzimeve të treguara për metodën e numërimit (inventarizimit) me sipërfaqe prove fikse dhe për metodën e numërimit me anë të përshkimit (apo e vrojtuesit, vrojtimit të lëvizshëm – transekt).

3. Gjendja e popullatës së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Mali të Tomorit.

3.1. Efektivi i vlerësuar për tërë parkun (nëse do të kemi të bëjmë me një popullatë të vetme) ose për pjesë të caktuara të tij (nëse do të kemi të bëjmë me më shumë se një popullatë).

Për kuptimin e konceptit të popullatës dhe mënyrën e përkufizimit i referohemi literaturës [1]. Përcaktimi i numrit të individëve për çdo popullatë do të bëhet duke përdorur

metodologjinë e llogaritjes për secilën metodë të përshkruar në literaturën [1].

3.2 Fiksimi në hartë dhe përshkrimi i vendeve të këngës (arenave) të determinuara bazë për përsëritjen e numërimeve në vitet e ardhshme

Duke përdorur një hartë 1:25000 dhe një pajisje GPS, hidhen në të vendet e këngës që është arritur të diktohen dhe bëhet përshkrimi i tyre, duke dhënë sipërfaqen, duke përshkruar bimësinë e arenës si mbulesën drunore atë të nënpyllit dhe bimësinë barishtore me të gjitha elementet e tyre si përbërja, kurorëndësia, moshë, gjendja fitosanitare etj.

Vendet e këngës rankohen edhe sipas prezencës e sidomos numrit të ekzemplarëve që i frekuentojnë, intervalit kohor kur ndodh kjo (ditor dhe mujor) etj.

Për vendet e këngës shikohet edhe mundësia që ekziston për ndërtimin e “kullave vrojtuese” (fig. 11) si pajisje të qëndrueshme për numërim por edhe për promovimin e gjelit të egër për ta fotografuar dhe zhvilluar turizmin elitare.




Fig. 11. Tip, kullë vrojtimi



3.3 Kërcënime ndaj popullatës së gjelit të egër në masivin e Malit të Tomorit

Sikurse tregohet nga të dhënat ekzistuese të publikuara nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Berat popullata e gjelit të egër në Malin e Tomorit ka pësuar rënie të madhe, por sot mbas zbatimit të moratoriumit të gjuetisë konstatohet një popullatë e aftë të riprodhohet por që nuk është arritur të fotografohet.

Prandaj, lidhur me kërcënimet që ekzistojnë ndaj gjelit të egër do të bëhen vlerësime me anë të dokumentacionit ekzistues:

a) të dhëna të ish-DSHP-ve Berat, Skrapar dhe Gramsh;

b) të dhëna të shoqatave të gjuetarëve të këtyre rretheve (nëse këto të dhëna ekzistojnë).

Anketimit që duhet bërë nga ADZM Berat me popullsinë lokale, pylltarët, nxënësit e shkollave dhe gjuetarët duhet të bazohet, në:

a) Vrasjet që mund të jenë bërë gjatë 5 viteve të fundit nga gjuetia e paligjshme (brakonazhi) e cila është vështirë të zbulohet.

b) Sëmundjet: Edhe pse treguesi i sëmundjeve infektive dhe parazitare të gjeli i egër është i vogël, në rastin kur shpendët d.m.th. zona e përhapjes së tyre reale, është afër zonave ku ka një aktivitet të caktuar njerëzor (fshatra, shpendë të buta, restorante ku konsumohet mish shpendësh të buta dhe të egra, pista të lëvizjes së turistëve etj.) nga studimet e kryera në vende të tjera të zhvilluara, konstatohet se infestimi nga koksidet, certodat, dhe nematodat mund të përbëjë një rrezik të rëndësishëm për gjelin e egër.

c) Predacioni: Nga zardaifi, kunadhja dhe dhelpra, i cili ndodh mbi vezët në çerdhe të cilat ndërtohen në tokë dhe ndaj shpendëve të rinj deri sa janë më të vegjël se 10 ditë është faktori kryesor që kufizon suksesin e riprodhimit të gjelit të egër.

Edhe derri i egër kur është tepër i dendur në numër është një dëmtues i rëndësishëm i çerdheve dhe i shpendëve të rinj. Predacioni i shpendëve rrëmbenës është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që rrit mortalitetin e gjelave të rinj por edhe të të rriturve.

Për këto arsye gjatë vërtetimeve në terren për rëqvimet e të gjitha llojeve do të përqipemi të vërtetojmë edhe dendësinë e këtyre rrëmbenësve për të parashikuar më pas masa për kufizimin apo edhe luftimin e tyre.

d) Infrastrukturat dhe frekuentimi turistik i parkut

- Rugët e hyrjes dhe të aksesit në park, ndërtesat, pistat e skive, zonat e pelegrinazhit fetar, ato të piknikut etj., shkaktojnë një zvogëlim kuptimplotë të popullatës së gjelit që mund të çojë deri në zhdukjen e tij.

- Mortaliteti i shkaktuar nga kabllot elektrike ndikon, gjithashtu, negativisht mbi dinamikën e popullatës së gjelit të egër.

- Ekzistenca e rrugëve pyjore dhe atyre të qarkullimit të kopeve shpesh janë shkak i intensifikimit të punimeve silvikulturale dhe zooteknike që ngandonjëherë prekin cilësinë e habitateve, mbasi ato sjellin në mënyrë thuajse sistematike një rritje të veprimtarive turistike, dhe të gjuetisë. Megjithëse këtu mund të thuhet se aktivitetet turistike verore (si ekskursione të drejtura etj.) janë më pak të dëmshme për gjelin e egër se sa ato dimërore me përjashtim të rasteve kur ato janë tepër masive dhe të paorganizuara mirë.

e) Degradimi dhe modifikimi i habitateve

Në shumë vende të botës degradimi dhe modifikimi i habitateve ka qenë faktori më i rëndësishëm i pakësimit progresiv të këtij shpendi të egër. Ndër këta faktorë negativë më të rëndësishmit janë:

- Zvogëlimi ose ndalimi i plotë i kullotës në pyje;

- Intensifikimi i prodhimit silvikultural (plantacione pyjore me dendësi të madhe, konvertimi i pyjeve në trungishte të rregullta, ripërtëritja masive e pyjeve) dhe të gjitha praktikatat që çojnë në përgjithësi në një mbyllje pak a shumë totale të grumbujve dhe në një mbyllje të nënpyllit dhe të vegetacionit barishtor;

- Degradimi dhe shkatërrimi i kateve të ulëta të vegetacionit pyjor të domosdoshme për shpendët e rinj;

- Mbrojtja e pyllëzimeve të reja apo e kulturave të tjera brenda habitatit të gjelit me rrethime me rrjet teli;

- Të gjitha këto janë shkaqe të një mortaliteti të lartë të gjelit të egër.

f) Kushtet meteorologjike dhe ndryshimi i tyre

- Kushtet meteorologjike gjatë periudhës së riprodhimit (nga periudha para pjelljes së vezëve deri në javët e para të jetës së shpendëve të vegjël) influencojnë fuqimisht mbi suksesin e riprodhimit.



Kështu një rritje e reshjeve dhe zvogëlim i temperaturave (nga ajo normale) gjatë periudhës së riprodhimit ka një efekt direkt mbi produktivitetin e riprodhimit.

- Përveç këtyre analizat me të fundit të kryera në vende të zhvilluara tregojnë se ka një tendencë që gjeli i egër të riprodhohet më herët (nga pikëpamja stinore) gjë që bën që kulmi i çeljeve të korrespondojë në një periudhë me kushte meteorologjike të dëmshme për shpendët e rinj.

4. Identifikimi i vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë që janë përfshirë direkt në menaxhimin e habitatit/species dhe analiza SWOT

4.1 Autoritetet qendrore

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

ka rolin kryesor të politikëbërjes dhe të monitorimit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri. Detyrat kryesore të MTM-së, në lidhje me biodiversitetin janë:

- zhvillon dhe publikon strategji/plane për komponentët e mjedisit;
- zhvillon dhe miraton kornizën ligjore për mbrojtjen e mjedisit;
- miraton dhe monitoron standardet mjedisore;
- informon dhe ndërgjegjëson komunitetet për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm.

Ministria ka disa institucione në varësi të përdorura si organe teknike në përmbushjen e detyrave. ata janë:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

Është një institucion publik që punon në gjithë territorin, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Mjedisit. Detyrat kryesore të Agjencisë kanë të bëjnë me monitorimin e elementeve mjedisore dhe raportimin përmes “Raportit të gjendjes së mjedisit”. Një tjetër detyrë është edhe leja mjedisore përmes procesit të VNM-së.

- **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)** e themeluar në shkurt të 2015, me strukturat e saj rajonale (administratat rajonale të zonave të mbrojtura) është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura dhe zbatimin e planeve të menaxhimit. Staf i administratës së zonës së mbrojtur ka funksion koordinues dhe informativ për të siguruar një zbatim më të mirë të praktikave ligjore, në lidhje me ruajtjen e natyrës, biodiversitetit, zonat e mbrojtura dhe peizazhin.

- **Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ADZM, Berat** është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura dhe zbatimin e planit të menaxhimit për Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

Kjo Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka katër shtylla kryesore: i. energjinë; ii. zhvillimin e infrastrukturës; iii. zhvillimin industrial, iv. zhvillimin urban.

Institucioni kryesor në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për planifikimin hapësinor është **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)**, përgjegjëse për koordinimin e proceseve të hartimit të dokumenteve të planifikimit territorial dhe të zhvillimit, të cilat janë ndërmarrë nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror dhe lokal.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)** është institucioni kryesor qeveritar që merret me bujqësinë dhe zhvillimin rural.

- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me Drejtorinë Arsimore Rajonale, qarku Berat**, të cilat promovojnë përmes përfshirjes së informacionit për ruajtjen e habitateve/specieve në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit në kurrikulat arsimore.

- Institucionet kërkimore dhe universitetet.

4.2 Autoritetet lokale

- **Njësitë e qeverisjes vendore** (komunat, njësitë administrative), detyrat kryesore janë miratimi i instrumenteve të planifikimit, lëshimi i lejeve për zhvillim dhe ndërtim, miratimi i rregulloreve të planifikimit dhe ndërtimit në nivel lokal, sigurimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve, përfshirë furnizimin me ujë dhe kanalizimet, menaxhimin e integruar të mbetjeve etj.

- **Prefekturat e Beratit dhe Gramshit** kanë për detyrë të kontrollojnë përputhshmërinë ligjore të vendimeve të bëra nga njësitë e planifikimit lokal.

- **Organizatat dhe shoqatat jofitimprurëse**, të cilat mbështesin iniciativat e komunitetit lokal, duke përfshirë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera lokale ekonomike, ruajtjen e biodiversitetit dhe rritjen e ndërgjegjësisimit. Shoqatat më të rëndësishme dhe ato që luajnë rol në mbrojtjen e habitateve/specieve janë PPNEA, INCA.



- **Shoqatat e gjuetisë**, ndalimi i gjuetisë së paligjshme dhe përmirësimi i habitateve për specie të veçanta të faunës.

- **Subjektet fetare** promovojnë vlerat fetare dhe kulturore të zonës, organizojnë aktivitete fetare dhe maksimizojnë pjesëmarrjen e publikut.

- **Banorët vendës:** pronarët lokalë të tokës, përfitojnë nga turizmi dhe zhvillimi i infrastrukturës, maksimizojnë përfitimet e tyre ekonomike nga aktivitete të ndryshme.

- **Institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e pranishëm në Shqipëri**, përmes

projekteve dhe aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen e habitateve/specie, janë UNDP, Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, WWF etj.

4.3 Analiza SWOT

Kjo analizë është e çmuar në theksimin e potencialeve në zonë, duke identifikuar problemet për t'u përmirësuar ose shmangur në menaxhimin e ardhshëm, duke përcaktuar kërcënimet ekologjike dhe social-ekonomike dhe mundësitë e ardhshme për zhvillim.

Pikat e forta	Dobësitë
-Habitatë të ndryshme të shpërndara në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, pyje natyrore dhe të vjetra, kullota, shqopishte dhe shoqërime të bimësisë së ulët; -Faunë e pasur në PK i Malit të Tomorit – grupe kryesore taksonomike të pranishme, prania e llojeve të rralla, endemike; -Galliformet ofrojnë kandidatë të përshtatshëm për ripopullim me qëllim që t'i ruajmë ato. Ekziston një rrezik i ulët i migrimit ose lëvizjes jashtë territorit në krahasim me llojet e tjera të shpendëve; -Rendi i Galliformeve përfshin një popullatë ideale të shpendëve për hulumtime në situata eksperimentale; -Forcimi i sistemit të menaxhimit të ZM-së. Ngritja e Komitetit të Menaxhimit të PK të Malit të Tomorit; -Krijimi i AKZM-së dhe ADZM Berat, të cilët monitorojnë dhe menaxhojnë territorin e PK të Malit të Tomorit; -Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit me zonimin përkatës të territorit; -Partneritet i fuqishëm për të siguruar përfshirjen e të gjithë aktorëve;	-Prerje intensive të drurëve; -Mungesa e monitorimit dhe sistemit të menaxhimit të zjarreve; -Informacion të kufizuar rreth veçorive të natyrës dhe zonës së mbrojtur; -Praktika të paligjshme dhe të palejuara të gjuetisë; -Ekziston informacion i pakët lidhur me këtë aspekt, sidomos për sa iu përket Galliformeve dhe impaktin e tyre me komunitetin; -Përkrahje e pakët e komunitetit lokal në procesin e ripopullimit të shpendëve në mënyrë që të jetë i suksesshëm; -Mungesa e mbështetjes në nivel lokal mund t'i bëjë aspekte të ndryshme të ripopullimit, shumë të vështira apo të pamundura për t'u realizuar; -Mungesa e eksperteve lokal apo rajonal; -Mungesë koordinimi mes aktorëve kryesorë dhe anëtareve të Komitetit të Menaxhimit; -Mungesë bashkëpunimi me institucionet lokale;
Mundësitë	Kërcënimet
-Impakte pozitive sociale-ekonomike për komunitetin; -Ekosisteme të mundshme për studime kërkime shkencore për institucionet kërkimore dhe studentët; -Ndërgjegjësim për mbrojtjen e kësaj specie nga komuniteti lokal dhe edukim mjedisor për nxënësit të shkollave; -Ndryshimi i perceptimit që ka komuniteti në lidhje me gjelin e egër; -Ruajtja e specieve individuale; -Reduktimi i humbjeve të biodiversitetit brenda rendit të Galliformeve; -Informacione/trajtime mbi ruajtjen e gjelit të egër; -Prirje të rritjes së mundshme të ekoturizmit; -Rritja e interesit nga turistët ndërkombëtarë dhe lokalë.	-Prerja e paligjshme e drurëve; -Humbje të habitatit dhe fragmentim të tij; -Erozioni; -Modifikime gjeomorfologjike; -Mungesa e eksperteve lokale apo rajonal; -Mungesa e mbështetjes në nivel lokal; -Mungesa e aksesit në strukturën e komunitetit;

Tabela 4. Analiza SWOT



Pikat e forta – Mundësitë

- Bashkëpunimi me eksperte për hulumtime rreth *Tetrao Urogallus*.

- Aplikimi i të dhënave të përditësuara mbi bioteknologjinë për të optimizuar ruajtjen e *Tetrao Urogallus*.

Pikat e forta – Kërcënime

- Shtimi i numrit të stafit për të monitoruar specien *Tetrao Urogallus*.

- Përcaktimi i rregullave për kushtet e përshtatshme për habitatin e domosdoshëm për *Tetrao Urogallus*.

- Monitorimi i vazhdueshëm i zonës (habitatit) që është e prekshme nga presionet e ndryshme.

Dobësi – Mundësitë

- Shpërndarje informacioni/trajnime rreth ruajtjes së *Tetrao Urogallus*.

- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zonave të Mbrojtura Rajonale Berat, si dhe të ADZM-ve të tjera.

5. Përcaktimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë për ruajtjen e habitateve/specieve në periodha afatshkurtra, të mesme dhe të gjata.

Objekti i kryesor është përballja me humbjen e biodiversitetit, duke përcaktuar strategji të përbashkët për të ruajtur trashëgiminë natyrore dhe peizazhin në zonën e Adriatikut të ulët, me prioritet për speciet e mbrojtura nga direktivat e 92/43/EEC dhe direktiva 79/409/EEC, tipike për këto ekorajone dhe/ose të kërcënuara nga variacionet mjedisore të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe menaxhimi i gabuar.

Objektivat specifikë janë:

- Ndikim në politikat e mbrojtjes së mjedisit;

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit përmes qasjeve të integruara dhe aktiviteteve të bashkëpunimit, duke gjeneruar mjete konkrete dhe rezultate që favorizojnë rritjen e qëndrueshme afatgjatë jo vetëm në zonat e përfshira, por edhe në zona të tjera që nuk përfshihen drejtpërdrejt;

- Përmirësimi i nivelit të mbrojtjes së specieve/habitatave të përcaktuara dhe forcimi i bashkëpunimit publik-privat për të nxitur ruajtjen afatgjatë të mjedisit (zbatimi konkret i Strategjisë së Përbashkët Ndërkufitare nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ruajtjen e habitateve dhe të specieve);

- Vendosja e një ekuilibër të mirë midis zhvillimit social-ekonomik dhe mbrojtjes së

mjedisit, nëpërmjet ndërhyrjeve konkrete dhe rritjes së ndërgjegjësimit me anë të veprimeve sensibilizuese. Projekti do të japë rezultate konkrete dhe mjete që lejojnë përcaktimin e rrugëve të mundshme të zhvillimit, duke përfutur nga shkëmbimi i njohurive.

Më konkretisht, plani i konservimit dhe ripopullimi i Galliformeve ka si qëllim krijimin e një popullatë të lirë dhe të shëndetshme. Kjo gjë do të kontribuonte në ruajtjen e specieve individuale dhe reduktimin e humbjeve të biodiversitetit brenda rendit.

Qëllimi i këtij programi ripopullimi është vendosja e një popullate, e cila do të jetë e shëndetshme në terma afatgjatë, kjo gjë mund të arrihet nëpërmjet dy objektivave:

Objekti i parë ka të bëjë me mbarështrimin e suksesshëm nëpërmjet rifutjes së individëve dhe pasardhësve të tyre, në mënyrë të tillë që popullatat e rivendosura mund të lidhen me popullatat ekzistuese përreth dhe në këtë mënyrë të shmanget mundësia e incestit. Për të rritur sigurinë e shpendëve të rifutur, në rastin tonë kjo është shumë e vështirë, për shkak të vështirësisë të gjendjes së specieve për ripopullim.

Objekti i dytë do të ishte lënia e menaxhimit të tyre nga komuniteti, menaxhim i cili nëse do të jetë i përshtatshëm mund të konvertohet në përfitim financiar (p.sh. nëpërmjet turizmit). Kjo është parashikuar në këtë projekt, pra përfshirja e gjithë komunitetit lokal i cili do të ketë rol të rëndësishëm në këtë ripopullim.

Ndërsa qëllimet afatgjata zakonisht përfshijnë ruajtjen e specieve dhe krijimin e një popullate të pavarur, objektivat afatshkurtër (mbijetesë, riprodhim) sigurojnë qartësi të menjëhershme mbi suksesin e zhvendosjes dhe shërbejnë si udhëzues për vendimmarrje në të ardhmen.

6. Plan i veprimeve për ruajtjen dhe rikualifikimin e habitatit dhe popullatës (popullatave) së gjelit të egër në Parkun e Tomorit.

Parku Kombëtar i Malit të Tomorit menaxhohet me anë të Planit të Menaxhimit nr. 2027, datë 31.12.2014. Vizioni për Parkun Kombëtar të Tomorit është:

Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve të Parkut Kombëtar të Tomorit, vlerës së tyre estetike dhe trashëgimisë kulturore si një vlerë unike dhe universale e bashkëjetesës dhe harmonisë së njeriut



me natyrën për brezat e ardhshëm, duke siguruar që Tomori të jetë një vend jetese, edukimi dhe çlodhjeje, si dhe ofrimi efikas i produkteve dhe i shërbimeve turistike të klasës së parë.

Dy nga objektivat afatgjatë të menaxhimit të PK të Malit të Tomorit janë:

1. Rritja e mbrojtjes dhe ruajtjes së habitateve dhe të biodiversitetit;

2. Forcimi i sistemit të menaxhimit të zonës së mbrojtur;

Në lidhje me zonimin e Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit, i cili është një aspekt i rëndësishëm i planit të menaxhimit, duke dhënë një pasqyrë më qartë të menaxhimit të burimeve dhe habitateve të specieve [3], ndahet në:

1. Zona qendrore (ZQ) – 7.484,4 ha;

2. Zona e përdorimit të qëndrueshëm (ZPQ) – 1.365,5 ha;

3. Zona e përdorimit tradicional (ZPT) – 15.640,9 ha;

4. Zona rekreative (ZR) – 232,3 ha.

Plani i veprimeve që do të ndërmerren për mbrojtjen e specieve *Tetrao Urogallus* dhe të habitateve të përshtatshme janë grupuar si më poshtë:

6.1 Përmirësimin e politikave për ruajtjen e specieve *Tetrao Urogallus* dhe të planit të menaxhimit

Plani i menaxhimit të PK të Malit të Tomorit duhet të përmirësohet me masa për të siguruar ruajtjen e habitateve kritike të gjelit të egër në malin e Tomorit dhe në zona të tjera të Shqipërisë. Palët përgjegjëse dhe ato të interesuara duhet të sigurojnë zbatimin e tij të plotë. Trajnimi i stafit të ADZM-ve dhe aktoreve të tjerë në terren është i domosdoshëm.

Grupi i punës së kërkimit në terren do të përpaket të grumbullojë të gjitha të dhënat e mundshme mbi kërcënimet që realisht ekzistojnë në park dhe të planifikojë pastaj masat adekuate që duhen propozuar dhe shpenzimet përkatëse.

Aktivitetet:

Vendosja e rojave për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së follenizimit në PK të Malit të Tomorit për periudhën janar–qershor të çdo viti. Nuk duhet të lejohet hyrja e turistëve, vizitorëve brenda zonës gjatë kësaj periudhe.

- Kontroll i shtuar i aksesit të njeriut dhe të banorëve vendës, me qëllim krijimin e një mjedisi të paqetësuar për gjelin e egër.

- Ndalimi i prerjeve/djegjeve në zonat kyçe (territoreve), ku qëndron gjeli i egër.

Prioriteti: Thelbësor

Përgjegjësia: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM); Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ADZM) të Beratit; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MTM).

Palët e tjera të interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë e Beratit, Skraparit, Gramshit, institucionet lokale, organizatat lokale, institucionet shkencore etj.

Kohëveprimi: I menjëhershëm dhe në vazhdim.

7. Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e *Tetrao Urogallus*

Duhet të promovohet një qasje e integruar për ruajtjen e habitateve nga ku do të përfitojë dhe ruajtja e llojeve të tjera. Një qasje e tillë do të mbrojë zonat nga zhvillimi i paqëndrueshëm shoqëruar me ndotje, degradim dhe humbje të habitateve. Njëkohësisht do të rrisë të ardhurat për komunitetet lokale. Përfshirja e tyre në ruajtjen dhe menaxhimin e specieve dhe të habitateve kritike është e rëndësie së veçantë.

Aktivitetet:

Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Mali të Tomorit, ku zonat ku gjeli i egër ka habitatin e tij, të përcaktohen si zona me ruajtje të veçantë.

Promovim i ruajtjes dhe i përfitimit të ndërsjellë me komunitetin lokal të fshatrave Dardhë, Kapinovë e Tomor për rimëkëmbjen e gjelit të egër, aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë.

Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendrore të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit.

Ndërtim i një kulle të vëzhgimit të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit. Ndërtimi i kësaj kulle i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vërtetimin e shpendëve.

Prioriteti: Thelbësor

Përgjegjësia: AKZM, ADZM Berati; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MTM)



Palët e tjera të interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia e Beratit, Skraparit dhe Gramshit, institucionet lokale, organizatat lokale dhe shoqëria civile etj.

Kohëveprimi: I menjëhershëm dhe në vazhdim

8. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Aktivitetet:

Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje, si Italia dhe Mali i Zi, nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara.

Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të vendeve fqinje në mbrojtje të biodiversitetit, veçanërisht të species gjelit të egër.

Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkëta të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit.

Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e gjelrit të egër për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet.

Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga Italia dhe Mali i Zi, duke shkëmbyer praktikat më të mira.

Prioriteti: I mesëm

Përgjegjësia: MTM, AKZM; ADZM Berat;

Palët e tjera të interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia e Beratit, Skraparit dhe Gramshit, institucionet lokale, organizatat lokale, institucionet shkencore etj.

Kohëveprimi: I mesëm dhe në vazhdim

8.1. Menaxhimi dhe monitorimi i llojit *Tetrao Urogallos* dhe ruajtjen e habitatit

8.2 Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit

Sikurse është vepruar kudo në botë në rezervatet e gjelrit të egër për mbrojtjen dhe shtyrjen në gjendje normale të popullatës së tij edhe në Parkun e Tomorit duhen planifikuar dhe realizuar gradualisht e për një kohë të gjatë një seri masash (aktivitete), ndër të cilat vend themelor zënë ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e habitatit të cilat shkurtimisht janë, si më poshtë:

- Trajtimi i pyjeve, duke pasur parasysh në mënyrë sistematike kërkesat e gjelrit të egër në

tërësinë e sipërfaqes së përhapjes së tij e veçanërisht mjediset vitale, siç janë:

- vendet e këngës (arenat);
- vendet e folezimit;
- vendet e rritjes së shpendëve etj.

- Strukturimi i grumbujve pyjorë, siç tregohet në fig. 11, e cila paraqet rastin ideal të një strukture pyjore të favorshme për zhvillimin e natyrshëm të popullatave të këtij shpendi. Realizimi i kësaj strukture do të jetë qëllimi strategjik afatgjatë i trajtimit të pyjeve që do të realizohet gradualisht e për një kohë të gjatë nëpërmjet masave kulturore që do të planifikohen e zbatohen.

- Evitimi i mbylljes së tepruar e grumbujve pyjorë për një kohë të gjatë, duke favorizuar hapjen e tyre me të gjitha mënyrat e mundshme nëpërmjet përdorimit të metodave të përshtatshme silvikulturore ose nëpërmjet lejit të një kullote të arsyeshme në pyll.

- Krijimi, kur kjo është e mundur, të një strukture të çrregullt e grumbujve pyjorë, duke favorizuar përzierjen e llojeve.

- Mbatja e një dendësie të tillë e dythundrakëve (kur ata ekzistojnë) që të mos shkaktohet një zhdukje e plotë e nënpyllit dhe e bimësisë barishtore.

- Të ruhet të paktën 30% e sipërfaqes me vegetacion drunor mbi kufirin e epërm të vegetacionit pyjor, e paprekur dhe e padjegur nga punimet e përmirësimit të kullotave, në zonat ku gjendet gjeli i egër duke kursyer pishat gjatë prerjeve kulturore.

8.3 Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve

- Brenda dhe në periferi të zonave që përdoren për sportin e skive të vendosen nën mbrojtje të plotë zonat e dimërimit të gjelrit të egër gjë që bën që shpendët të mbahen edhe në distancë të afërt nga zona e menaxhuar për këtë qëllim.

- Në të gjitha rastet e krijimit të zonave të reja për qëllime sportive dhe turistike, si dhe kur vendosen sinjalizime të rrugëve apo të rrugicave, gjurmët e vijave (rrugëve) të lëvizjes duhet të respektojnë (evitohen) zonat e dimërimit të gjelrit të egër.

- Përdorimi i rrugëve pyjore dhe i atyre të lëvizjes së kopeve të kafshëve të buta që shkojnë për kullotë t'u besohet vetëm profesionistëve.

- Transporti me teleferik mund të përbëjë një alternative efikase në krijimin e mundësive të



transportit, sepse eviton ndërtimin e rrugëve në habitatet e gjelit të egër.

8.4 Masa lidhur me gjuetinë dhe problematiken e lindur prej saj

Për momentin gjuetia është një aktivitet që nuk mund të lejohet absolutisht në parkun e Tomorit.

- Nëse mbas një numri vitesh verifikohet që popullatat e gjelit të egër e kanë rimarrë veten (pra do të kenë arritur stadin e një popullate të mbarështruar), si kudo në botën e qytetëruar edhe në parkun e Tomorit, do të bëhej i mundur edhe një shfrytëzim i tyre për qëllime gjuetie. Në këtë rast aplikimi i një “plani gjuetie” do të lejonte të kontrollohej përqindja e vjeljeve (vrasjeve).

- Identifikimi individual i ekzemplareve të vjelë legalisht lejon, gjithashtu, të lehtësohet mënjanimi i brakonazhit dhe trafikut të shpendëve.

- Kuotat e vjeljeve përcaktohen çdo vit në funksion të gjelave që janë prezent në hapjen e gjuetisë dhe të suksesit të riprodhimit.

- Efektivi i meshkujve të rritur mund të vlerësohet mbi bazën e numërimit të këngëve të realizuara në maj dhe të përqindjes së tyre të mbijetesës nga pranvera në vjeshtë e cila nga studimet e realizuara në vende të tjera rezulton të jetë 90%.

Planifikimet duhet të bëhen sipas rekomandimeve të mëposhtme:

- Numri i gjelave të vitit vlerësohet në funksion të treguesit të riprodhimit (që është numri i shpendëve të rinj për individë të rritur) të vrojtuar në zonën përkatëse nëpërmjet numërimeve të bëra me anë të “individëve meshkuj kryesor riprodhues” në muajin gusht, duke pasur parasysh një raport të ekuilibruar seksesh (gjinish).

- Efekti i gjuetisë së kontrolluar (vjeljet) do të jenë pa rrezik për stabilitetin e efektivave nëse riprodhimi tejkalon raportin (një shpend të ri: për individë femër të rritur). Konkretisht vjeljet duhet të mos tejkalojnë:

- (5–10) % të efektivit kur riprodhimi është mesatar (1–1,8 shpend të rinj për individ femër);

- (15–20) % të efektivit në rastin e një riprodhimi të mirë (më shumë se 1,8 shpendë të rinj për individ femër);

Kuotave të vjeljeve të përcaktuara në këtë mënyrë duhet t’u zbritet 30% për shkak të mosgjetyes së shpendëve të vrarë në grumbujt e rinj tepër të dendur.

- Përveç viteve kur riprodhimi dështon, vjeljet duhet të ndërpriten kur tendenca e efektivit tregon një regresion të theksuar ose kur dendësia e shpendëve gjykohet si tepër e ulet.

8.4.1 Masa për përmirësimin e habitatit

Përmirësimi i habitatit realizohet si më poshtë [5]:

- Krijimi me anë të mbjelljeve i disa qindra sipërfaqeve (në formë çeltirash disa hektarësh) me myrtilus të shpërndara në pyje të ndryshme lejon rehabilitimin e mjediseve vitale, në të cilat grumbulli pyjor shumë i dendur nuk lejon bimët që prodhojnë bazën ushqimore të gjelit. Nganjëherë përdoret kullota në pyje si mjet për t’i mbajtur ato të hapura për një kohë të gjatë.

- Aplikimi i rrallimeve të hershme për të evituar pengimin e zhvillimit të vegjetacionit të nënpyllit dhe krijimin e një strukture të çrregullt (me shumë diversitet) në sipërfaqe të mëdha.

- Mbjellja e esencave pyjore të favorshme për gjelin e egër, si: hartine, kerleke, tis, fletore që prodhojnë fruta etj.




Fig. 11. Projektimi i pyjeve për Tetrao Urogallus, kërkesat mjedisore dhe rekomandimet e përgjithshme për implementimin e masave silvikulturale për ruajtjen e Tetrao Urogallus

- Pastrimi në formë mozaiku i sipërfaqeve tepër të mbyllura nga ashja (*rhododendron*), me qëllim që të restaurohet potenciali i tyre tërheqës për individët femra.

- Përcaktimi në pyjet e përhapjes të gjelit të egër të të ashtuquajturave “zona të qëndrimit të species” dhe të “zonave të rritjes së individëve” në sipërfaqe prej disa mijëra hektarësh, të cilat do të krijojnë mundësinë që pjesë të caktuara të pyllit të mbahen në gjendjen e trungishtes së vjetër që korrespondon me optimumin e kërkesave për këtë specie (fig. 11).

8.4.2 Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet

- Ndalimi për periudha dhe zona të caktuara i “gjuetisë fotografike”, si dhe i qarkullimit rrugor e përdorimit turistik të territorit kur mbrojtja e llojit e kërkon.

- Për zona të rëndësishme me karakter vital për gjelin e egër vendoset ndalimi i çdo ndërhyrjeje njerëzore dhe kalohet në gjetjen dhe eksperimentimin e zgjidhjeve të mundshme.

8.4.3 Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe atij artificial

- Hartimi i një programi për identifikimin, kartografin dhe përdorimi i teknikave zbutëse

(spirale plastike të ngjyrosura, vendosja e sferave me ngjyra të forta) për nxjerrjen në pah të kabllove elektrike apo të llojeve të tjera të kabllove, të cilat kalojnë nëpër pyje mbasi ato janë vdekjeprurëse për gjelin e egër.

- Një program i njëjtë hartohet edhe për rrethimet e sipërfaqeve të ndryshme me rrjeta teli për qëllime të ndryshme mbrojtjeje.

- Administrata e zonave të mbrojtura me stafin të ngarkuar për mënjanimin e brakonazhit në çdo pranverë bëjnë mbikëqyrjen brenda ose afër sipërfaqeve të këngës (arenave) për të zbuluar gjuetinë ilegale.

8.4.4 Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK i Malit të Tomorit

Për formulimin dhe detajimin e masave të konservimit së popullatave të gjelit të egër është e nevojshme të thellohen njohuritë tona mbi kapacitetet e shpërndarjes së shpendëve të rinj mbas ndarjes së tyre nga bërthama familjare.

Kartografimi i bërthamave më të rëndësishme të popullatave për konservimin e species kërkon të bëhen kërkime të tjera mbi organizimin e këtyre bërthamave në “metapopullata”. Ky kartografim



vendoset në raport me njohuritë e përfituara lidhur me kapacitetin e përhapjes së shpendëve të rinj nga bërthamat familjare.

Janë akoma të nevojshme kërkimet për saktësimin e ndikimit të predacionit dhe të shqetësimeve me origjinë antropogjene.

Kërkime suplementare kërkon edhe lidhja që ekziston midis ndryshimeve klimatike dhe suksesit të riprodhimit të gjelit të egër.

- Vlera e gjelit të egër si indikator i diversitetit biologjik të pyjeve të zonave malore duhet të testohet në mënyrë më të thelluar në shkallë të ndryshme madhësie, si pyll, masiv pyjor, njësi natyrale (p.sh. park i niveleve të ndryshme) apo region biogeografik.

- Në një të ardhme më të largët kur popullata dhe habitatet e gjelit të egër të jenë rikualifikuar mund të arrihet deri në promovimin e turizmit nëpërmjet “gjuetisë fotografike” nga observatorë që mund të ngrihen në afërsi të “arenave”, fig. 10, si dhe planifikimi i një vjeljeje vjetore të kontrolluar e cila mund të jetë objekt i një “gjuetie turistike”.

- Përveç këtyre, duke e ditur rëndësinë gjithnjë e më të qartë të këtij shpendi të egër si indikator i diversitetit biologjik pyjor, si dhe zhvillimin në rritje të koncepteve të “zhvillimit të qëndrueshëm” apo të “zhvillimit multifunksional”, marrja parasysh e tij në menaxhimin e hapësirave pyjore malore mund

të konsiderohet si një nga mjetet nëpërmjet të cilave mund të arrihen këta objektiva.

Për të gjitha problemet që mund të hasen gjatë zbatimit të planit, studiuesit në terren verifikojnë problematikën që ekziston, urgjencën e zgjidhjes së saj, duke parashikuar pastaj masat që duhen marrë, duke planifikuar realizimin e tyre dhe shpenzimet përkatëse.

Prioriteti: Thelbësor

Përgjegjësia: AKZM, ADZM Berat, shoqata mjedisore.

Palët e interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të territorit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, institucionet lokale, shoqatat lokale, shoqatat e gjuetarëve, institucionet shkencore etj.

Kohëveprimi: I menjëhershëm dhe në vijim

8.4.5 Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

Aktivitetet për ruajtjen e llojit shtrihen gjatë gjithë kohës së zbatimit të planit, pra në periudhën kohore 2-vjeçare. Por, aktivitetet të cilësuar si thelbësore dhe me efekt të menjëhershëm janë parashikuar të zbatohen që në vitin e parë të planit. Ndërkaq, aktivitetet e tjera do të zbatohen në vitin e dytë (tabela 5).

Nr.	Aktivitetet	Periodha
9.1	Përmirësimin e politikave për ruajtjen e species gjeli i egër dhe të planit të menaxhimit	
a)	Vendosja e rojave për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së follenizimit në PK të Malit të Tomorit për periudhën janar–qershor të çdo viti. Nuk duhet të lejohet hyrja e turistëve, vizitorëve brenda zone gjatë kësaj periudhe.	Gjatë gjithë zbatimit
b)	Kontroll i shtuar i aksesit të njeriut dhe banorëve vendës, me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për gjelin e egër.	Gjatë gjithë zbatimit
c)	Ndalimi i prerjeve/djegjeve në zonat kyçe (territoreve) ku qëndron gjeli i egër.	Gjatë gjithë zbatimit
9.2	Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e gjelit të egër	
a)	Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit, ku zonat ku gjeli i egër i ka habitat të tij, të përcaktohen si zona me ruajtje të veçantë	Gjatë gjithë zbatimit
b)	Promovim i ruajtjes dhe i përfitimit të ndërsjellë me komunitetin lokal të fshatrave Dardhë, Kapinovë, Tomor e Ujanik, për rimëkëmbjen e gjelit të Egër aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë	Gjatë gjithë zbatimit
c)	Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendrore të Parkut Kombëtar Malit të Tomorit	Gjatë gjithë zbatimit
d)	Ndërtim i një kulle të vëzhgimit të gjelit të egër në Parkun Kombëtar Malit të Tomorit. Ndërtimi i tyre i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vrojtimin e shpendëve	Viti i dytë
9.3	Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	
a)	Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje, si	Gjatë gjithë



	Italia dhe Mali i Zi, nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara	zbatimit
b)	Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të vendeve fqinje në mbrojtje të biodiversitetit, veçanërisht të species gjelit të egër	Gjatë gjithë zbatimit
c)	Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkët të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit	Gjatë gjithë zbatimit
d)	Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e gjelit të egër për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet	Gjatë gjithë zbatimit
e)	Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga Italia dhe Mali i Zi, duke shkëmbyer praktikatat me të mira.	Viti i parë
9.4	Menaxhimi dhe monitorimi i llojit <i>Tetrao Urogallus</i> dhe ruajtjen e habitatit	
9.4.1	Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit	Viti i parë
9.4.2	Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.3	Masa lidhur me gjuetinë dhe problematiken e lindur prej saj	
9.4.4	Masa për përmirësimin e habitatit	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.5	Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.6	Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe atij artificial	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.7	Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK Malit të Tomorit	Gjatë gjithë zbatimit

Tabela 5. Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

9. Informacione dhe masa sensibilizuese për aktorët dhe për popullsinë lokale në drejtim të thellimit të njohjes së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor i ndërmarrë në 20 vitet e fundit duket se po jep frytet e veta por ka ende nevojë që ruajtja e biodiversitetit dhe specieve në rrezik, si gjeli i egër të rrënohet jo vetëm në komunitetin vendor, por edhe atë kombëtar. Për këtë nevojitet trajnim i mëtejshëm i stafit të ADZM-së përgjegjëse, administratës vendore dhe grupeve të tjera të interesit.

Aktivite:

Organizmi i fushatave ndërgjegjëse publike me gjuetarët, komunitetet lokale, operatorët turistikë, institucionet qeveritare që janë pjesë e mbrojtjes së species gjelit të egër.

Organizim i vizitave shkëmbyese në vende partnere për të njohur dhe ndarë praktikatat më të mira të ruajtjes së gjelit të egër dhe menaxhimit të habitateve të tij.

Përgatitja e publikimeve si (fletëpalosje, broshura, postera etj.) mbi rëndësinë e habitatit/species në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Trajnim i stafit të ADZM-ve, në lidhje me edukimin mjedisor, ruajtjen dhe menaxhimin e shpendëve, jetës së egër në përgjithësi.

Trajnim i OJF-ve dhe i grupeve të tjera të interesit për ruajtjen e natyrës, duke u përqendruar veçanërisht në ruajtjen e gjelit të egër.

Trajnim i guidave ekoturistike për të shoqëruar turistët që vizitojnë Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

Zhvillimi i një moduli trajnimit për stafin ADZM-së përgjegjëse për zbatimin e ligjit mbi rregullat dhe rregulloret që lidhen me mbrojtjen e gjelit të egër.

Rritja e kapaciteteve teknike të punonjësve të zonave të mbrojtura, mbi:

- monitorimin e shpendëve;
- pajisjet e menaxhimit të cilat janë të rëndësishme për ruajtjen e gjelit të egër;
- minimizimin e ndërhyrjeve nga njerëzit dhe shqetësimeve të tjera të veçanta.

10. Vlerësim i impaktit të Planit të Veprimit për mbrojtjen dhe menaxhimin korrekt të habitatit/species

10.1 Problemet e pritshme gjatë implementimit

Zbatimi i planit mund të hasi në vështirësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm të jashtëm, të cilët



mund të ndikojnë në suksesin e tij. Është e nevojshme që këto faktorë të identifikohen dhe të listohen paraprakisht në mënyrë që të kontrollohen në mënyrë sa më efektive.

Katastrofa ekologjike natyrore: mund të përmendim kushtet e ashpra të motit (zjarre, dëmtime të bimësisë etj.) dhe epidemitë.

10.2 Impakti njerëzor

Është tashmë e njohur që faktori njerëzor i shprehur si shqetësim njerëzor ka një influencë të lartë në popullatat e shpendëve në Shqipëri. Ky është një alarm për të qenë shumë të kujdesshëm me kontrollin e gjuetisë në PK e Malit të Tomorit, në mënyrë që të mos cenohet popullata e gjelit të egër.

Ndryshimi i habitatit ose dëmtimi i tij nga aktivitete të ndryshme të banorëve vendës (prerje e pemëve, kositje e celtinave etj.) kanë një impakt të drejtpërdrejtë, sepse ato dëmtojnë habitatet jetike për llojin. Ato sjellin shqetësime të ndryshme, të cilat kanë efekte afatgjata në popullatë dhe ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe suksesin e zhvillimit pozitiv të saj.

Aktivitetet turistike të pakontrolluara, sidomos në zona me rëndësi të veçantë për llojin mund të sjellin shqetësim të vazhdueshëm të popullatës së tij edhe ulje të suksesit të riprodhimit të llojit.

Mënyra e vetme në terma afatshkurtër për të parandaluar impaktin negativ është kontrolli i këtyre aktiviteteve nga rangersat lokalë. Ruajtja e tij në mënyrë më afatgjatë mund të arrihet nëpërmjet ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë që ka gjeli i egër si aset i çmuar natyror i zonës së PK i Malit të Tomorit, i cili ndikon në zhvillimin ekoturistik dhe ekonomik të popullsisë lokale.

Me qëllim që të sigurohemi që ruajtja dhe shtimi është planifikuar siç duhet, do të merren në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- ruajtja e territorit natyror, e cila mbart habitate të përshtatshme për gjelin e egër;
- eliminimi i faktorëve, që shkaktuan zhdukjen e pjesshme të popullatës dhe identifikimi i rreziqeve të tjera potenciale;
- krijimi i kushteve për një rikolonizim natyral;
- sigurimi i kushteve për një zhvillim dhe qëndrueshmëri afatgjatë të popullatës, në mënyrë që të arrihet një popullatë e shëndetshme gjenetike;

- ndërgjegjësimi i popullatës vendëse për rëndësinë që ka lloji në zhvillimin e ekoturizmit në zonë.

11. Identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare, të cilat do të përfshihen në projekt nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet publike dhe private

Partneriteti do të sigurojë ekspertizën e nevojshme teorike dhe teknike për zhvillimin optimal të projektit. Partnerët kryesorë do jenë autoritetet lokale, stafi i ADZM Berat, të cilët do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e tij në terren. Gjithashtu OJF-të rajonale, institutet kërkimore, dhe universitetet do jenë partnerë të rëndësishëm, të cilët do të japin kontributin e tyre në ndërgjegjësimin e popullatës vendëse për rëndësinë e gjelit të egër dhe duke ndarë informacione shkencore. Pasi planet e punës të miratohen, ato do të përfaqësojnë një mjet me anë të të cilit çdo grup interesi do zhvillojë aktivitete konkrete, me synim ruajtjen e gjelit të egër. Çdo partner do të kontribuojë duke siguruar të dhëna, duke identifikuar problemet dhe duke sugjeruar zgjidhjet e mundshme respektivisht sipas fushës përkatëse. Banorët vendës, gjithashtu, do të jenë bashkëpunëtorë të rëndësishëm, duke qenë se ata janë në kontakt të vazhdueshëm me zonën dhe luajnë një rol kyç në ruajtjen e balancave të shfrytëzimit të mjedisit në zonën me interes dhe rrjedhimisht dhe impaktin mbi llojin *Tetrao Urogallus*.

Dhënia e fondeve për implementimin e planit është planifikuar të zhvillohet nga dy burime, si më poshtë:

Burime të brendshme:

- buxheti i shtetit të Republikës së Shqipërisë nga pjesa e përcaktuar për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- burimet e institucioneve shkencore dhe akademike;
- burimet e Shoqatës Shqiptare të Gjuetisë;
- burime të tjera (p.sh. sektori i biznesit)

Burime të huaja:

- Komuniteti Evropian – përmes programeve IPA CBC Itali–Shqipëri–Mali i Zi për disa vjet dhe për projekte të caktuara;
- kontribute të huaja;
- burime të tjera.



12. Monitorimi i Planit të Veprimit për kontrollin e efektivitetit të veprimeve

Monitorimi i Planit të Veprimit

Çdo plan konservimi ka nevojë për monitorim të thellë në mënyrë që sukcesi i Planit të Veprimit të bëhet i matshëm. Monitorimi duhet të fokusohet në përmbushjen e qëllimeve të Planit të Veprimit.

Në rastin tonë monitorimi duhet:

- të kontrollojë suksesin e riprodhimit të popullatës së gjelit të egër;
- të kontrollojë madhësinë e popullatës së gjelit të egër;
- të kontrollojë nivelin e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet intervistave me përfaqësues ose jo të zonës;
- të kontrollojë numrin e publikimeve kërkimore që përmendin gjelin e egër.

13. Lista e indikatorëve për monitorimin

Aktivitetet	Indikatorët	0 = nuk ka filluar; 1 = në proces; 2 = i përfunduar			
		Realizimi			Vlerësime/korrigjime shënime
		0	1	2	
Përmirësimin e politikave për ruajtjen e speciest gjeli i egër dhe të Planit të menaxhimit	Vendosja e rojave për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së folezimit në PK të Malit të Tomorit për periudhën janar–qershor të çdo viti. Nuk duhet të lejohet hyrja e turistëve, vizitorëve brenda zonës gjatë kësaj periudhe				
	Kontroll i shtuar i aksesit të njeriut dhe të banorëve vendës, me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për gjelin e egër				
	Ndalimi i prerjeve/djegjeve në zonat kyçe (territoreve) ku qëndron gjeli i egër				
Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e gjelit të egër	Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit, ku zonat ku gjeli i egër i ka habitat të tij, të përcaktohen si zona me ruajtje të veçantë				
	Promovim i ruajtjes dhe i përfuturit të ndërsjellë me komunitetin lokal të fshatrave Dardhë, Kapinovë, Tomor e Ujanik, për rimëkëmbjen e gjelit të egër aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë				
	Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendrore të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit				
	Ndërtim i një kulle të vëzhgimit të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit. Ndërtimi i tyre i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vërtetimin e shpendëve				
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje, si Italia dhe Mali i Zi nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara.				
	Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të vendeve fqinje në mbrojtje të biodiversitetit, veçanërisht të speciest gjelit të egër				
	Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkët të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit				
	Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e gjelit të egër për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet				
	Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga Italia dhe Mali i Zi, duke shkëmbyer praktikat me të mira				
Menaxhimi dhe monitorimi i llojit <i>Tetrao Urogallus</i> dhe ruajtjen e habitatit	Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit				
	Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve				
	Masa lidhur me gjuetinë dhe problematikën e lindur prej saj				
	Masa për përmirësimin e habitatit				
	Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet				
	Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe të atij artificial				
	Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK të Malit të Tomorit				



UDHËZIM

Nr. 336, datë 10.6.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 385, DATË 13.10.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR MARRJEN E
LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË
AUTORIT, RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI
DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR
PEZULLIMIN DHE HEQJEN E
LICENCËS, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.
35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË
DREJTAT E AUTORIT DHE TË
DREJTAT E TJERA TË LIDHURA
ME TO”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Pika 1, shkronja “ë” e germës “B”, e kreut I, riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Vërteton plotësimin e kriterëve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, të germës “B”, brenda 6 (gjashtë) muajve pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to.”.

2. Në pikën 1, shkronja “a”, e germës “C”, të kreut I, shtohet si vijon:

“Këto kontrata do të shoqërohet me lista të plota të titujve të veprave, të cilat do të administrohen.”.

3. Në pikën 1, shkronja “b”, e germës “C”, të kreut I, shtohet si vijon:

“Vërteton respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi.”.

4. Pikat 2, 3, 4 dhe 5 të germës “D”, në kreun I, rinumërohen:

“Pikat 1, 2, 3, 4”.

5. Pika 1 e germës “D”, të kreut I, riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit, ngre grupin e punës për shqyrtimin e kërkesave për licencim apo ripërtëritjen të licencës së AAK-ve dhe përcakton afatet për shqyrtimin e dokumentacionit.

6. Pika 1 e germës “D”, të kreut I, rinumërohet “pikë 5”.

7. Shkronja “e”, pika 2, germa “A”, kreu II, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“DDA-ja, bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit pezullimin për 6 (gjashtë) muaj të licencës.”.

8. Shkronja “e”, pika 2, germa “B”, kreu II, riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“DDA-ja, bazuar në raportin e grupit të punës, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit heqjen e licencës.”.

9. Ndryshimet në këtë udhëzim reflektohen dhe në formularët e aplikimit.

10. Këto ndryshime në udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.

11. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij udhëzimi.

MINISTËR I KULTURËS

Elva Margariti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS**Formular aplikimi për licencimin e agjencive të administrimit kolektiv për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to**

Data e aplikimit _____ Data e dorëzimit _____
data, muaji, viti data, muaji, viti

1. Emri, _____

(organizatë pa qëllim fitimi, nenet 133, 134, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe të udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. _____, datë _____).

Adresa e selisë së Agjencisë:

a) Qyteti _____;

b) Rruga _____;

c) Tel: _____;

d) Fax: _____;

e) Email: _____.

2. Përfaqësuesi ligjor i Agjencisë, z./znj. _____.

3. Kategoria e të drejtave të autorit apo të drejtave të tjera të lidhura me to, ku kërkoni të administroni në emër të mbajtësit të të drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrimi i kategorisë përkatëse):

a) _____

b) _____

c) _____

4. Vendim regjistrimi në gjykatë, i dalë nga sekretaria gjyqësore:

a) Nr. _____, datë _____.

5. Statut (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të regjistrimit të gjykatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. 385, datë 13.10.2020; (objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që Agjencia përfaqëson kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese etj.).

6. Ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj, si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale.

7. Mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë.

8. Banka/t dhe nr. i llogarisë/ve përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare.

9. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë shtetas shqiptar apo rezident në Republikën e Shqipërisë.

10. Rregullore e brendshme e dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të mësipërm të regjistrimit në gjykatë.

11. Administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës.

12. Listë të mbajtësve të të drejtave që kanë dhënë pëlqimin me shkrim për ta autorizuar për administrimin e të drejtave të tyre dhe do të shoqërohen me lista të plota të titujve të veprave të cilat do të administrohen.

13. Dokumentacionin e nevojshëm, në gjuhën shqipe, që dëshmon shprehjen e vullnetit për përfaqësim reciprok me agjencitë e huaja.



14. Dokument provues të kushteve të përshtatshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj.

15. Dokument provues të ekspertizës dhe shërbimit teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

16. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës jurist dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

17. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

18. Dokument provues për mekanizma të mjaftueshëm lidhur me mbledhjen shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimeve.

19. Për pikat 12 dhe 13 të këtij formulari depozitohet dokumentacioni provues për plotësim të tyre brenda 6 (gjashtë) muaj pas marrjes së licencës për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me to.

20. Pagesa e tarifës për aplikim për licencimin e organizatave si agjenci të administrimit kolektiv, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS**Formular aplikimi për ripërtëritjen e agjencive të administrimit kolektiv për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.**Data e aplikimit _____ Data e dorëzimit _____
data, muaji, viti data, muaji, viti

1. Emri i Agjencisë _____

(organizatë pa qëllim fitimi nenet 133, 134, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. _____, datë _____).

Adresa e selisë të Agjencisë:

Qyteti: _____;

Rruga: _____;

Tel: _____;

Fax: _____;

Email: _____.

2. Përfaqësuesi ligjor i Agjencisë, z./znj. _____.

3. Vendim regjistrimi në gjykatë, i dalë nga sekretaria gjyqësore:

Nr. _____, datë _____ (i rifreskuar):

4. Ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale.

5. Statut (bashkëlidhur) i dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të regjistrimit të gjykatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, dhe udhëzimit të ministrit të Kulturës nr. 386, datë 13.10.2020; (objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që Agjencia përfaqëson, kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese etj.).

6. Kategoria e të drejtave të autorit apo të të drejtave të tjera të lidhura me to që kërkohet të administrohen në emër të mbajtësit të të drejtave të autorit/të drejtave të lidhura me to (përshkrimi i kategorisë përkatëse):

a) _____;

b) _____;

c) _____.

7. Mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë.

8. Banka/t dhe nr. i llogarisë/ve përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare.

9. Drejtori ekzekutiv duhet të jetë shtetas shqiptar apo rezident në Republikën e Shqipërisë.

10. Rregullore e brendshme e Agjencisë (bashkëlidhur) e dalë nga sekretaria gjyqësore, sipas vendimit të mësipërm të regjistrimit në gjykatë.

11. Kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtave të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre.

12. Kontrata për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja në gjuhën shqipe.

13. Administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës.



Po _____ Jo _____

14. Mënyrën e funksionimit të brendshëm dhe e respektimit të akteve rregulluese.

15. Raportimin dhe përmbushjen e detyrave të lëna nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.

16. Dokumente provuese për respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi.

17. Dokumente provuese për përmbushjen/zbatimin e parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit për ushtrimin e administrimit kolektiv dhe të legjislacionit në fuqi.

18. Dokumente provuese të funksionimit të mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve kundrejt anëtarëve titullarë të të drejtave.

19. Kushte të përshtatshme me pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj;

20. Ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

21. Ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj, të vërtetuara me dëshmitë përkatëse;

22. Dokument provues të ekspertizës profesionale me një punonjës në fushën financiare dhe është njohës i të paktën një gjuhe të huaj, të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.

23. Dokumentacion, dëshmi për punonjësit që do të jenë pjesë administrative e AAK-së, që vërteton kualifikimet e tyre profesionale, përvojën profesionale dhe njohuritë e gjuhëve të huaja;

24. Deklarimin lidhur me gjendjen gjyqësore të drejtorit ekzekutiv, si dhe çdo punonjësi të punësuar.

25. Njësitë përbërëse të administratës së Agjencisë, kontratat e punës dhe niveli i pagave të tyre.

26. Deklaratë e gjendjes financiare aktuale të nënshkruar nga drejtuesi i Agjencisë.

27. Pasuritë e paluajtshme në emër të Agjencisë, të vërtetuar me certifikatë pronësie nga ZRPP-ja (kopje e noterizuar).

28. Performancën në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e saj.

29. Performancën në lidhje me shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës.

30. Transparencën e bilanceve, informacionit dhe raportimit me organet e tjera shtetërore.

31. Pagesa e tarifës për aplikim për ripërtëritjen e licencës të organizatave, si agjenci të administrimit kolektiv, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

32. Procese gjyqësore me objekt cenimi të të drejtave të mbrojtura nga Agjencia.

Po _____ Jo _____

33. Nëse keni listoni dhe paraqisni bashkëlidhur kopje të vendimeve të gjykatës nga sekretaria gjyqësore:

Për Agjencinë e Administrimi Kolektiv

Emri, mbiemër, firmë, vulë, përfaqësuesit ligjor të Agjencisë

**URDHËR****Nr. 270, datë 31.5.2021**

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK
“MBI PËRDORIMIN E DETYRUESHËM
TË MASKAVE NË AMBIENTET
JASHTË SHTËPISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 23, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar; në zbatim të autorizimit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 556, datë 29.1.2021; në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 2435, datë 27.5.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik “Mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe të gjithë institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve në pikën 23, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Eugena Tomini**

UDHËZUES

**MBI PËRDORIMIN E DETYRUESHËM TË
MASKAVE NË AMBIENTET JASHTË
SHTËPISË**

Ky udhëzues hartohet bazuar në pikën 23, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”. të ndryshuar,

Hyrje

Ky dokument paraqet kriteret e përgjithshme, rregullat dhe përjashtimet për përdorimin e barrierave mbrojtëse (maskave) në ambientet jashtë shtëpisë, me qëllim zvogëlimin e përhapjes së mundshme të COVID-19.

Maska ndihmon në zvogëlimin e përhapjes së infeksionit në komunitet, duke minimizuar transmetimin e tij nga individ të infektuar. Përdorimi i maskave të fytyrës në komunitet mund të shërbejë si një mjet për kontrollin e burimit të infeksionit.

Përdorimi i barrierës mbrojtëse (maskës) duhet të konsiderohet vetëm si një masë plotësuese dhe jo si një zëvendësim i masave të përcaktuara parandaluese, duhet të zbatohet bashkë me distancën fizike 1.5 – 2 metra dhe higjienën e duarve.

1. Përdorimi korrekt i barrierës mbrojtëse (maskës)

Parimet e përdorimit korrekt të maskave janë:

- a) maska e fytyrës duhet të mbulojë plotësisht hundën, gojën dhe mjekrën;
- b) pastrohen duart me sapun dhe ujë ose dezinfektues duarsh me bazë alkooli, përpara se të vendoset dhe hiqet maska;
- c) maska nuk duhet të preket kur vendoset;
- d) maska duhet të hiqet nga pas, duke shmangur preken e përparme të saj duke palosur qoshet e jashtme së bashku;
- e) maska kirurgjikale hidhet në koshin e mbetjeve pas heqjes;
- f) lani duart ose përdorni dezinfektant menjëherë pas heqjes së maskës;
- g) maska jomjekësore prej tekstili, e ripërdorshme, pasi hiqet duhet të lahet pas çdo



përdorimi, duke përdorur larës të zakonshëm në 60° C;

h) maska jomjekësore prej tekstili pasi të hiqet vendoset në një qese deri sa të lahet.

2. Kur duhet të mbahet maska

COVID-19 përhapet kryesisht ndërmjet njerëzve që janë në kontakt të ngushtë me njeri-tjetrin (brenda 1.5 – 2 metra). Barrierë mbrojtëse (maska) duhet të vendosen vetëm në ambientet e mbyllura. Përdorimi i barrierës mbrojtëse (maskës) jashtë shtëpisë rekomandohet parimisht në këto raste (rastet më tipike):

- a) në çdo ambient të mbyllur;
- b) në çdo dyqan, supermarket apo aktivitet tregtar;
- c) fëmijë mbi moshën 11 vjeç, kur vizitojnë mjedise si në pikën “b”;
- d) në të gjitha mjetet e transportit publik dhe jopublik, kur në to enden persona të tjerë, përveç drejtuesit të automjetit;
- e) gjatë të gjithë aktivitetit të punës në zyra, të gjithë institucionet publike dhe jopublike, teatër, kinema, muze, biblioteka, etj.;
- f) nëse jeni duke u kujdesur në shtëpi për një familjar me COVID-19;
- g) në të gjitha ambientet e brendshme në institucionet fetare;
- h) në institucionet arsimore dhe ato të kujdesit shëndetësor, sipas rekomandimeve të mëparshme.

3. Modifikimet e përdorimit të barrierës mbrojtëse (maskës)

Vendosja e barrierës mbrojtëse (maskës) nuk mund të jetë e mundur në çdo situatë. Prandaj, ekzistojnë gjithashtu skenarë në disa raste kur ju lejohet të hiqni atë apo të modifikoni përdorimin e saj:

- a) nëse kërkohet për qëllime të identifikimit personal nga zyrtarët përkatës në polici, në bankë, në postë, në gjykatë, etj.;
- b) gjatë procesit të manipulimeve dentare;
- c) nga personat që mbajnë/drejtojnë lutjen/shërbesën/ceremoninë fetare në ambiente të mbyllura;
- d) nga persona me humbje të dëgjimit dhe të folurit ose për personat gjatë kohës së komunikimit me ta, nëse nuk kanë mundësi të përdorin maska të posaçme (transparente);
- e) nëse kërkohet nga stafi i dyqaneve ose marketeve përkatëse për identifikim të moshës,

përfshirë blerjen e produkteve me moshë të kufizuar, siç janë duhani dhe alkooli.

4. Rastet përjashtimore të përdorimit të barrierës mbrojtëse (maskës)

Mbajtja e maskës nuk mund të jetë e mundur në çdo situatë, prandaj parashikohen situatat përjashtimore, si vijon:

- a) në të gjitha rastet kur përdorimi i maskës dëmton shëndetin, sipas rekomandimit të mjekut të familjes*;
 - b) nga persona me sëmundje që i bëjnë të paaftë për përdorimin e maskës*;
 - c) gjatë ushtrimit të aktivitetëve sportive;
 - d) kur në makinë është vetëm drejtuesi i mjetit ose persona që kanë lidhje familjare me të;
 - e) në aktivitete që mund të shkaktojnë lagjen e maskës, si p.sh.: gjatë larjes në pishinë, në liqen ose në det;
 - f) në shtëpi, me anëtarët e ngushtë të familjes;
- * Atyre që për shkak të moshës, shëndetit ose për arsye të paaftësisë nuk bartin maskë, do t'u kërkohet dokumentacioni shëndetësor që verifikon statusin apo vërtetimi respektiv.
- **Këto udhëzime do të rivlerësohen në vazhdim, sipas të dhënave të sëmundshmërisë dhe situatës epidemiologjike të COVID-19.
- ***Udhëzuesit e mëparshëm mbi përdorimin e maskës, që nuk bien ndesh, mbeten në fuqi.

DREJTOR
Albana Fico

Referencat

1. National Institute for Occupational Safety and Health (NIOSH). Use of respirators and surgical masks for protection against healthcare hazards [internet]. Atlanta: CDC; 2018 [accessed 1 April 2020]. Available from: <http://www.cdc.gov/niosh/topics/healthcare/sps/respiratory.html> 2.
2. European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC). Safe use of personal protective equipment is the treatment of infectious diseases of high consequence. Stockholm: ECDC; 2014. Available from: <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/media/en/publications/Publications/safe-use-of-ppe.pdf>



3. World Health Organization (WHO). Non-pharmaceutical public health measures for mitigating the risk and impact of epidemic and pandemic influenza. Geneva: WHO; 2019. Available from: <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/329438/9789241516839-ng.pdf>

4. World Health Organization.

Advice on the use of masks in the context of COVID-19. Geneva: World Health Organization; 2020 (<https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/331693> accessed 20 August 2020)

5. UNICEF. Convention on the Rights of the Child text. 1990

(<https://www.unicef.org/child-rights-convention/conventiontext> accessed 20 August 2020)

6. CDC, USA:

www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/prevent-getting-sick/how-to-wear-cloth-face-coverings.html.

URDHËR

Nr. 390, datë 7.6.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 7.6.2021 deri në datën 11.6.2021.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacioni në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

KËRKESË

Nr. 3010/5, datë 11.6.2021

RISHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rishpall kërkesën për shpronësim, për interes publik përmes kompensimit me shkëmbim, për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit “Për zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative 6, zona Kombinat”, në funksion të procesit të rindërtimit.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij ripublikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga procedura e shkëmbimit të pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative nr. 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë”, ku masa e kompensimit vendoset sipas rregullave, si më poshtë vijon:

1. Për pasuritë e llojit “tokë truall”, shkëmbimi për interes publik realizohet referuar gërmës “b”, të pikës 3, të kreu II, të VKM-së nr. 7, datë 6.1.2020, të ndryshuar, ku përcaktohet se “...në rast të kompensimit të vlerës së truallit me sipërfaqe banimi, vlera e sipërfaqes së ndërtimit përlllogaritet duke përdorur si bazë çmimet e miratuara me vendim nga EKB-ja, në fuqi në kohën e shpronësimit ose shkëmbimit...”, si dhe shkresës nr. 1644/1 prot., datë 14.4.2021, të Entit Kombëtar të Banesave, ku përcaktohet se “...çmimi për



sipërfaqe shfrytëzimi për zonën e Kombinatit, z.k. 8230 është 65 000 lekë /m².

2. Për pasuritë e llojit “objekt banimi”, shkëmbimi për interes publik realizohet referuar germës “a”, të pikës 5, të kreu II, të VKM-së nr. 7, datë 6.1.2020, të ndryshuar, ku përcaktohet se “...pronarët që kanë në pronësi njësi banimi do të përfitojnë në shkëmbim të pasurive të tyre njësi banimi në ndërtesat që realizohen në zonën e re për zhvillim ose shtëpi individuale banimi në zonën e re për zhvillim, sa sipërfaqja e banesës që kanë...”.

